

KOHA

për

Gratë



PËRGATITUR NGA



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Center for Gender Studies

GRATË DHE ZGJEDHJET

Revolucioni i grave

Besnik Krasniqi

Vjosa Osmani e ka shembur “rregullin” e rrënjësuar prej më shumë se një dekade që grave u siguronte përfaqësim në Kuvend nëpërmjet kuotës gjinore, derisa gara për votë bëhej mes burrash. Kuota s’iu desh në tri palë zgjedhjet paraprake, e as në këto të 14 shkurtit që e bënë kandidaten më të votuar ndër gra e burra në historinë e Kosovës.

Rezultatet përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tregojnë se Osmani ka marrë 300.788 vota, e që bëjnë më shumë se votat që kanë mbërri bashkërisht bartësit e listave të 27 subjekteve tjera garuese.

Osmani, e cila në mandatin që po përmbyllet është kryeparlamentare dhe nga ky funksion ushtron edhe detyrën e Presidentes së shtetit, thotë se qysh në zgjedhjet e vitit 2019 është vërejtur qartë që votuesit në Kosovë duan një përfaqësim më të madh të grave në politikëbërje.

“Një votë në favor të grave ka ardhë si rezultat i faktorëve të ndryshëm, por duhet theksuar që shumica e grave që ishin në politikë dëshmuar që janë model i denjë se si duhet të jetë një politikane e kohëve tona dhe kanë dhënë kontribut përmbajtësor në skenën politike duke e mbështetur po ashtu njëra-tjetrën dhe duke u angazhuar për fuqizimin e vazave dhe grave tjera”.

E, pas zgjedhjeve të tri javëve më parë, sipas Osmanit, vajzat dhe gratë në politikë dëshmuar edhe njëherë që puna e mirë shpërblehet dhe që korrektësia dhe respektimi i vullnetit të qytetarëve vlerësohet me besimin e tyre. Ajo flet për një realitet të ri që tashmë ka mbërritur në skenën politike dhe thotë se indikacionet janë që shumë gra kanë thyer rekorde dhe janë ndër politikanët më të votuara në vend.

“Nga ky realitet nuk ka më kthim prapa. Ne ende nuk kemi një përfaqësim të barabartë gjinor në institucionet tona, por trendët dhe përkushtimi i grave në veçanti në këtë drejtim, duke mos e mohuar edhe kontributin e disa burrave, është garancia më e mirë që edhe barazia gjinore në politikë mund të jetë një realitet i afërt, e që kjo përfundimisht do të reflektohet në mirëqenie më të mirë e politika më të barabarta për të gjithë. Vota masive e grave në këto zgjedhje dëshmon se pikërisht gratë i kanë prirë ndryshimit”.

Në zgjedhjet e 2019-ës, Osmani ishte prijëse e listës së kandidatëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe për rreth 15 mijë vota nuk mbërriti ta mundte Lëvizjen VETËVENDOSJE! Para këtyre zgjedhjeve, të dyja partitë ishin në opozitë dhe patën dhënë zotimin për bashkëqeverisje. Ajo u zgjati veç 50 ditë, meqë forumet vendimarrëse të LDK-së u përcaktuan për mocion mosbesimi kundër qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti i LVV-së. Osmani u pozicionua kundër, e hakmarrja që pasoi nga LDK-ja ishte largimi nga vendimarrja partiake.

Ky zhvillim dhe vendimi që pas mocionit të qeveriste me partitë që paraprakisht i kishte bërë përgjegjëse për krim, korrupsion e

hise në kapjen e shtetit, i kushtuan LDK-së. Në zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit, Osmani bashkë me disa aktivistë të LDK-së garoi në listë me LVV-në, në të cilën u rangua e dyta, por rezultoi në krye pasi KQZ-ja nuk e certifikoi bartësin Albin Kurti. Rezultati përfundimtar i këtyre zgjedhjeve tregoi se LDK-ja i humbi saktësisht gjysmën e votave, e LVV-ja u rrit dhe siguroi mbështetjen e gati gjysmës së elektoratit kosovar (49.95 për qind). Kësisoj, dallimi prej 15 mijë votash mes këtyre dy partive që ishte në tetor të 2019, kur Osmani i printe LDK-së, për një vit pësoi rritje astronomike prej 327 mijë sosh.

Një hulumtim opinioni i realizuar në ditën e fundit të fushatës, e që u publikua në KTV në momentin e mbylljes së vendotimeve, tregoi se 52.4 për qind e grave të anketuara do të jepnin votën për LVV-në, në krahasim me 35.1 për qind të burrave. Edhe një “exit poll” i publikuar

në të njëjtën kohë nga UBO dhe TV Dukagjini ofroi të njëjtën pasqyrë.

Linda Gusia, profesore në Departamentin e Sociologjisë të Universitetit të Prishtinës, thotë se ky përbën revolucion.

“Çka mendoj që ka qenë revolucionare në zgjedhjet e fundit është pikërisht fakti që gratë kanë votuar për gra. Kemi njëfarë lëvizje të madhe, për dallim nga mënyra se si është votuar më herët. Mendoj që zgjedhjet e fundit e dëshmojnë se ekziston njëfarë insistimi edhe i qytetarëve të Kosovës, por edhe i burrave, me pa më shumë gra në politikë dhe të përfaqësuar”.

Ajo çfarë ishte parë në prag të garës zgjedhore nuk ishte inkurajuese. Listat e partive kryesore që përmbanin kandidatët dominoheshin nga burrat. Në to kishin përfshirë minimalisht gra, sa për të qenë brenda kuotës prej 30 për qind, që e kërkon Ligji për Zgjedhjet. Kësisoj, nga 1.052 kandidatë gjithsej, vetëm 359 ishin gra, ose 34.1 për qind.

Para zgjedhjeve, Instituti D4D publikoi një letër të hapur me të cilën kërkoi përfaqësim të barabartë në lista.

Valëza Zogjani, hulumtuese e politikave në këtë institut, thotë se subjektet politike vazhdojnë të mos e respektojnë Ligjin për Barazimë Gjinore, i cili thërret për barazi gjinore në të gjitha organet publike dhe mjaftohen me obligimet që dalin nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili parashihet kuotë gjinore prej 30 për qind për gjininë e nënpërfaqësuar – gratë, në listat zgjedhore.

“Në mungesë të harmonizimit të plotë të këtyre ligjeve, edhe në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të shkurtit 2021 që sapo përfunduan, vërejmë tendencën e subjekteve politike për të mirëmbajtur praktikën e kuotës minimale prej 30 për qind, që rrjedhimisht cenon edhe mundësitë reale të përfaqësimit të barabartë të grave në Parlament. Përderisa në këtë palë zgjedhje është konsideruar sukses i madh tejkalimi i kuotës minimale të përfaqësimit të grave në listën e njërit subjekt politik, edhe pse ishte larg kuotës 50-50 për qind, kjo në fakt jep sinjal për kulturën politike në përgjithësi në Kosovë, ku gratë ende nuk shihen mjaftueshëm hisedare të proceseve të rëndësishme politike dhe vendimarrëse në vend, dhe në jetën publike në përgjithësi – kulturë e cila nxitet direkt nga vetë subjektet politike”.

Në garën zgjedhore, gratë fituan për 2.5 për qind më shumë vende në Kuvend sesa që partitë u dhanë hapësirë në lista. Legjislatura e re do t’i ketë 44 deputete, ose 36.6 për qind të përbërjes.

Vetëm 9 nga deputetet kanë marrë mandatin me ndihmën e kuotës për gjininë e nënpërfaqësuar: 4 prej 5 deputeteve të LDK-së, 3 prej 6 deputeteve të PDK-së, si dhe 2 prej 3 deputeteve të AAK-së.

Me forca të veta hynë në Kuvend të 23 deputetet e LVV-së, sikur edhe të 7 deputetet që përfaqësojnë komunitetet pakicë.

Aktivistja Jeta Krasniqi, e cila është hulumtuese në KDI, do akoma më shumë përfaqësim. Ajo shtron

nevojën që, për të arritur përfaqësimin e barabartë, të bëhen ndryshime në Ligjin për Zgjedhjet, por në të njëjtën kohë të ketë ndryshim të qasjes edhe brenda vet partive politike, duke u demokratizuar dhe ofruar qasje të barabartë grave, qoftë në vendimarrje, por edhe qasje në resurset financiare.

“Çështja e përfaqësimit të barabartë gjinor lidhet me vullnetin apo mosvullnetin e partive politike për të promovuar me të vërtetë barazi gjinore, duke ndërmarrë reformat e brendshme të nevojshme në këtë drejtim. Në këto zgjedhje fuqia e votës së grave ishte më se e qartë. Kjo duhet të përkthehet edhe në përfaqësim në pozita vendimarrëse. Thënë shkurt, duhet të lëvizet nga premtimet në veprime konkrete që reflektojnë realisht vullnetin politik të partive politike për t’iu ofruar grave qasje dhe mundësi të barabarta”.

Ambienti patriarkal çfarë përbën Kosova, nuk ka ofruar hapësirë përfaqësimi për gratë. Por, ato nuk i janë bindur realitetit dhe nuk i kanë ndalur përpjekjet për ta zënë hapësirën që u takon. Në vitet e 1980-a, simbol i përpjekjeve të tilla ishte Kaçusha Jashari, e cila mbërriti të ishte edhe në krye të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, një post i ngjashëm për nga rëndësia me atë të drejtuesit të qeverisë.

Pas suprimimit të autonomisë nga Serbia, Kosova organizoi sistem paralel funksionimi dhe, edhe në këtë kohë, një nga zërat më të artikuluar opozitar ishte ai i një gruaje – Luljeta Pulës.

Në dekadën e fundit, gruaja më me ndikim në politikë u bë Vjosa Osmani. Në vitin 2010 ajo i hyri garës për deputete dhe fitoi pa pasur nevojë që mandatin ta marrë nëpërmjet kuotës. Në 2014 shkon në rreth 40 mijë vota. Ndërkohë, provoi t’i bëhej kundërkandidate për kryetare partie kreut të LDK-së, Isa Mustafa, por kjo iu pamundësua. Dhe, shkaku i oponencës që ia bënte atij, në zgjedhjet nacionale partia e rangoi të 81-ën në listën e kandidatëve për deputetë. Përkundër kësaj, atë vit i siguroi 64 mijë vota. Pastaj, përkohshëm, partia ndërroi qasje ndaj saj dhe në zgjedhjet e 2019-ës e bëri kandidatë për kryeministre dhe bartëse të listës së kandidatëve për deputetë, kur i fitoi 176 mijë vota.

Pasi LDK-ja e përjashtoi nga forumet vendimarrëse dhe në prag të zgjedhjeve të 14 shkurtit u mor vesh me LVV-në për t’u përfshirë në listën e saj, u prezantua edhe si kandidatë e ardhshme për presidente.

Vjosa Osmani thotë se çdo grua që synon të jetë pjesë e garës zgjedhore dhe të sigurojë përfaqësim përmasaj duhet së pari dhe mbi të gjitha të besojë në aftësinë e vet për të arritur një gjë të tillë. Mesazhi që ua jep grave dhe vajzave është se ato duhen ta kenë të qartë që munden ta bëjnë këtë. Përtej kësaj, sipas Osmanit, besnikëria ndaj pritshmërive të qytetarëve, përgatitja, sinqeriteti dhe konsistenca në veprime janë parakushte për ta fituar besimin e tyre.

Por, tërheq vëmendjen se, mbi të gjitha, duhet kuptuar që fitimi i besimit të qytetarëve është vetëm hapi i parë në këtë rrugëtim.

“Për të ecur në rrugët e gjata të angazhimit politik duhen të identifikohen kauzat të cilat shtyhen përpara, duhet të veprohet duke mos i kompromentuar vlerat dhe parimet e veta, dhe duhet të komunikohet vazhdimisht e rregullisht me elektoratin. Sukses i pjesëmarrjes në politikë nuk është përzgjedhja, por angazhimi për ndryshim pozitiv dhe luftimi për kauza të cilat përfundimisht e përmirësojnë mirëqenien e shoqërisë në të cilën jetojmë”.

Autori është gazetar në KOHA Ditore.

Lista e 10 grave më të votuara

1. Vjosa Osmani, LVV – 300.788 vota
2. Donika Gërvalla Schwarz, LVV – 71.720 vota
3. Vasfije Blair, LVV – 60.885 vota
4. Mimoza Kusari Lila, LVV – 53.563 vota
5. Saranda Bogujevci, LVV – 26.378 vota
6. Arbërije Nagavci, LVV – 21.800 vota
7. Labinotë Demi Murtezi, LVV – 19.970 vota
8. Shqipe Mehmeti Selimi, LVV – 18.522 vota
9. Miljana Nikoliq, LS – 18.348 vota
10. Verica Çeraniq, LS – 15.394 vota

Lufta për drejtësi: Nga aktivizmi, në parlament



Vasfije Krasniqi - Goodman

Unë e kam thënë disa herë që nuk ka qenë në planet e mia që të merrem me politikë dhe kjo për shumë arsye. Një nga arsyet ishte se unë jetoj larg nga Kosova dhe larg aktiviteteve që partitë politike zhvillojnë këtu. Megjithatë, në këto zgjedhje mora vendim që angazhimin politik tash e tutje ta bëj përmes një subjekti politik. Ky vendim ndërlihet ngushtë me kauzën time dhe mënyrën se si mendoj që drejtësia për gratë dhe burrat, të mbijetuarat/a të dhunës seksuale gjatë luftës, mund të arrihet më shpejt dhe më sigurt. Që nga koha kur kam marrë qëndrim publik për të mbijetuarat/a të dhunës seksuale gjatë luftës, duke e ndarë përvojën time dhe avokuar për drejtësi për këtë kategori, unë kam takuar qindra të mbijetuarat/a, përdërisa kam mbajtur kontakt me qindra e qindra të tjerë. Ajo që unë kam vërejtur përgjatë kësaj kohe është zhgënjimi i madh i tyre në institucionet tona. Përgjatë kësaj periudhe të angazhimit, duke e parë si ka ecur procesi me njohjen e statusit të "të mbijetuarës/it të dhunës seksuale" si kategori e dalë nga lufta, kam arritur ta identifikoj se pikërisht mënyra në të cilën institucionet dhe politika vendore i qaset kësaj kategorie është një pjesë e problemit për mosarritjen e drejtësisë për ato/ata. Prandaj kam konsideruar që nevojitet një zë më mbështetës për këtë kategori pikërisht brenda Kuvendit të Kosovës, nevojë e cila edhe më ka obliguar që t'i hyj garës për t'u bërë njëra nga përfaqësueset në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për mua është shumë e rëndësishme që kur flasim për kategoritë e dala nga lufta, të mbijetuarat/it e dhunës seksuale të përfshihen në të. Qoftë si njohje e vuajtjes dhe kontributit të tyre, qoftë si kategori me të cilat shteti duhet të merret me seriozitet për t'iu ofruar drejtësi.

Ajo çka më obligon mua dhe të tjerët të punojmë më shumë për këtë kategori është nevoja e menjëhershme që të punojmë në krijimin e politikave të cilat hapin rrugë dhe mbështesin organet e drejtësisë në ndjekjen e atyre që kanë bërë krime të luftës. Gjithashtu, një dimension tjetër po aq i rëndësishëm i gjithë angazhimit tim dhe tonë politik duhet të jetë fuqizimi socioekonomik për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale. Me këtë nënkuptoj që ne duhet të punojmë që ligjin për njohjen e statusit të të mbijetuararave/ëve të dhunës seksuale gjatë luftës. Fuqizimi socioekonomik është parakusht për arritjen e drejtësisë për këto kategori të ndjeshme, nëse veç i marrim parasysh problemet e shumta psikologjike, ekonomike dhe shoqërore që u janë krijuar atyre prej luftës e tutje. Andaj, konsideroj që nëse punojmë më drejtë dhe më me vendosmëri në krijimin e kushteve më të mira për personat që tashmë i janë nënshtruar procesit të njohjes së statusit të të mbijetuararës/it të dhunës seksuale gjatë luftës, palët që do të kërkojnë drejtësi do të shtohen dhe vetëm atëherë mund të flasim për funk-

sionalizimin e ligjit dhe vendosjes së drejtësisë për to. Kjo pasi mendoj që fuqizimi ekonomik dhe drejtësia janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Kjo rrugë padyshim që do të jetë e vështirë dhe sfiduese. Megjithatë, unë jam e vendosur që të punoj për këtë kauzë e cila edhe më ka shtyrë t'i hyj politikës. Në Kuvend do të angazhohem me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion që të kontribuoj në forcimin e bazës ligjore e cila e nje dhe e mbron këtë kategori. Do të angazhohem që të bëhet ndryshim-plotësimi i ligjit për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës, për të përfshirë një shkallë më të gjerë të reparacioneve për këtë kategori.

Kosova është duke e krijuar një klimë politike e cila është më e gatshme të merret më seriozisht me të kaluarën dhe t'i trajtojë më dinjitetshëm të gjitha kategoritë e dala nga lufta. Aktualisht, qasja që do t'i bëhet këtyre personave është më premtuese, duke qenë se çdo herë e më shumë po shohim që fokusi është duke kaluar në atë që është avokuar nga aktivistët tash e një kohë, e që është fuqizimi socioekonomik i të mbijetuararave/ëve, si rruga e vetme e cila siguron vendosjen e drejtësisë.

Përfundimisht, duhet ta ritheksoj që arsyeja pse unë e kam filluar angazhimin tim partiak ndërlihet kryekëput me nevojën për kontribut më të madh që vendosja e drejtësisë të jetë më e shpejtë, më gjithëpërfshirëse dhe kuptimplote. I gjithë aktiviteti im i deritanishëm ka qenë i përqendruar në fushën e të drejtave të njeriut dhe avokimin për dhënie fund të dhunës dhe përdhunimeve si mjete të luftës, si dhe ndalimin e praktikës së mosndëshkueshmërisë.

Një dimension tjetër që më shtyn edhe më shumë të jem pjesë e politikës është përfaqësimi i ulët i përvojave dhe nevojave të grave në politikë, sidomos kur flasim për ballafaqim me të kaluarën. Ajo çka kam vërejtur, por edhe është theksuar në të gjithë literaturën që trajton luftërat dhe konfliktet, është se trupat e grave janë mjete që për-

doren nga burrat për ta përcaktuar rrjedhën e luftës. Gjithashtu, rasti ynë dhe rastet tjera kanë treguar që është pikërisht qasja e burrave që janë të përfshirë në procesin e "paqebërjes" njëri nga problemet kryesore të cilin ne duhet ndryshuar rrënjësisht. Duke qenë që në pjesën dërrmuese të vendim-marrjes shohim burra që janë të përfshirë në të gjitha postet kryesore, na mbesin dy alternativa: të angazhohemi dhe të bëjmë presion në përfshirjen e perspektivës gjinore, ose të fillojmë ne si gra të përfshira drejtpërdrejt në luftë të hyjmë brenda këtyre proceseve dhe ta ndryshojmë qasjen nga brenda. Një gjë është e sigurt. Sikur gratë të ishin në krye të qeverisjes, përdhunimi dhe dhuna ndaj tyre, qoftë në familje dhe jashtë saj, nuk do të ndodhnin. Gjithashtu konsideroj që përfshirja e grave do ta bënte të gjithë procesin që e ka shoqëruar Kosovën që nga lufta e fundit - qoftë në riorganizimin shoqëror, fuqizimin e shtetit dhe ballafaqimin me të kaluarën - më të drejtë për të gjitha kategoritë e dala nga lufta. Ky element flet për rëndësinë që gratë duhet aktivisht dhe më masivisht të merren me politikë, në çdo nivel.

Ne si shoqëri duhet të punojmë ta forcojmë besimin që gratë të jenë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë të përfaqësuar në politikë, si dhe të jenë pjesë e vendim-marrjes. Kjo arrihet përmes hartimit të politikave që i fuqizojnë gratë ekonomikisht brenda familjes, në shoqëri dhe në institucione. Vetëm me fuqizimin e grave mund të krijohet një rregull i ri politik dhe shoqëror, i cili është kusht kryesor për progres. Është vërtetuar tashmë nga përvoja e shteteve të tjera se gratë në politikë jo vetëm që mundësojnë përfaqësim më të gjerë, por edhe i kontribuojnë përmbajtësisht politikëbërjes dhe zhvillimit të shtetit.

Gratë duan, dinë dhe duhet të bashkëqeverisin. Për një shtet të mirëqenies së gjithsecilit dhe gjithsecilës.

Autorja është deputete e zgjedhur në legjislaturën e tetë të Kuvendit të Kosovës.



Gratë në udhëheqje: Thelbësore, jo “Mirë për t'i pasur”



Nicholas Abbott

Gjatë vitit të shkuar, COVID-19 ka qenë sfidë për të gjithë ne. Por, veçanërisht ka qenë sfidë për profesionistët, të cilave iu është dashur të manovrojnë gjithë ato përgjegjësi.

Përgjatë tërë karrierës sime kam punuar me gra të talentuara, përfshirë në ambasadën britanike në Prishtinë, ku shumica janë gra. Gjatë vitit të kaluar kam parë se si ato i përshtatën shtëpitë e tyre dhe i kthyen në zyre dhe tek kryenin punën përtej pritjeve, duke punuar në një situatë ndryshe, por prapëseprapë duke arritur sukses përkundër sfidave të shtëpisë dhe punës që u shkruanë në njëra-tjetrën si kurrë më parë.

Përvoja e grave në pozita të pushtetit ndryshon nga ajo e burrave. Tradicionalisht, nga gratë në pozita udhëheqëse ende pritet që t'i bëjnë të gjitha: punën, familjen, miqtë, etj. Kjo situatë po ndryshon. Nga viti në vit, në Mbretërinë e Bashkuar po bëhet më e qartë se përgjegjësitë, punët dhe detyrat e shtëpisë duhet të kryhen si nga gratë ashtu edhe nga burrat. Edhe Kosova është në këtë rrugëtim dhe përderisa më shumë gra hyjnë në tregun e punës, kjo do të bëhet domosdoshmëri.

Kosova i ka pasur dy presidente, ministre të shumta, deputete, kryesuese të OJQ-ve, institucion-ëve... Këto gra tregojnë guxim dhe forcë në udhëheqje, e njëkohësisht iu prijnë dhe i mbështesin edhe familjet dhe miqtë e tyre. Ato kanë sjellë një këndvështrim, dikur të shpërfillur, por pa të cilin procesi i vendim-marrjes është i shtrembëruar dhe thelbësisht i padrejtë. Kontributi i tyre nuk paraqet thjesht vetëm vlerë të shtuar, është element thelbësor në ndërtimin e një shoqërie bashkëkohore dhe të drejtë.

Gratë udhëheqëse gjithmonë do të jenë forca shtytëse në demokratizimin e shoqërisë kosovare dhe kjo u bë më e evidente se kurrë gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare në Kosovë, ku pamë një rritje të dukshme të votueseve. Ky është hap i mirë për të ardhmen e Kosovës. Vetëm përmes pjesëmarrjes proporcionale në jetën politike dhe sociale do të shohim barazi të plotë për të gjithë qytetarët.

Përmes mbështetjes sonë dhe projekteve të ndryshme, ne kemi punuar me gra në situata të ndryshme. Momentalisht po punojmë me të mbijetuarat e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, për t'i rehabilituar, për të luftuar stigmën dhe për t'i fuqizuar që ato të bëhen udhëheqëse në shtëpitë, familjet dhe shoqëritë e tyre. Përmes fushatës “Bëhu zëri im”, ne përkrahëm Vasfije Krasniqi - Goodman për të folur publikisht. Ajo është shembull i guximit dhe këmbën-

guljes. Përkundër përvojës së saj, ajo prapëseprapë gjeti fuqinë për të luftuar stigmën, për të luftuar për drejtësi, për të mbështetur të mbijetuarat e tjera dhe për të kandiduar për Kuvend. Bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të fundit, kam besim se Vasfija dhe deputetët e tjerë do të bëhen zëri i atyre që më parë nuk kishin fare zë.

Fuqizimi ekonomik përbën një pjesë tjetër të rëndësishme të punës sonë në mbështetjen e të mbijetuararave të dhunës seksuale të lidhur me konflikt. Përmes fuqizimit ekonomik, të mbijetuarat gjenerojnë të ardhurat e tyre, pavarësohen më shumë dhe mund të marrin rol më aktiv në shoqëri. Hulumtimet kanë treguar se forcimi i ndjenjës së kontrollit përbën ndër faktorët kryesorë në kurimin nga trauma. Fuqizimi i njerezve që të kontribuojnë në shoqëri e ndryshon perceptimin se ata janë vetëm viktimë. Në vend të kësaj, ata mund të shohin se janë të nevojshëm dhe çmohen për punën dhe qëndrueshmërinë e tyre. Përmes mbështetjes së vazhdueshme të të mbijetuararave, ato që dikur janë viktimizuar tani bëhen udhëheqëse. E nxis/inkurajoj qeverinë kosovare që të vazhdojë të punojë në këtë drejtim.

Në kohë të konfliktit, gratë janë ndër më të prekurat sepse janë cak i sulmeve dhe viktimizimit, si dhe përkujdesen për më të vegjlit dhe të moshuarit. Është më se e rëndësishme që gratë dhe vajzat të jenë në thelb të punës sonë për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet. Zëri i tyre duhet të dëgjohet në të gjitha proceset vendim-marrëse, përfshirë edhe në dialogun me Serbinë.

Puna e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë gjithmonë do të synojë që t'i vë gratë në ballë të përpjekjeve tona dhe t'i fuqizojë ato që të bëhen udhëheqëse dhe të marrin vendime për të mirën e përgjithshme të shoqërisë. Në vend se t'i kategorizojmë gratë, ne jemi munduar t'i heqim pengesat dhe të krijojmë hapësirë që gratë të përdorin fuqinë, kreativitetin dhe aftësinë e tyre për të ndikuar në ndryshim. Kjo mundëson një proces përfshirës dhe të drejtë të vendim-marrjes, përmes së cilit prezantohen çështje që janë injoruar ose përjashtuar kur gratë nuk kanë qenë të pranishme në biseda.

Në përmbyllje, të drejtat e grave janë ngushtë të lidhura me të drejtat e të gjithëve. Barazia gjinore sjell paqe dhe siguri për të gjithë. Të gjithë ne e kemi për detyrë të promovojmë barazinë gjinore dhe të përfshijmë gratë në thelb të shoqërisë dhe në mënyrën si menaxhohet ajo shoqëri. Të gjithë duhet të punojmë për t'i mbështetur gratë dhe për t'ua mundësuar që të bëhen udhëheqëset që i duhen shoqërisë.

Sot, ne i kremtojmë gratë dhe vajzat anembanë botës dhe unë kërkoj që të gjithë të bëhemi nxitës të barazisë gjinore dhe të avokojmë për pjesëmarrjen e grave në të gjitha aspektet e udhëheqjes.

Autori është Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.

Barazia gjinore, sfidat dhe perspektivat



Naim Qelaj

Barazia gjinore i referohet të drejtave të barabarta midis burrave dhe grave. Vendi ynë ka një të kaluar historike të ndikuar nga normat zakonore ku gruaja nuk trajtohet barabartë me burrin – një paradoks që vazhdon edhe në ditët e sotme. Diskriminimi gjinor i vë gratë në situata të pafavorshme dhe kjo shihet në çdo sferë të jetës.

Që nga përfundimi i luftës është punuar shumë dhe me përkushtim për eliminimin e diskriminimit gjinor. Në saje të këtij angazhimi mund të themi që është arritur progres në avancimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe në respektimin e barazisë gjinore. Për dy dekada i është dhënë prioritet hartimit të politikave dhe strategjive që afirmojnë dhe promovojnë barazinë gjinore, e në anën tjetër legjislativi është harmonizuar me atë të BE-së. Janë aprovuar ligje për të drejtat e njeriut: Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligji për Barazinë Gjinore. Mirëpo, ka probleme me zbatimin e këtyre politikave dhe ligjeve, pikërisht për shkak të rezistencës nga mendësia dhe botëkuptimet e dominuara nga normat zakonore.

Si pasojë e moszbatimit të ligjeve në fjalë, sot kemi shumë pak raste të hapura në gjykata, pra kemi pak raste të raportuara, e kjo si pasojë e trajtimit të barazisë ligjore si një vlerë afirmative e jo si detyrim që ka

shteti dhe institucionet tjera. Barazia gjinore nuk ka arritur të trajtohet si detyrim pozitiv që ka shteti për ta luftuar çdo formë të diskriminimit.

Nga përvoja ime e kaluar dhe tani në pozitën e Avokatit të Popullit, kam vërejtur se praktika vendore gjyqësore kundër diskriminimit ende është e varfër, mungon përvoja e mjaftueshme në aplikimin e ligjit kundër diskriminimit. Për më tepër, duket se gjyqësorit i mungon një kategorizim adekuat dhe identifikim i lëndëve që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe, si rrjedhojë, nuk ka monitorim të duhur të këtyre lëndëve. Po ashtu, lëndët e diskriminimit nuk kanë një shenjë specifike të gjykatës, kështu që është shumë e vështirë të monitorohen. Sot, kur kemi fare pak raste të paraqitura në gjykatë, padyshim që të krijohet përshtypja që publiku nuk është i informuar për përmbajtjen e ligjit dhe për të drejtat që kanë sipas ligjit.

Gjykatat në Kosovë, përveç Gjykatës Kushtetuese që është një përjashtim, nuk përdorin ose nuk i referohen praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për çka i obligon Kushtetuta. Në anën tjetër, qytetarët, për shumë arsye, vazhdojnë të mos parashatrojnë në gjykata dhe institucione tjera raste kundër diskriminimit. Kjo ndodh për shkak se nuk i njohin mirë të drejtat e tyre sa i përket mbrojtjes ligjore kundër diskriminimit dhe mungesës së praktikës gjyqësore në rastet e diskriminimit. Ndodh edhe për shkak të mungesës së besimit në institucione, që është edhe tregues i mungesës së raportimeve për rastet e diskriminimit.

Përkundër deklarimeve për barazi gjinore nga organet vendimarrëse, vërehet mungesë e veprimit

politik. Institucioni i Avokatit të Popullit ka vërejtur se mungojnë hapat konkretë për masat afirmative për zbatimin e barazisë gjinore. Pjesëmarrja në jetën publike, e drejta për të zgjedhë dhe e drejta për të qenë i/e zgjedhur, nuk janë zbatuar në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës në 2019 dhe 2021. Kjo si pasojë e mungesës së vullnetit politik nga partitë politike që të afirmojnë përfaqësimin të barabartë në listat e kandidatëve të cilët garojnë në zgjedhje.

Mund të përfundoj se, përveç mangësive në promovim dhe në zbatim të ligjeve, mungon edhe vullneti politik dhe institucional për zbatimin e normave afirmative që do të krijonin parakushte optimale për një shoqëri pa diskriminim dhe me respektim të plotë të barazisë gjinore.

Çështjet e ndërlidhura me diskriminimin gjinor kërkojnë një qasje më të gjerë të të gjitha mekanizmave në vend, që mund t'i luftojnë të gjitha rastet e diskriminimit në mënyrë që shoqëria të prosperojë e barabartë. Ndryshimet në shoqëri duhen të vazhdojnë në mënyrë që qëndrimet negative dhe konceptet e vjetra të zhduken sa i përket diskriminimit gjinor. Për t'i bërë këto ndryshime duhet të punohet në të gjitha nivelet në zbatim të ligjit dhe politikave që janë miratuar nga legjislativi dhe qeveria. Nuk mjafton vetëm deklarimi afirmativ, duhet akcion dhe veprim konkret që vlerat mbi të cilat është ndërtuar vendi ynë të jetësohen, për të arritur të ndërtojmë një shoqëri pa diskriminim dhe me shanse të barabarta për të gjithë.

Autori është Avokat i Popullit në Kosovë.

Feminizëm qeverisës



Luljeta Demolli

Dita Ndërkombëtare e Gruas është platformë e vlerësimit të arritjeve feministe dhe përpjekjeve për ta përmirësuar shoqërinë duke promovuar barazinë gjinore.

Protestohet dhe marshohet për vazhdimësi të artikullimit të të drejtave të grave. Mbahen panele diskutimesh, u gëzohemi të arriturave personale, organizative dhe ekipore, mërzitemi për stagnimet. Në shkolla flitet për historikun e festës, lëvizjet mobilizuese dhe revolucionet, vizitohen monumente të grave.

8 Marsi është raport i progresit mbi të drejtat e grave.

Festa e sivjetme e gjen Kosovën në pozitë jo të mirë për t'i adresuar institucionalisht çështjet e feminizmit dhe të drejtave të grave. Pa parlament, pa qeveri, me ushtruese të detyrës së presidentes, dhe – me ashpërsim të pandemisë.

Lajmi i mirë është që për herë të parë kemi numër kaq të madh të grave deputete të zgjedhura në parlament, 44 prej 120 gjithsej.

Ballafaqimi me pandeminë COVID-19 është një prej indikatoreve kryesorë të sfidave të grave. Prej fillimit të qendrimit stoikisht në vijën e parë të frontit: profesioniste shëndetësore, punëtore sociale, mësuese dhe kujdestare kryesore në shtëpi. Pjesa e tregut të punës ku gratë janë më të angazhuara (tregti, hotelieri, prodhim, kujdestari) u prek më shumë. Një dëgjim i kohës së luftës, kur barra për gjithë kujdesin e shtëpisë, fëmijëve dhe të moshuarve ishte e grave.

Organizatave për të drejtat e grave i trajtuan me prioritet problematikat specifike që u shfaqën gjatë pandemisë, por nuk u haruan as pengesat tradicionale që me vite ua vështirësojnë jetën.

Ndër shqetësimet më kryesore që adresohet në kontinuitet prej feministeve është dhuna ndaj grave, e cila ndonjëherë rezulton edhe me vrasje. Tregu i punës është më i pazhvilluar në Europë dhe me kushte të pafavorshme, posaçërisht për gratë. Mungon një dialog substancial mes feministeve aktiviste dhe sektorit të organizatave të grave me institucionet vendimarrëse, gjë që e ka minuar për një kohë të gjatë arritjen e progresit më të madh për barazi gjinore.

Përpjekje për t'i adresuar çështjet që ndërlidhen me mirëqenien e grave u bënë edhe nga partitë politike gjatë fushatës për zgjedhjet e 14 shkurtit 2021. Kishte premtime për të ndërtuar politika më të mira familjare dhe rritje të mirëqenies së grave. Mirëpo, përgjithësisht, premtimet ishin populiste dhe të padetajizuara, me simbolika improvizuese dhe pa buxhetime, ndonëse edhe në këtë formë morën mbështetje të madhe nga votueset gra. Kryesisht u fol për politikë që i adresonin familjet e varfra.

Edhe partia fituese, Lëvizja VETËVENDOSJE!, në programin e saj premtoi angazhim për gratë në tregun e punës, politika përkrahëse për nënat dhe gratë kryefamiljare, subvencione që do t'u ndihmojnë grave, ide për pushimin e lehonisë, të drejtën në pronë dhe banim të përbalueshëm.

Problemi me këto politika që shënjestrojnë mirëqenien e grave është se asnjëherë nuk u tregua nëse ishin të harmonizuara dhe në pajtueshmëri me partnerët socialë, me organizatat e grave, me grupet

e feministeve. Nuk u ofrua ndonjë formulë realiste për rritjen e bashkëpunimit mes politikanëve dhe këtyre grupeve, për të krijuar qartësi nëse do të mund të presim një dialog të mirëfilltë për këto çështje pasi të krijohet qeveria e re.

Është qëndrim patronizues nga ana e politikanëve që të mos i tregojnë kontekstet prej nga u erdhën idetë, planet, adresimet dhe premtimet. Nuk thanë a janë politika vendore, rajonale, apo globale, origjinale ose të përshtatura. Sa janë të mundshme të realizohen përbrenda kufizimeve ekzistuese? Ç'kosto buxhetore kanë? Në cilën periudhë kohore do të mund të krijohen? Çfarë pajtueshmërie kanë me sektorin privat, për të cilin humtimet dëshmojnë se është diskriminues për gratë? A janë këto politika për t'i larguar gratë nga varfëria, stigmatizimi dhe marginalizimi, duke u ndihmuar të hyjnë në tregun e punës me një pagë të dinjitetshme, apo politika që i paguajnë gratë për të qëndruar në shtëpi, për t'u kujdesur për të vegjlit dhe të moshuarit, duke e paguar pushimin e lehonisë edhe për ato gra që nuk janë në tregun e punës?

Mirëqenia e grave është proces kompleks, prandaj duhet analizuar nëse nga politikat e premtuara do të priten efekte emancipuese, apo do ta vendosin gruan në margjinë, duke e fokusuar rolin riprodhues. Rajoni ynë gjithnjë e më shumë karakterizohet nga mbivendosja e normave patriarkale ndaj vendimeve racionale politike. Për shkak të ndryshimeve në situatat demografike, shumica e vendeve që na rrethojnë janë duke shfaqur modele të politikave me qëllim të rritjes së natalitetit – të arsyetueshme nga qeveritë populiste, kurrsesi nga feministet.

Politikat e premtuara duhet të analizohen në shumë nivele të perspektivave feministe, për të kuptuar më shumë mbi sfidat e grave punëtore, të atyre që kërkojnë punë dhe të tjerave që janë në shtëpi. Do të ishte tejet kontraproduktive nga cilado qeveri e re nëse do të injoroheshin kontributet e jashtëzakonshme që janë bërë ndër vite nga feministet dhe organizatat e ndryshme për ligjet, politikat dhe strategjitë e veçanta ekzistuese.

Gratë në Kosovë janë të punësuar vetëm 14 për qind, në punë të paqëndrueshme dhe në ekonominë joformale, me diskriminim dhe pagesë të ultë. Joaktiviteti i tyre është shumë i lartë. Më shumë se 75 për qind e grave klasifikohen si "ekonomikisht joaktive". S'mund të ketë prioritet tjetër të parë për kabinetin e ardhshëm qeveritar në raport me mirëqenien e grave.

Përfshirja e feministeve aktiviste dhe organizatave të grave në procesin e dialogut social dhe përcaktimit të politikave e bën më të mundshme që t'u përgjigjen nevojave dhe situatave të ndryshme të grave, si dhe të kontribuojnë në barazinë gjinore.

Qeveria gjithsesi duhet t'i përfshijë në planifikime problematikë që adresohen nga grupet feministe, duke krijuar hapësira të mirëseardhura për dialog social. Një dialog aktiv do të ndihmojë në identifikimin dhe orientimin preciz të përparësive politike dhe institucionale.

Agjenda e re qeveritare duhet ta shfrytëzojë këtë momentum unik për ta transformuar entuziazmin politik dhe votën e grave në adresim konkret të kërkesave të tyre.

Qeveritë ndryshojnë, për dallim nga pushteti i feminizmit aktivist.

Autorja është Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore.



E ardhmja e barabartë në botën e COVID-19



Alia El-Yassir

Dita Ndërkombëtare e Gruas shënohet këtë vit përdërisa bota vazhdon të përballet me pandeminë COVID-19 dhe ndikimet e saj tronditëse në gratë - duke filluar nga shtyrja në varfëri, humbja e vendeve të punës gjersa ekonomia joformale po tkurret e deri te rritja alarmuese e dhunës në familje dhe barra për përkujdesje pa pagesë. Pandemia COVID-19 na ka mësuar diçka të pamohueshme: diversiteti në udhëheqje bën ndryshim dhe reagimi ndaj pandemisë në vendet e udhëhequra nga gratë ka qenë lajmi kryesor në ballina të gazetave. Megjithatë, hulumtimet mbi temën e Ditës Ndërkombëtare të Gruas për këtë vit: "Gratë në udhëheqje: Arritja e të ardhmes së barabartë në botën e COVID-19", tregojnë se vetëm tri vende në botë kanë 50% ose më shumë përfaqësim të grave në parlament. Në aspektin global, 119 vende kurrë nuk kanë pasur grua si kryetare të shtetit ose të qeverisë. Me shkallën e tanishme të përparimit, barazia gjinore në parlament nuk do të arrihet para vitit 2063, në pozitat ministrorë para vitit 2077 dhe në pozitat më të larta të pushtetit para vitit 2150. Gjatë zgjedhjeve të muajit të kaluar, monitorimi i mediave gjatë fushatës zbuloi se kandidatet, përkundër faktit se përbënin 34% të të gjithë kandidatëve në Kosovë, dolën në televizione në vetëm 8% të kohës (46 minuta) krahasuar me 538 minuta të shfaqjes së kandidatëve burra. Me këtë mungesë të grave në tryezën ku merren vendimet, bota thjesht po humbet.

Përkundër udhëheqjes së grave në kaq shumë vende në reagim ndaj COVID-19 dhe rolit mbizotërues të grave si reaguese të para, në vetëm 3.5% të task-forcave për COVID-19 të studiuar në 87 vende kishte barazi gjinore. Në muajt e fundit, 135 vende kanë përforcuar veprimet dhe resurset për të adresuar dhunën ndaj grave si pjesë e reagimit ndaj COVID-19 me shërbime thelbësore më të fuqishme, si strehimore, linja për ndihmë dhe mekanizma të tjerë të raportimit. Megjithatë, nevojitet shumë më shumë. Vetëm 48 vende, më pak se çereku i të analizuarave, po i trajtojnë shërbimet që lidhen me dhunën ndaj grave dhe vajzave si pjesë përbërëse e planeve të tyre kombëtare dhe lokale të reagimit ndaj COVID-19, kurse shumë pak prej tyre mundësojnë financim përkatës për këto masa. Kemi nevojë për veprime të përshtetshme, sepse në vitin 2021 pandemia dhe faktorët tjerë ndikues do t'i shtyjnë më shumë se 47 milionë gra dhe vajza nën kufirin e varfërisë, duke përmbysur kështu përparimin e arritur me dekada për çrrenjosjen e varfërisë së skajshme. Për shkak të përvojave të tyre, udhëheqëset kanë më shumë gjasa të përqendrohen dhe të ndajnë resurse për çështjet që çojnë në rezultate më të mira për të gjithë, siç është dhënia fund dhunës, rritja e qasjes në shërbime si përkujdesja për fëmijët, kujdesi shëndetësor, përparësitë për mjedis, si dhe reagimin ndaj COVID-19. Për shembull, gjatë mandatit të saj të parë si presidente e Liberisë, Ellen Johnson Sirleaf rekrutoi më shumë gra në sektorin e sigurisë dhe të policisë dhe krijoi një gjykatë të specializuar për ndjekjen penale të rasteve të dhunës ndaj grave.


Njëzet e pesë vjet pas Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, e cila përcaktoi objektivat ndërkombëtare për arritjen e barazisë gjinore në vendimmarrje politike, pavarësisht përparimit, gratë ende janë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e udhëheqësisë politike. Sidoqoftë, ekzistojnë mënyra për promovimin e rolit të grave në jetën publike. Sidomos, udhëheqëseve të reja duhet t'u krijojnë mundësi dhe mbështetje për të plotësuar pozitat aktuale të udhëheqjes. Edhe pse të rinjtë përgjithësisht janë më të nënpërfaqësuar në parlamentet nacionale, ka dy herë më shumë burra të moshës 21-40 vjeçare që shërbejnë në parlamente sesa gra të reja të të njëjtës grupmoshë. Ndërtimi i "kapitalit politik" për të arritur pozita të larta udhëheqëse në qeveri merr vite të tëra - dhe si i tillë ky boshllëk gjinor mes udhëheqësve të rinj sot do të reflektohet në mesin e kuadrove të mundshëm të ministrave, presidentëve dhe ambasadorëve të së nesërme, përveç nëse nuk punohet më shumë për këtë. Mund të ndryshojmë dinamikën e pozitave aktuale të udhëheqjes për të ardhme më të barabartë duke i mbështetur udhëheqëset e reja të së sotmes për të vazhduar në ngritjen e shkathësisë të tyre dhe për të krijuar mundësi që të reja të angazhohen në procese politike, institucione, udhëheqje dhe mentorim. Kosova e ka popullatën më të re në Evropë dhe mund ta përdorë këtë mundësi demografike për të shfrytëzuar potencialin e grave të reja dhe për t'i fuqizuar ato që të bëhen pjesë e politikës dhe vendimmarrjes në Kosovë. Shfrytëzimi i potencialit të grave të reja duke iu dhënë mundësi për angazhim dhe pjesëmarrje domethënëse në vendimmarrje ka rëndësi të jashtëzakonshme për trajektoren pozitive dhe paqësore të Kosovës.

Pandemia COVID-19 ka përkeqësuar pabarazinë ekzistuese gjinore dhe ka prishur mekanizmat për përballje. Siç tregohet në dy vlerësimet

e shpejta të ndikimit socioekonomik nga COVID-19 në Kosovë, të bëra nga organizatat UN Women, UNDP dhe UNFPA, pandemia ka pasur ndikim gjinor përmes rritjes së papunësisë, varfërisë së rënduar, humbjes së vazhdueshme të të ardhurave, pasigurisë për punësim, rritjes së dhunës në familje dhe vështirësive për gratë për qasje në shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese. Por, kriza mund të shihet edhe si mundësi për të nxirur rinegocimin e kontratave shoqërore dhe për ta vënë pjesëmarrjen domethënëse të grave në jetën publike dhe ndërtimin e paqes në ballë dhe qendër të përpjekjeve të përbashkëta. Proceset efektive të ndërtimit të paqes mund të orientohen drejt "ndërtimit më të mirë" të një shoqërie më të drejtë, më të barabartë dhe më gjithëpërfshirëse, e cila do të shërbejë si mburojë që në të ardhmen mos të lejohet përsëritja e konflikteve. Gjatë shumë viteve të angazhimit, organizata UN Women, përmes programeve të saj ka bërë bashkë gratë dhe të reja e komuniteteve të ndryshme dhe ka forcur aftësitë e tyre udhëheqëse dhe ndikimin në ndërtimin e paqes. Tani, me sfidat e imponuara nga pandemia COVID-19, udhëheqja e tyre nevojitet si kurrë më parë për të ndërtuar të ardhme më të mirë, më të gjelbër dhe më të barabartë.

Viti 2021 paraqet mundësi të madhe për avancimin e mundësive për udhëheqje për gratë dhe vajzat. Gjersa COVID-19 na detyron të rimendojmë mënyrën se si funksionojnë shoqëritë tona dhe përdërisa barazia gjinore zë vendin kryesor në Forumin e Barazisë së Brezit në Meksikë dhe Paris, ne e kemi mundësinë për të siguruar pjesëmarrje dhe vendimmarrje të plotë dhe efektive të grave në jetën publike, prej shtëpisë e deri te zyrat e bordeve.

Autorja është Drejtore Regjionale e UN Women për Evropë dhe Azi Qendrore.



Shekulli i barazisë së grave



Carin Lobbezoo

Kur Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, António Guterres, një feminist i vetëshpallur, foli para një viti në Universitetin New School të Nju Jorkut, ai tha që shekulli 21 duhet të jetë shekulli i barazisë së grave. Guterres theksoi se barazia gjinore në thelb është çështje e pushtetit. Pajtohem plotësisht me të. Nëse doni të nxisni ndryshime pozitive për gratë dhe vajzat, gratë duhet të jenë në sallat e bordeve, parlamenteve dhe qeverive duke marrë vendime që ndryshojnë jetën e grave dhe vajzave. Të jesh aty dhe të sigurohesh që gratë dhe vajzat të bëhen pjesë e diskutimit do të thotë që strukturat e pushtetit do të ndryshojnë dhe do të arrihet më shumë barazi.

Qartazi, kjo nuk është një detyrë e lehtë, por fillon me gratë që bëhen shumë më të dukshme si në jetën politike, ashtu edhe në biznes. Për të dalë në ballë, gratë duhet të ndjehen të sigurta për të marrë pjesë në mënyrë aktive në vendimmarrje. Për këtë, ato jo vetëm që duhet të arsimohen, por edhe të mësojnë aftësitë që iu ndihmojnë atyre për të bërë ndryshim. Të jem më e saktë: të dish të luftosh për vendin që të takon, si ta promovosh veten dhe punën që bën dhe ku të kërkesha mbështetje për t'i arritur qëllimet e tua. Këto vegla të rëndësishme do të ndihmojnë në kapërcimin e të keqes dhe ta thyejnë bindjen e kamotshme për rolin e grave në shoqëri. Është diçka që mua si diplomate më është dashur ta mësoj në karrierën time. Edhe unë vendosa të punoj në një profesion ende të dominuar nga burrat. Edhe unë duhej të punoja dyfish më shumë për të provuar se isha po aq e aftë t'i mbroja pikëpamjet e mia në negociatat ndërkombëtare si kolegët e mi burra. Edhe unë (edhe sot e kësaj dite) has në njerëz që më pyesin çfarë bën burri im në ambasadë.

Të kesh një kuti veglash plot aftësi ndihmon në trajtimin e pengesave praktike. Por, nuk mjafton. Gratë gjithashtu kanë nevojë për shembuj me të cilat mund të identifikohen dhe që sigurojnë frymëzim duke treguar se gjërat mund të bëhen ndryshe. Si studente aspiruese, pashe profesoreshen time të ardhshme të historisë duke shpjeguar me pasion pse kursi i saj ishte një domosdoshmëri absolute kur u regjistrua në Universitetin Leiden. Ajo më bëri përshtypje të madhe dhe më kujtohet që mendova: "Dua të bëhem si ajo". Gjatë karrierës sime kam takuar shumë gra si ajo, të cilat në mënyrë të ngjashme më kanë frymëzuar të bëj gjëra të cilat në shikim të parë dukeshin të paarrtshme.

Jam krenare që me projektet të cilat i mbështesim ne mund të kontribuojmë në fuqizimin e grave sipërmarrëse dhe politikane (përfshirë të ardhshmet) në Kosovë. Ne synojmë t'i ndihmojmë gratë të arrijnë potencialin e tyre të plotë, të lëvizin ndryshime nga të cilat do të përfitojnë dhe do të frymëzohen gra dhe vajza të tjera. Me fjalë të tjera, që t'i pajisim me njohuri, vegla dhe shembuj për t'u dhënë një vend në tavolinën ku merren vendimet. Vendime që në të njëjtën kohë nxjerrin në pah përfitimet e barazisë gjinore.

Barazia gjinore nuk është vetëm gjëja e duhur për të bërë: është

gjëja e arsyeshme për të bërë. Gratë përbëjnë të paktën 50% të potencialit total të çdo vendi. Investimi në gra është një nga investimet më të zgjuara që dikush mund të bëjë. Duke edukuar gra dhe vajza, ne po investojmë në mijëra mjeke, punonjëse të kujdesit shëndetësor, sipërmarrëse, politikane, mësuese, shkencëtare, të cilat me talentet e tyre do të kontribuojnë për ta çuar vendin përpara. Studimet vazhdimisht tregojnë se kur gratë punojnë dhe fitojnë të ardhurat e tyre, familjet e tyre përparojnë në të gjitha sferat. Investimi në gra jo vetëm që përdor mirë të gjitha talentet në dispozicion, por është edhe investim në të ardhmen tonë kolektive.

Përveç kësaj, kur rritet numri i grave në politikë dhe biznes, automatikisht rritet edhe shumëllojshmëria. Kjo çon në më shumë larmi mendimesh. Në fund të fundit, gratë dhe burrat e shikojnë botën ndryshe. A është ky problem? Jo, aspak, është pasuri. Kërkimet kanë treguar se ekipet e larmishme në çdo profesion marrin vendime më të ekuilibruara. Ato gjithashtu arrijnë rezultate më të mira, nga të cilat përfitojnë të gjithë.

Mund të mendoni se e gjithë kjo është shumë mirë, por situata në Kosovë nuk qëndron ashtu. Unë prirem të mos pajtohem. Çdo ditë takoj gra të cilat më frymëzojnë dhe që - si unë - kanë një shtytje të madhe për t'i kapërcyer pengesat dhe idetë e paracaktuara. Ato duan të bëjnë ndryshim në fushat e tyre përkatëse të punës. Edhe pse kjo nuk është gjithmonë e lehtë, ato janë të përkushtuara dhe të apasionuara pas punës së tyre, shfrytëzojnë shanset e tyre, përdorin talentet e tyre në formën më të mirë të mundshme, kanë mendimet e tyre, janë të ekuilibruara dhe dinë çfarë duan. Ato po trokasin në derë dhe duan t'i ndryshojnë strukturat ekzistuese të pushtetit në mënyrë që këto të funksionojnë për to dhe për ato gra dhe vajza që kanë qenë me më pak fat. Këto gra meritojnë mbështetje tonë ashtu siç e kemi pasur ne më parë. Tani është radha jonë (dhe radha ime) të udhëheqim me shembullin tonë dhe të jemi frymëzimi për gratë dhe vajzat që t'i kapërcëjnë kufijtë, që t'i përdorin talentet e tyre dhe që ta përmbyshin potencialin e tyre të vërtetë.

Nëse kam mësuar një gjë ajo është se mund të arrihen ndryshime të shpejta për gratë dhe vajzat. Para dhjetë vitesh vështirë që dikush në Holandë ndiqte ndeshjet e ekipit tonë kombëtar të futbollit për femra. Njerëzit qeshnin me gratë që dëshironin të luajnë futboll garues dhe kurrë në të vërtetë nuk e morën seriozisht këtë sport. Sidoqoftë, një numër i njerëzve vizionarë në Federatën e Futbollit vendosën ta injorojnë ndjenjën e përgjithshme dhe filluan të investojnë në zhvillimin e lojtareve të reja. "Luaneshat e Portokallta" fituan Kampionatin Europian në vitin 2017 dhe ishin nënkampione në Kampionatin Botëror të Grave në vitin 2019. Tani lojërat e tyre transmetohen drejtpërdrejt në televizionin kombëtar dhe kompani të mëdha sponsorizojnë ekipin. Gjatë rrugëtimit, Lieke Martens dhe Vivianne Miedema (që luajnë për Barcelonën dhe Arsenalin), kanë frymëzuar qindra vajza holandeze të merren me këtë sport dhe të bëhen futbolliste profesionale.

Kështu duket ndryshimi. Le ta bëjmë shekullin 21 vërtet shekull të barazisë së grave. Unë jam gati për këtë dhe shpresoj që je edhe ti.

Autorja është Ambasadore e Mbretërisë së Holandës në Republikën e Kosovës.

Fuqizimi i grave në dialogun për të ardhmen Pse po luftojmë?



Sonja Biserko

Gjatë vitit të pandemisë, udhëheqëset politike dëshmuar se ishin shumë më të afta se homologët e tyre burra. Kjo edhe njëherë vuri në pah nevojën për barazi gjinore më të madhe në rolet udhëheqëse. Fatkeqësisht, hulumtimet e reja ndërkombëtare tregojnë se nuk është bërë shumë përparim për t'i ndryshuar qëndrimet publike lidhur me këtë.

Qeveritë anëmbanë botës janë përqendruar si t'i rikthehen normalitetit pas pandemisë. Kjo pikërisht paraqet mundësinë për ta marrë seriozisht parasysh faktin se gratë janë të nënpërfaqësuar në pozitë udhëheqëse, sepse pa këtë nuk mund të kemi shoqëri të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta të njeriut. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për sfidat e epokës së re. Pjesëmarrja e grave në politikë nuk është e mundur pa pjesëmarrjen e tyre në të madhe në partitë politike dhe në pozita udhëheqëse për të mundësuar përfshirje më të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes. Promovimi i barazisë së grave në parti njëkohësisht paraqet promovimin e tyre në tërë shoqërinë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta të njeriut. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për sfidat e epokës së re. Pjesëmarrja e grave në politikë nuk është e mundur pa pjesëmarrjen e tyre në të madhe në partitë politike dhe në pozita udhëheqëse për të mundësuar përfshirje më të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes. Promovimi i barazisë së grave në parti njëkohësisht paraqet promovimin e tyre në tërë shoqërinë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta të njeriut. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për sfidat e epokës së re. Pjesëmarrja e grave në politikë nuk është e mundur pa pjesëmarrjen e tyre në të madhe në partitë politike dhe në pozita udhëheqëse për të mundësuar përfshirje më të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes. Promovimi i barazisë së grave në parti njëkohësisht paraqet promovimin e tyre në tërë shoqërinë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta të njeriut. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për sfidat e epokës së re. Pjesëmarrja e grave në politikë nuk është e mundur pa pjesëmarrjen e tyre në të madhe në partitë politike dhe në pozita udhëheqëse për të mundësuar përfshirje më të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes. Promovimi i barazisë së grave në parti njëkohësisht paraqet promovimin e tyre në tërë shoqërinë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta të njeriut. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për sfidat e epokës së re. Pjesëmarrja e grave në politikë nuk është e mundur pa pjesëmarrjen e tyre në të madhe në partitë politike dhe në pozita udhëheqëse për të mundësuar përfshirje më të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes. Promovimi i barazisë së grave në parti njëkohësisht paraqet promovimin e tyre në tërë shoqërinë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta të njeriut. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për sfidat e epokës së re. Pjesëmarrja e grave në politikë nuk është e mundur pa pjesëmarrjen e tyre në të madhe në partitë politike dhe në pozita udhëheqëse për të mundësuar përfshirje më të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes. Promovimi i barazisë së grave në parti njëkohësisht paraqet promovimin e tyre në tërë shoqërinë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta të njeriut. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për sfidat e epokës së re. Pjesëmarrja e grave në politikë nuk është e mundur pa pjesëmarrjen e tyre në të madhe në partitë politike dhe në pozita udhëheqëse për të mundësuar përfshirje më të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes. Promovimi i barazisë së grave në parti njëkohësisht paraqet promovimin e tyre në tërë shoqërinë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta të njeriut. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për sfidat e epokës së re. Pjesëmarrja e grave në politikë nuk është e mundur pa pjesëmarrjen e tyre në të madhe në partitë politike dhe në pozita udhëheqëse për të mundësuar përfshirje më të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes. Promovimi i barazisë së grave në parti njëkohësisht paraqet promovimin e tyre në tërë shoqërinë.



Renata Mienkowska-Norkiene

Në një nga mbishkrimet gjatë protestave të grave në Poloni, në tetor 2020, thuhej se po të ishin meshkujt shtatzënë, aborti do të rimburohej nga shteti. Për të qeshur? Më shumë tmerruese, sepse tregojn se problemi i abortit, i cili zgjon emocione të mëdha pothuajse çdoherë që shfaqet në agjendën politike, lidhet me një problem shumë më serioz, përkatësisht me nënpërfaqësimin e rëndësishëm politik të grave, i cili përkeqësohet në pjesëmarrjen e kufizuar të tyre në formësimin e agjendës politike dhe sigurimin e përfaqësimit të duhur të interesave të grave në shoqëri. Polonia mund të konsiderohet shembull jashtëzakonisht i qartë i nënpërfaqësimit të grave në qeveri (1 nga 21 anëtarë të qeverisë), në parlament (155 nga 560 anëtarë të Dhomës së Ulët – Sejm, dhe Senatit), por mbi të gjitha në fushën e formësimit të kulturës politike polake (pra, fuqizimin e mjaftueshëm gjinor në shoqëri për të ndryshuar realitetin shoqëror, ekonomik dhe politik në nivele të shumta të jetës publike.

Kultura udhëheqëse mënyrën e të menduarit rreth roleve të grave dhe burrave në shoqëri, kurse këto role në Poloni shikohen nga aspekti i kufizimit tradicional. Sipas rezultateve të hulumtimit të opinionit publik nga Eurobarometer (në vitin 2019), në vendet e BE-së, si Bullgaria, Hungaria, Polonia, Republika Çeke, Lituania apo Sllovakia, shumica dërmuese e të anketuarve theksuan rolin e madh të grave në përkujdesjen për familje dhe shtëpi, përdërisa në Suedi vetëm 11% e të anketuarve zgjedhën këtë rol. Gjithashtu, ndikimi i madh i kishës ndërlidhet me pabarazinë gjinore dhe fuqia e Kishës Katolike në Poloni ka qenë e madhe që nga rënia e komunizmit. Përveç kësaj, kjo fuqi është rritur prej vitit 2015, sepse partia Ligji dhe Drejtësia ka mbështetur politike të Kishës Katolike. Duke pasur parasysh të gjitha këto, nuk është befasi që është rritur zhgënjimi i një mase të madhe të grave (veçanërisht të reja), ndërsa zemërimi i tyre shpërtheu pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Polonisë – të emëruar në mënyrë të jashtëligjshme – më 22 tetor 2020, për ndalesën pothuajse të plotë të abortit. Deri atëherë, sipas të ashtuquajturit “Kompromis të abortit” të vitit 1993, ndërprerja e shtatzënisë në Poloni ishte e ligjshme në tri raste:

- 1) Nëse jeta e nënës ishte në rrezik,
- 2) Nëse shtatzënia ishte rezultat i dhunimit,
- 3) Nëse fetusi kishte defekte kongjenitale të pakthyeshme.

vendimmarrëse dhe në thyerjen e pengesave të politikave të përqendruara në etni.

Situata në Ballkanin Perëndimor ende është e ngarkuar nga trashëgimia e luftërave të viteve të 1990-a, si dhe nga një proces shumë i ngadalshëm i transformimit demokratik dhe stabilitetit rajonal. Duhet të nënvizohet se e gjithë kjo ka pasojat të thella për tërë rajonin dhe ndikon shumë në të gjitha segmentet e shoqërisë.

Pavarësisht rëndësisë së Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e kaluara e afërt ende nuk është adresuar siç duhet dhe kjo pengon normalizimin dhe pajtimin. Mekanizmat e drejtësisë tranzicionale prodhojnë rezultate shumë të kufizuara.

Përgjegjësia për krimet e luftës ndaj grave, trafikimi, problemet e shëndetit riprodhues dhe arsimimi i vajzave, vazhdon t'i përmjekë vendet e konfliktit dhe postkonfliktit.

Organizatat e shoqërisë civile të grave, e veçanërisht mbrojtësit e të drejtave njerëzore si grave, kanë qenë në ballë të luftës për mbrojtjen e të drejtave të grupeve të ndjeshme – refugjatëve, pakicave, femijëve dhe grave në përgjithësi.

Zbatimi i Rezolutës 1325 i Këshillit të Sigurimit të OKB-së është pjesë përbërëse e reformës në sektorin e sigurisë që vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë ndërmarrë apo janë në proces të ndërmarrjes.

Abuzimi i tmerrshëm i të drejtave të grave gjatë luftërave është përcjellë me rritimin e të drejtave të tyre aktuale ekonomike dhe shoqërore si pasojë e masave rigorozë (mbrojtja sociale, kundesit shëndetësor, përkujdesja për femijë) të marra në krizën e tanishme ekonomike dhe financiare. Ky rënie është shtuar edhe më shumë nga imponimi i vlerave tradicionale (krjesist fetare) në disa pjesë të rajonit, duke i përjashtuar gratë nga jeta publike dhe politike.

Përveç fundamentalizmit fetar, patriarkati dhe nacionalizmi etnik janë bërë bashkë për të formuar një sistem të ri të vjetër vlerash. Ky trend anti-bashkëkohor deri diku ka qenë i pranishëm në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë, por veçanërisht ka ardhur në shprehje në zonat ru-

rale. Ai praktikisht përjashton çfarëdo roli të grave në sektorin e sigurisë dhe kufizon mundësitë e tyre në një shoqëri më të gjerë.

Organet gjyqësore shtetërore ende nuk e kanë adresuar siç duhet dhunën kundër grave (dhunimin në masë, spastrimin etnik, të gjitha llojet e privimeve) gjatë viteve të 1990-ta. Edhe ky fakt mund të luajë rol negativ në përballjen kundër dhunës dhe brutalitetit ndaj grave në shoqëritë bashkëkohore të Ballkanit Perëndimor.

Meqenëse shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor ende nuk janë konsoliduar si demokraci të qëndrueshme, bashkëpunimi rajonal në fushën e sigurisë akoma mungon. Fakti që disa prej këtyre vendeve ende kanë aspirata territoriale ndaj fqinjëve të tyre e vështirëson edhe më shumë situatën.

Në këtë kontekst kaq të vështirë e të brishtë politik dhe të sigurisë, nuk është për t'u çuditur që gjatë dekadës së fundit shumica e çështjeve thelbësore për krijimin e shoqërive të drejta dhe demokratike – duke filluar nga sjellja para drejtësisë e kriminelëve të luftës, lufta kundër korrupsionit, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe të pakicave e deri te parandalimi i diskriminimit dhe dhunës kundër grave për të siguruar barazi gjinore – janë prekur në kuadër të procesit të përafritimit në BE (dhe NATO) dhe pajtueshmërisë me kriteret politike dhe kushtet tjera për anëtarësim në BE.

Roli transformues i BE-së dhe NATO-s ka sjellë masë të paqes dhe stabilitet në rajon, por asnjëra prej tyre nuk duhet të merren si të nënkuptueshme. Në këtë drejtim, angazhimi më i madh i grave në përpjekjet për konsolidimin e vendeve të tyre si shtete demokratike funksionale ka qenë shumë i rëndësishëm.

Duke marrë parasysh gjithë këtë, përfshirja e grave në dialogun Beograd-Prishtinë ka rëndësi të jashtëzakonshme, sepse në dialog mungon perspektiva, përvoja dhe të kuptuarit e botës nga pikëpamja e grave.

Autorja është aktiviste për të drejtat e njeriut dhe kryetare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi.

Protestat e grave në Poloni si burim i ndryshimit shoqëror dhe politik

Kushti i fundit prek deri në 98% të të gjitha rasteve ligjore të aborteve dhe Gjykata Kushtetuese e konsideroi antikushtetues. Kjo e bëri Poloninë ndër vendet me rregulloret më të rrepta për abort në botë. Në mungesë të mjeteve të tjera të ndikimit politik, gratë polake dhe mbështetësit e tyre dolën në rrugë për të protestuar kundër kufizimeve të të drejtave të tyre dhe kundër sakrificimit të tyre për ujditë jozyrtare të partisë në pushtet dhe udhëheqës të saj, Jaroslaw Kaczy ski me Kishën Katolike dhe organizatat fundamentale radikale katolike si Ordo Luris, ndikimi i të cilave në institucionet qeveritare, gjykata dhe administratën publike po rritet gjithnjë e më shumë. Gratë në Poloni – të privuara nga qasja në shërbime gjinekologjike gjatë pandemisë dhe të ekspozuara më shumë se zakonisht ndaj dhunës në familje, dhunimit dhe shtatzënisë së padëshiruar – vendosën të protestonin kundër shkeljes së të drejtës së tyre për trajtim njerëzor dhe dinjtet. Megjithatë, brenda disa ditëve protestat morën përmbajtje shtesë kundër qeverisë, kundër kishës dhe kundër diskriminimit në kuptim më të gjerë.

Sipas të gjitha gjasave, Jaroslaw Kaczy ski me qëllim i nxori njerëzit në rrugë. Marrja e vendimit për ndalesën pothuajse të plotë pikërisht kur Polonia çdo ditë po shënonte rekorde të reja të rasteve me COVID-19 ndoshta i është dukur si situatë ku ai fitonte gjithsesi: nëse gratë do të kishin frikë nga virusi dhe nuk do të dilnin në rrugë – nuk do të kishte asnjë pasojë të dhimbshme për partitë në pushtet, nëse do të organizonin protesta në kohë pandemie – kjo do të paraqiste arsyetim të lehtë për t'i akuzuar për rritjen e numrit të të infektuarve dhe për të përhapur këtë akuzë në televizionin publik, i cili është plotësisht në vartësi të partisë në pushtet. Megjithatë, duket se Jaroslaw Kaczy ski kishte nënvlerësuar nivelin dhe shkallën e këtij shpërthimi të pakënaqësisë që mobilizoi rreth një milion polakë. Atë gjithashtu e befasoi vendosmëria e protestuesve dhe gjuha vulgare që ato përdorën qëllimisht. Shumica e demonstruesve të reja përdorën parulla si: “Fuck off”, “Fuck PiS” (gjithashtu të shkruar edhe me simbole: ***** ***)

Sipas anketave të opinionit publik të realizuara në fund të 2020 (p.sh. të Kantar), më shumë se 70% e polakëve i mbështetën protestat e grave dhe 13% e tyre morën pjesë në to. Veçori e

posaçme e protestave ishte pjesëmarrja e madhe e banorëve të qytezave dhe madje edhe të fshatrave. Po ashtu, për herë të parë në historinë bashkëkohore të Polonisë, protestuesit thyen tabunë se kishat janë të paprekshme dhe ndërprenë meshat, ngjyrosën muret e kishave dhe përdorën parulla të rënda kundër Kishës. Kjo ishte arsyeja që e bëri Jaroslaw Kaczy ski-n të shfaqej në një video të shkurtë në Facebook, ku akuzoi gratë për sharje dhe iu bëri thirrje përkrahësve të partisë në pushtet për t'i mbrojtur kishat me çdo kusht. Kjo i provokoi grupet e krahut ekstrem të djathtë për të mbajtur kundër-protesta dhe madje edhe për t'i sulmuar protestuesit. Gjithashtu, aparati policor turpshëm u angazhua dhe u nxit nga partia në pushtet për t'i trajtuar protestuesit në mënyrë të ashpër dhe për t'i dënuar (jashtëligjshëm) me gjopa.

Kështu, situata e grave në Poloni kohëve të fundit ka qenë mjaft specifike. Në njërën anë, të drejtat e tyre riprodhuese janë kufizuar në mënyrë domethënëse ndërsa pandemia ka kontribuar në përkeqësimin e situatës në familjet e tyre dhe në tregun e punës, megjithatë, në anën tjetër, në pah doli zemërimi i tyre i grumbulluar dhe potenciali për ta ndryshuar realitetin shoqëror dhe politik në të mirë të të drejtave të grave. Udhëheqëset e protestave janë përpjekur shumë për t'i parandaluar politikanët opozitarë për ta përdorë praninë e tyre në demonstrata për interesat e tyre të posaçme, duke mos i miratuar kërkesat e protestuesve. Organizatorët e protestave më shumë folën për idetë e komitetëve dhe këshillave socialë sesa për bisedimet me politikanët opozitarë lidhur me mundësinë e veprimit politik.

Populli thotë: “Uji zhibron gurin”. Anketat e fundit të opinionit publik (në 2021) tregojnë se çështja e abortit ka rëndësi të madhe për shumicën dërmuese të polakeve të reja në zgjedhjet e tyre politike. Duke marrë parasysh faktin se shumica e tyre zgjedhin liberalizim të plotë të ligjit për abortin, ato mund të jenë pika e fundit që do të kontribuojë në shkatërrimin e rendit të vjetër politik konservativ në Poloni dhe marrjen e pushtetit prej partisë populiste të Jaroslaw Kaczy ski-t. Edhe pse duhet ta pranojmë se ky është skenar mjaft optimist.

Autorja është profesore në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Studimeve Ndërkombëtare në Universitetin e Varshavës.

Maida Omerćehajić



Statistikat globale nuk gënjëjnë: anëmbanë botës kemi një deficit shkatërrues dhe të vazhdueshëm të grave në politikë. Ciklet elektorale vijnë dhe shkojnë dhe nga ne pritët të jemi të kënaqura, e madje t'i festojmë edhe ato pak arritje, nëse ka, në përqindjet e grave të emëruara si ministre në qeveri, të zgjedhura si përfaqësuese në kuvende ose të përfshira në çdo formë të strukturave udhëheqëse. Edhe kur kemi të arritura të tilla, prapëseprapë gratë shpesh nuk arrijnë të ushtrtojnë ndikimin e tyre të vërtetë politik. Në ato sisteme që përmbajnë dispozita ligjore të kuotës për sigurimin e përfaqësimit të grave këto rregulla kryesisht injorohen dhe duket se zgjidhen duke paguar gjoja simbolike për shkak të dështimit për t'iu përmbajtur kuotave. Sot dhe përditë duhet ta mbajmë në mend: kjo nuk mjafton.

Duket se stereotipat e rrënjësor thellë të roleve gjinore tradicionale për gratë në sferën publike veçe janë përforcuar më shumë. Partitë politike përfshijnë në listat e tyre statusin martesor dhe numrin e femijëve vetëm për kandidatet, thuaja se ato rrethana disi dëshmojnë që ato janë të denja për votat e qytetarëve. Në vend se të përqendrohen në platformën politike të grave, gazetat, portalet në internet dhe kanalet televizive organizojnë zgjedhje simuluese paralele për “Missin e Zgjedhjeve”. Përndryshe, gratë janë pothuajse tërësisht të padukshme në fushatat zgjedhore; madje edhe nëse zgjidhen, atyre nuk iu jepet hapësirë e mjaftueshme për të dhënë kontributin e tyre përmbajtësor. Gratë vazhdimisht dhe gabimisht perceptohen si tepër të dobëta për t'u përballur me përgjegjësinë e pushtetit, si dhe shumë emotive për të marrë vendime të rëndësishme.

Pandemia globale që na kaploi vitin e shkuar edhe njëherë e dëshmoi se gratë janë reaguesat e para në kohë krize. Eshhtë e pamundur të shpërfilltet bollëku i profesioneve të mbizotëruara nga femrat, të cilat kanë qenë esenciale në luftën kundër pandemisë dhe punën e jashtëzakonshme të aktivisteve dhe organizatave të shoqërisë civile të grave. Trimeria dhe përkushtimi i grave për përmirësimin e shoqërisë, veçanërisht në kohë krize, është dokumentuar dhe nganjëherë ato madje janë vlerësuar dhe lavdëruar publikisht, por legjitimiteti ynë për të marrë pjesë në hartimin dhe marrjen e vendimeve që ndikojnë në jetën tonë të përditshme kurrë nuk është materializuar sa duhet.

E pse pra ende vazhdojmë të luftojmë? Përgjigja është e thjeshtë: është e drejta jonë, por mbi të gjitha – është detyra jonë.

Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së botës dhe kanë të drejtë për pjesëmarrje dhe angazhim të plotë e të barabartë në vendimmarrje për të gjitha çështjet, veçanërisht ato që na prekin drejtpërdrejt. Përfaqësimi i barabartë politik ju vetëm që ofron këndvështrimin e domosdoshëm të grave për të gjitha çështjet me të cilat përballlet shoqëria, por gjithashtu kontribuon duke iu dhënë rëndësi kaq të nevojshme çështjeve që i prekin vetëm gratë. Gratë duhet të pranohen dhe të njihen si aktere të afta dhe të besueshme në proceset politike.

Partitë politike, si ndërmjetësuere në procesin demokratik politik, duhet të mbështesin dhe promovojnë fushatat zgjedhore të grave dhe t'i përfshijnë ato në strukturat e tyre udhëheqëse. Përmes krijimit dhe zbatimit efektiv të legjislativitetit dhe politikave të barazisë gjinore, shtetet duhet të krijojnë hapësirë të sigurt ku gratë inkurajohen për t'u angazhuar dhe përfshirë në mënyrë përmbajtësore, si përmes përfshirjes së tyre aktive, ashtu edhe përmes hedhjes së votës së lirë për përfaqësuesit e tyre të zgjedhur. Jo vetëm që kemi nevojë për standarde të përgjithshme që garantojnë barazi gjinore, por para se të miratohen të gjitha ligjet dhe politikat e tjera ato duhet të përfshijnë edhe perspektivën gjinore, të shoqëruar me një analizë të plotë të nevojave të grave. Eshhtë e papranueshme që barazia gjinore të mbetet vetëm deklaratë politike boshe dhe e papërmbyshur.

Në fund, është e rëndësishme të mbajmë në mend se respektimi i pjesëmarrjes së barabartë në jetën politike mund të arrihet vetëm nëse pasqyruan respektimin e plotë të parimeve të barazisë gjinore në të gjitha aspektet e shoqërisë. Gratë nuk duhet të jenë të vetmet që e marrin përgjegjësinë për të siguruar dhe promovuar barazinë gjinore në politikë dhe në të gjitha format e tjera të vendimmarrjes – kjo duhet të jetë detyrë e shoqërisë si tërësi. Tani më shumë se kurrë është e rëndësishme të vazhdohet puna për rritjen e ndërgjegjësimit, promovimit dhe edukimit për barazi gjinore. Nëse vërtet duam të arrijmë trajtim dhe mundësi të barabarta në të gjitha aspektet, përfshirë edhe në politikë, duhet të bëhen ndryshime rrënjësore dhe të njmëndta në perceptimin dhe qëndrimet e shoqërisë.

Prandaj, ne do të vazhdojmë të luftojmë për një shoqëri ku lulëzimi i grave në politikë dhe në të gjitha fushat tjera do të jetë rregull, e jo përjashtim. Do të vazhdojmë të luftojmë për një shoqëri me mundësi të barabarta, pa stereotipa dhe pa diskriminim, ku interesat e grave pranohen dhe respektohen plotësisht. Gratë nuk po kërkojnë asnjë lloj trajtimi të veçantë – ne po kërkojmë barazi. Jepjani grave mundësinë që të flasin dhe të na dalin krah në të gjitha ato vende ku zëri ynë me të vërtetë mund të dëgjohej. Kemi shumë për të thënë.

Autorja është Këshilltare Ligjore në organizatën “Të Drejta për të Gritë” (Prava za sve - Rights for All), në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Margjinalizimi i dyfishtë i grave në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19



Judita Krasniqi

Pandemia e COVID-19 nuk e ka goditur vetëm shëndetin. Në nivel global, pandemia e SARS-Cov-2 ka nxjerrë në pah shkallën e lartë të pabarazive sociale, gjendjen e rëndë të grupeve të marginalizuara, si dhe thellësinë e pabarazisë gjinore. Ato që u goditën më së rëndi ishin shtetet e varfra dhe grupet e marginalizuara, ku pothuajse gjithmonë janë edhe gratë.

Në Kosovë, gratë ishin gjithmonë pjesë e marginalizuar e shoqërisë.

A ekziston një periudhë historike në Kosovë kur gratë ishin pjesë e barabartë e shoqërisë? Literatura, hulumtimet, të dhënat statistikore të Kosovës së paralutës dhe të pasluftës, gjithmonë e pasqyrojnë gruan si kujdestare të shtëpisë e të fëmijëve, duke iu dhënë vend dytësor në shoqëri e në familje. Krugëtimi i grave për pjesëmarrje në jetën politike dhe vendimmarrje gjykohe dhe parajykohe, duke i stigmatizuar gratë të cilat bëjnë përpjekje për barazi në shoqëri, e duke e dekuruar pjesën tjetër të grave të cilat i shikojnë vuajtjet e grave të tjera dhe humbin guximin për të ndërmarrë ndonjëherë një hap drejt kërkesës për të drejtat e tyre. Grave u përshkruhen e parashkruhen detyrat shtëpiake dhe familjare si obligime të tyre, mirëpo edhe nga familja e shtëpia janë të përjashtuara, duke i përjashtuar nga e drejta e barabartë e trashëgimisë.

Pandemia e COVID-19 në vendet e zhvilluara ka rrezikuar progresin drejt barazisë gjinore, por jo edhe në Kosovë, ku diskriminimi ndaj grave s'kishte se si të rritej më shumë. Në vendin tonë kriza dhe kaosi i shkaktuar nga emergjenca shëndetësore në fillim të vitit 2020 e zbuloi gjendjen e vërtetë të grave në tregun e punës, në shoqëri dhe familje, si dhe zbuloi të vërtetën e neglizhencës ndaj grave nga institucionet shtetërore, madje neglizhencën e qëllimshme. Për më tepër, u vërtetua edhe njëherë se çështjet që kanë të bëjnë me jetën e grave në Kosovë, si pjesëmarrja në tregun e punës dhe punësimi i grave, dhuna në familje e mirëqenia e gruas në Kosovë, janë terma me të cilat shoqëria dhe institucionet merren vetëm atëherë pasi të jenë zgjidhur të gjitha problemet tjera në vend. Prandaj, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, në vend që të listohen arritjet dhe progresi i shënuar drejt barazisë dhe të drejtave të gjysmës së popullsisë në Kosovë, e gjitha çka mund të listojmë fatkeqësisht janë emrat e grave të vrara nga burrat e tyre, të cilët ose nuk u dënuan kurrë, ose dënimet e tyre u reduktuan, u konsideruan "shumë të rënda" për vrasjen e një gruaje. Në vitin 2021 ne akoma përpjetojmë për të drejtat elementare që janë të garantuara me ligje vendore dhe konventa ndërkombëtare, por vënia në praktikë e tyre nuk duket askund në horizontin e të ardhmës.

Se gratë në Kosovë ishin skajshmërisht të marginalizuara para shfaqjes së pandemisë COVID-19 e dëshmojnë fillimisht statistikave e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Statistikat e fundit tregojnë se 78.5% e grave në moshë pune në Kosovë janë joaktive, 31% e tyre janë të papuna kurse vetëm 14% e tyre janë të punësuar. Në fakt, që nga viti 2015, përqindja e grave joaktive ishte 79%-81% që tregon se dëshpërimi i thellë, zhgënjimi dhe dorëzimi i grave para këtij diskriminimi të padrejtë ka filluar shumë kohë para se të shfaqej virusi SARS-Cov-2. Edhe gratë e punësuar, pjesa më e

madhe janë të koncentruara në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, kurse në sektorët tjerë gratë kanë përfaqësim minimal, apo nuk marrin pjesë fare, që dëshmon për ndarjen e thellë gjinore të ekonomisë në Kosovë, bazuar në definicionet patriarkale të "punëve për burra dhe punëve për gra". Këto të dhëna gjithashtu tregojnë se Kosova qëndron e fundit në listën e shteteve të Ballkanit Perëndimor për kah pjesëmarrja e grave në tregun e punës, që gjithashtu tregon se gratë në Kosovë janë më të diskriminuara në rajon.

Çka në të vërtetë është marginalizimi dhe pse gratë në Kosovë jo vetëm që nuk arrijnë asnjëherë të dalin nga margjinat, por gjatë pandemisë së COVID-19 përjetuan marginalizim të dyfishtë e të shumëfishtë?

Janë tre faktorë kryesorë, të njëjtë për nga natyra, e që nuk dihet se cili nga këta i paraprin tjetrit, apo cili është më fajtor se tjetri.

I pari është sistemi patriarkal dhe mendësia tradicionale e shoqërisë në Kosovë, e cila ka arritur të modernizohet dhe ndryshohet në shumë aspekte, por kursesi nuk po arrin ta ndërrojë perceptimin dhe dëshirën për diskriminimin e gruas. Duke filluar nga familja, shkollat, universitetet, shoqëria e institucionet, barazia e gruas shihet si proces që "duhet ta pranojmë me zor" e jo si vlerë shoqërore e njerëzore. Edhe atëherë kur shoqëria "e ka pranuar" shkollimin dhe punësimin e vajzave dhe grave në Kosovë, kjo duhet të ndodhë në kohën e tyre të lirë, pasi që detyrat ndaj familjes, fëmijëve, punëve të shtëpisë dhe kujdesit ndaj të moshuarve, mbeten përsëri obligime kryesisht të grave. Portretizimi i gruas si figurë vetëmohuese e shoqërisë, e cila është gjithmonë në dispozicion sa herë që kërkohet sakrificë dhe heshtje "për të mirën e të tjerëve", mbetet pjesë e mentalitetit tonë shoqëror, pavarësisht çfarëdo progresi që mund të arrihet nga Kosova si shtet apo si shoqëri.

Faktor tjetër është familja, e cila është pasqyrë e shoqërisë, e që vazhdon të shërbejë si mjet për riprodhimin e kësaj mendësie tradicionale, duke mos e lënë të shuhet. Vajza si pronë e babait dhe pastaj e burrit vazhdon të jetë realitet në Kosovë, duke mos e lejuar gruan asnjëherë të paraqitet si figurë e pavarur dhe përcaktuese e fatit të saj. Kurse faktori i tretë është neglizhenca e institucioneve shtetërore, duke mos e zbatuar ligjin dhe duke mos kërkuar llogari për shkeljen e të drejtave të grave në Kosovë. Institucionet shtetërore në Kosovë madje legalizojnë praktika tradicionale diskriminuese ndaj grave, duke u bërë vet shkelëse të ligjeve që i garantojnë të drejtat e barabarta të grave në Kosovë, apo duke mos e konsideruar barazinë gjinore si vlerë e demokracisë të cilën po përpjetojnë ta ndërtojnë, duke mohuar rëndësinë vendimtare të gruas në ndërtimin e institucioneve dhe vlerave shoqërore të vendit.

Këtij rrethi vicioz, të menaxhuar kryesisht nga burra patriarkalë, të cilët pushtetin e tyre e ndërtojnë mbi nënshtrimin dhe subordinimin e grave, duket sikur i konvenon një gjendje e mjerueshme e grave në Kosovë. Një gjendje e tillë mund të krahasohet me kohën kur vetëm burrat e bardhë kishin të drejtë vote, duke ua mohuar gratë të drejtat politike dhe civile.

Ky sistem i cili ishte kamufluar dhe fshehur në mesin e strategjive e projekteve të së ardhmës e cila kurë nuk erdh, është demaskuar kryesisht gjatë krizës së pandemisë në Kosovë, kur gratë veçse të marginalizuara skajshmërisht, u përballën me një marginalizim të dytë, duke e treguar edhe njëherë se shoqëria jonë, dhe qëndrimi diskriminues i


shoqërisë dhe institucioneve ndaj grave, nuk ka ndryshuar aspak dhe asnjëherë. I gjithë progresi sado i vogël që mendohej se po arrihej drejt barazisë gjinore, në fakt ishte veç një petk i modernizimit me të cilin u mbuluan shkeljet e të drejtave të grave në Kosovë, por ishin gjithmonë aty, dhe do të zbuloheshin e rëndoheshin në një situatë krize si kjo e COVID-19.

Teoria feministe flet për konceptin e marginalizimit të dyfishtë të grave, duke u fokusuar kryesisht në diskriminimin e dyfishtë, së pari në bazë gjinore, pastaj duke u bazuar në veçori të tjera si raca, religjioni, kultura, e faktorë të tjerë. Në anën tjetër, marginalizimi si proces është privimi i një individi apo pjesë të shoqërisë për të mos arritur pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri, si dhe të mos i gëzojnë të drejtat dhe benefitet që i gëzojnë pjesa tjetër e shoqërisë. Mirëpo, si do ta quajmë një proces të shtypjes e diskriminimit sistematik të grave në Kosovë, të cilat veçse ishin të diskriminuara dhe ishin të parat që të diskriminoheshin edhe njëherë gjatë pandemisë COVID-19?

Hulumtimet e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare në Kosovë gjatë vitit 2020, por edhe të dhënat zyrtare, kanë treguar se gratë ishin të parat që pësuan nga mbyllja e bizneseve për shkak të masave qeveritare për parandalimin e përhapjes së virusit SARS-Cov-2. Kjo posaçërisht pasi që pjesa më e madhe e bizneseve në pronësi të grave në Kosovë janë biznese të vogla, të cilat pësuan nga pamundësitë financiare për t'i mbajtur biznese të tyre në këmbë. Shkalla e papunësisë në Kosovë të gratë u rrit prej 30.6% në tremujorin e parë të vitit 2020, në 33.1% në tremujorin e tretë, kurse papunësia tek burrat përkundrazi shënoi rënie. Gratë të cilat pësuan më së shumti ishin ato në sektorin privat dhe gratë në ekonominë joformale, për të cilat Qeveria akoma nuk i ka madje as shifrat zyrtare. Rreth 25% të grave u është shkëputur kontrata njëanshëm, kurse shumë prej tyre u dërguan në pushim pa pagesë, apo nuk e pranuan pagën e plotë gjatë muajve të karantinimit të plotë të vitit 2020.

Për shkak të mbylljes së vendeve të punës dhe inkuadrimit të modalitetit të punës nga shtëpia, 42% e grave në Kosovë - në krahasim me 19% të burrave - kaluan me punë nga shtëpia. Mirëpo, ajo që ndryshoi për gratë nuk ishte vetëm lokacioni i punës së tyre. Në një ambient të mbyllur të shtëpisë, ku fëmijët mësojnë përmes televizorit, barra për rreth 70% të grave u shumëfishua. Kujdesi i plotë për shkollimin e fëmijëve, duke përfshirë mësimin, kujdesin shtëpiak, e duke i shtuar edhe orarin e plotë të punës të cilën gratë e punësuar e vazhdonin nga shtëpia - situata për gratë gjatë vitit 2020 arriti kulmin. Përveç aspektit të mbingarkesës së pamëshirshme, me vështirësi të mëdha po përballen edhe nënat vetushqyese dhe gratë të cilat përmes punës së tyre ishin burim i vetëm financiar për familjet e tyre.

Një nga aspektet që më së paku ka marrë vëmendje gjatë vitit 2020 është implikimi gjinor i mbylljes së shkollave dhe institucioneve edukativo-arsimore në Kosovë. Duke konsideruar se u ofrua zgjidhja përmes mësimin online, Qeveria dhe Ministria e Arsimit në Kosovë nuk i kushtuan vëmendje asaj se barra kryesore për mësimin online të fëmijëve të nivelit fillor ra mbi gratë, të cilat me automatizëm u konsideruan si të obliguara për të ndihmuar fëmijët për të vazhduar mësimin nga shtëpia. Në njërin anë u injorua barra psikologjike e grave, sidomos e nënave të fëmijëve që filluan klasën e parë në vitin 2019/2020, dhe atyre grave të cilat kanë dy apo më shumë fëmijë duke ndjekur mësimin fillor,



paralelisht. Në anën tjetër, planprogrami për mësimin online nuk e mori në konsideratë barrën financiare që ka mësimi nga shtëpia, duke përfshirë kompjuterë ose laptopë, e të cilat ishin edhe një obligim më shumë për familjet që i kishin humbur të ardhurat e tyre si pasojë e ndikimit të COVID-19 në tregun e punës. Në anën tjetër, mësimi nga shtëpia përpos një mundësie për të vijuar mësimin në kushte të jashtëzakonshme si rezultat i përparimit të teknologjisë, paraqet edhe rrezik pikërisht për shkollimin e vajzave në të ardhmen në vende me mentalitet patriarkal, ku shkollimi i vajzave nuk konsiderohet si domosdoshmëri, duke pasur parasysh që për vajzat nga vendet rurale në Kosovë, shkolla është i vetmi ambient social ku ato marrin pjesë për t'u shoqëruar me bashkëmoshatarët e tyre. Prandaj, mësimi online mund të shihet si mundësi e ushtrimit të mentalitetit patriarkal për të kufizuar socializimin dhe pjesëmarrjen aktive të vajzave në shkollim.

Për të ndihmuar ekonominë e goditur nga pandemia COVID-19, në gusht të vitit 2020 Qeveria e Kosovës miratoi Programin për Rimëkëmbje Ekonomike, duke përfshirë masa të Pakos Emergjente Fiskale, të miratuar në fillim të vitit 2020. Ky program, i cili përfshinte 365 milionë euro për rimëkëmbje ekonomike, ndau vetëm 2 milion euro për aktivitetet dhe mbështetjen financiare të grave të prekura nga pandemia, që është shuma më e vogël e ndarë për masat 8, 9 dhe 10 nga 15 masat e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike. Kjo njëherit paraqet përqindjen e vëmendjes që Qeveria e Kosovës dhe institucionet i kanë kushtuar ndikimit të pandemisë në jetën e grave në Kosovë. Duke pasur parasysh që gratë në Kosovë përbëjnë gjysmën e popullsisë, ndarja e 0.55% të buxhetit të programit për rimëkëmbje për "çështje të grave" tregon qasjen diskriminuese të institucioneve të Republikës së Kosovës për t'u ofruar ndihmë grave të goditura nga pandemia. Buxheti i gjinor minimal dhe mungesa totale e vëmendjes dhe vetëdijes institucionale për ndikimin gjinor të pandemisë COVID-19 në Kosovë, jo vetëm që i ka marginalizuar gratë edhe njëherë, duke i shtyrë edhe më shumë drejt margjinave prej nga do të jetë shumë e vështirë të rimëkëm-

ben, por e ka zbuluar qëllimin e sistemit institucional në Kosovë që çon në diskriminim me bazë gjinore. Prandaj edhe kjo analizë tregon se gratë u marginalizuan edhe njëherë gjatë pandemisë së COVID-19, duke u diskriminuar edhe njëherë në situatë të një krize të tillë shëndetësore.

Është e qartë që përmirësimi i jetës së grave në Kosovë nuk do të ndodhë përdërisa atyre u ofrohen thërrmija të vëmendjes institucionale. Për më tepër, në pozitën në të cilën gjenden gratë në Kosovë sot, si rezultat i diskriminimit sistematik të shumë dekadave dhe goditjes së mëtejme nga kriza multidimensionale e shkaktuar nga pandemia COVID-19, vëmendja e plotë dhe masat e veçanta stimuluese afatgjata drejt barazisë gjinore përsëri do të kenë efekt minimal përdërisa gratë vazhdojnë të viktimizohen, sakrifikohen e hidhen në margjinat e shoqërisë sa herë që vendi dhe bota goditen nga kriza shëndetësore, ekonomike apo çfarëdo lloj krizash të tjera.

Barazia gjinore është vlerë demokratike dhe një nga shtyllat kryesore të një shoqërie të shëndoshë. Dështimi apo injorimi i një parimi të tillë nga shoqëria dhe institucionet shtetërore në Kosovë do ta çojë vendin drejt synimit të ndërtuar një shtet pa bazament, i cili gjithmonë rrezikon të rrezohet, sa herë që kriza ekonomike, shëndetësore, apo kriza të çfarëdo lloji mund t'i kanosen vendit dhe botës. Diskriminimi i grave në Kosovë nuk është qëndrim veç ndaj gruas, por është diskriminim dhe përjashtim i gjysmës së popullsisë, e cila bën punë të papaguar, kontribuon në ekonominë e vendit, dhe luan rol të pazëvendësueshëm në të gjitha instancat e shoqërisë. Përfundimisht, situata e pandemisë COVID-19 ka zbuluar se Kosova ka nevojë për një revolucion në aspektin e marrëdhënieve gjinore, një rrizgim të grave dhe vajzave në marrjen në dorë të të drejtave të tyre, vendit të tyre në shoqëri, familje, politikë dhe treg të punës, si vend që ka qenë gjithmonë i tyre, e jo si shpërblim, pozitë apo rezultat që duhet ta arrijnë duke luftuar ndaj një sistemi diskriminues dhe jologjior.

Autorja është kandidatë e doktoratës në Universitetin e Varshavës

Nuk ka feminizëm kosovar pa feminizmin e komuniteteve pakicë



Vlora Gashi
Qëndresa Ademi

“Vlora dhe Qëndresa janë dy vajza që jetojnë në komunën e Fushë Kosovës. Vlora është nga komuniteti egjiptian, ndërsa Qëndresa nga komuniteti ashkali. Përveç aktiviste, Vlora dhe Qëndresa janë shoqe që bashkëpunojnë dhe çojnë përpara kauza të cilat adresojnë racizmin dhe feminizmin me qëllim të përmirësimit të jetës për personat e komuniteteve tona dhe gratë që diskriminohen dukshëm më shumë se të tjerat. Përkundër shumë sfidave, Vlora dhe Qëndresa kanë vazhduar studimet e tyre universitare. Vlora studion edukimin në Fakultetin e Edukimit, ndërsa Qëndresa studion sociologjinë në Fakultetin Filozofik”. Kështu do të shpreheshim për veten nëse dikush do të na

pyeste kush jemi dhe pse punojmë.

Për ne racizmi ka qenë përvojë e jetuar me të cilën jemi ballafaquar prej bankave të shkollës fillore. Qysh në vegjëli e kemi menduar si të drejtë të shumicës, do të thotë të shqiptarëve, dhe këtë e kemi menduar kryekëput për shkak të mënyrës se si jemi trajtuar ne, duke qenë pjesëtare të komuniteteve pakicë. Ne e kemi përjetuar racizmin në lëkurën tonë. Megjithatë, kjo nuk na ka ndalë që të vazhdojmë të edukohemi vetë dhe kështu të angazhohemi për komunitetet tona e të punojmë edhe për një Kosovë më të mirë për të gjithë. Gjatë rrugës sonë, përveç dëshirës për t'u edukuar për hir të vetës dhe dëshirës për të mësuar, ne kemi dashur të japim mesazhe për të gjitha vajzat tjera nga komunitetet tona që ato mund të bëhen çfarëdo që duan, pavarësisht nga ngjyra dhe gjinia që kanë. Veçse duhet shumë vendosmëri, cilësi që e kanë të gjitha vajzat. Për shembull, ne ende vazhdojmë të ballafaqohemi me racizëm, por kjo tashmë është diçka që jemi duke e luftuar dhe nuk është që i dorëzohemi apo i frikësohemi më.

Ne, si dy aktiviste, e dimë fare mirë që gjendja e komuniteteve tona është e vështirë. Sidomos

gjendja ekonomike është shumë e rëndë tek këto komunitete, duke qenë se një vetëm një pakicë e tyre arrijnë të punojnë. Megjithatë, kjo nuk na ka ndalur, përkundrazi na ka shtyrë edhe më shumë që të punojmë në të gjitha mënyrat që mundemi që ta ndryshojmë këtë gjendje. Qysh në moshë të re ne kemi filluar të punojmë në mënyrë vullnetare çdo punë që ka synuar t'u përmirësojë jetën komuniteteve tona. Dhe jo vetëm tonave, pasi që ne jemi angazhuar dhe vazhdojmë të angazhohemi edhe për komunitetet tjera që diskriminohen në Kosovë. Përveç përmirësimit të situatës së këtyre komuniteteve në përgjithësi, ne vazhdojmë të punojmë edhe në përmirësimin e pozitës për vajzat dhe gratë e këtyre komuniteteve. Përkundër faktit që ne vuajmë se jemi pjesëtare të komuniteteve pakicë, vuajmë edhe më shumë për faktin që jemi gra.

Në komunitetet tona shumica e vajzave e ndërpresin shkollimin dhe marrohen në moshë shumë të re. Kjo nuk ndodh për shkak se është diçka që “ndodh natyrshëm tek këto komunitete”, por vjen për shkak të gjendjes ekonomike dhe shoqërore në të cilat këto vajza lindin dhe jetojnë. Po ashtu, kjo ndodh sepse institucionet e Kosovës

nuk e shohin të rëndësishme që të punojnë më shumë me komunitetet tona, sidomos me vajzat dhe gratë, si dhe t'u përmirësojnë jetën atyre. Për shkak të kësaj, komunitetet tona - sidomos gratë - mbesin më pak të shkolluara, më të varfra dhe më të lëna anash, gjë që është duke e ndikuar dukshëm negativisht pozitën e grave brenda komuniteteve, por edhe në shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Për shkak se ne i kemi vërejtur që në moshë të re këto problematika, kemi vendosur që të punojmë më shumë për ndryshimin e kësaj gjendjeje. Qysh në moshë të re kemi filluar punën vullnetare si mësuese në organizatën “The Ideas Partnership”, ku kemi dhënë mësim për fëmijët e klasave të para dhe për fëmijët që kanë pasur nevojë për mësim intensiv.

Aktivizmin tonë e kemi bërë më të zëshëm që prej korrikut 2019, kur ndodhi tragjedia e Kujtim Veselit, fëmijës që u përdhunua dhe u vra për shkak të neglizhencës së policisë dhe shtetit. Ne të dyja ishim bashkorganizatore të protestës “Drejtesia për Kujtimin”, që për ne ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme pasi që ishte protesta e parë që u organizua nga komunitetet për një kauzë të tillë, e cila e ktheu vë-

mendjen më shumë tek racizmi që tek ne është aq i normalizuar dhe shpesh kalon pa u vërejtur e pa u diskutuar fare. Prej këtij viti ne vazhdojmë të merremi aktivisht në kërkimin e drejtësisë për Kujtimin, duke u organizuar me komunitetet tjera dhe aktivistët tjerë për organizimin e aktiviteteve që kërkojnë drejtësi.

Si aktiviste, ne këmbëngulim në ngritjen e zërit për të gjitha këto padrejtësi. Siç jemi organizuar më herët do të vazhdojmë të organizojmë protesta tjera që do të kenë për temë problemet që i hasim si komunitete dhe si gra në shoqëri. Duke e ditur që gratë e komuniteteve tona ballafaqohen dukshëm me më shumë vështirësi dhe diskriminim në përditshmërinë e tyre, aktivizmin tonë kundër racizmit e shohim të pashkëputur edhe nga aktivizmi ynë feminist. Aktivizmin tonë e konsiderojmë si të nevojshëm në zhvillimin e çfarëdo iniciative për të drejtat e grave në Kosovë, sepse kur gratë e komuniteteve pakicë nuk janë të përfshira, ato nisma nuk mund të jenë të plota.

Autoret janë aktiviste për të drejtat e komuniteteve pakicë dhe të drejtat e grave.

Hapa të vegjël, por premtues



Gresa Hasa, Liri Kuçi

Deri së fundmi, në Shqipëri nuk qenë krijuar kushtet e përshtatshme historike dhe shoqërore për krijimin e lëvizjeve emancipuese me mobilizim nga poshtë. 45 vitet e regjimit totalitarist të Enver Hoxhës paralizuan qysh në gjenezë çdo përpjekje të hamendësuar apo të dëshiruar për një lëvizje gjithëpërfshirëse me karakter mirëfilli feminist. Paçka se në këtë periudhë gjysmëshekullore ekzistoi një propagandë e fuqishme për emancipimin e gruas, me fushata ndërgjegjësimit, organizime kolektive në vendin e punës, në shkollë, në lagje, etj., kjo nismë fillonte dhe mbaronte me tutelën totalitariste të partisë-shtet, reduktuar në kultin e diktatorit. Mbi të gjitha, zor se mund të flitet për një natyrë “feministe” të saj.

Teksa në vitet 1960 dhe 1970 shoqëritë perëndimore u udhëhoqën nga ndryshimet radikale për çlirim seksual, e drejta për abort, njohja e natyrshëmrisë së dashurisë homoseksuale, shtrirja e të drejtave të grave në mjedisin e punës për paga të barabarta dhe dinjitoze, artikullimi i çështjeve racore, etj., Shqipëria shkoi kah izolimi i plotë, duke rritur frikën dhe terrorin.

Nga ana tjetër, edhe kur lëvizja studentore e 1990-ave ia behu me guxim dhe shpresa të mëdha, ajo nuk ia doli që të krijonte një traditë të re dhe demokratike organizimi masiv nga poshtë. Jo vetëm kaq, por nuk pati as edhe një tentativë të mirëqenë për formimin e një baze disi të qëndrueshme, nga ku mund të hidheshin hapa foshnjorë por me peshë, për veprimtari të mëtejshme kolektive dhe që mëtonin ndryshime specifike. Tranzicioni solli modele të gatshme, tashmë të një perëndimi (më) të komercializuar, cinik dhe afërmendsh, liberal. Në Shqipëri u çelën OJF-të e para të cilat gëzonin,

dhe ende gëzojnë, një strukturë thellësisht të burokratizuar, jashtë ekzistencës së të cilës, në forma alternative aktivizmi, rëndom e kanë të pamundur të mbijetojnë.

Megjithatë, gjatë dekadës së fundit, kjo status quo burokratike e shoqërisë civile në vend është sfiduar për herë të parë prej mobilizimeve rishtas nga poshtë. Protestat kundër armëve kimike (shtator 2013), protestat e njëpasnjëshme studentore që kulmuan në dhjetor 2018, sikurse protesta e parë masive me karakter feminist në qershor 2020, kanë qenë të gjitha grupime mbresëlënëse dhe tërësisht vullnetare përreth një kauze të veçantë. Gjithashtu, krijimi i sindikatave të reja të punëtorëve/eve përbën një tjetër shkëndijë në vend, për një formë më radikale dhe të munguar organizimi. Ndërsa më herët kishim të bënim vetëm me burokratizimin në strukturë të shoqërisë civile, tashmë kemi të bëjmë me veprimtarinë konkrete dhe masive përreth kauzave të ndryshme dhe vetë mungesën e burokracisë, apo mungesën e një strukture kyçe përreth së cilës organizohet veprimtaria kolektive (qoftë kjo lëvizje horizontale, ose një formë hierarkie). A mund të themi vallë se Shqipëria ka mbërritur në këtë çast në kohë në një lloj pjekurie demokratike që premtim për të ardhmen e afërt? A janë të gjitha këto përpjekje kolektive së fundmi (studentore-feministe-punëtoze), një ogur i mirë për hedhjen për herë të parë të bazës për lëvizje emancipuese që pritej me aq ngut dhe romanticitet 30 vjet më parë? A mund të flasim për “lëvizje me mobilizim nga poshtë” dhe a ka ardhur “SHOTA” në jetë si një përpjekje e ngjizur në këto kushte të reja?

Pavarësisht idealizmit dhe sistematicitetit në punë, një pune ndërgjegjësuere dhe radikale që kryhet nën sipërfaqe - parakusht për vijimësinë e strukturave organizative të tilla dhe sakaq element i domosdoshëm për masivitetin e sigurt dhe rezonancën e gjerë shoqërore - koha përcakton kristalizimin me sukses ose jo të këtyre përpjekjeve në lëvizje dhe për pasojë, triumfin ose dështimin e tyre.

“SHOTA” erdhi si nevojë për të identifikuar publikisht bashkëjetesën e disa kauzave rreth një boshti që është feminizmi progresist: çlirim dhe emancipimin gjinor, barazinë mes gjinive, drejtësinë shoqërore, antikapitalizmin, antiracizmin, kulturën radikale queer dhe mbi të gjitha, mungesën e kompromisit për dinjitetin dhe të njerëzishmen e grave.

“SHOTA” lindi rrugëve të qytetit si përgjigje ndaj dhunës sistemore dhe patriarkale, për t'u kontekstualizuar më pas në një platformë përbashkuere, me qëllim shtrimin e diskursit dhe praktikës feministe në Shqipëri.

Përkrah solidaritetit dhe mobilizimit në terren, zhvillimi i mendimit kritik dhe emancipimi përmes dijes mbeten të vetmet in-

strumente premtuese tonat për ndërtimin e një shoqërie ndryshe. Aty ku ka vend për gratë njëloj sikurse për burrat; ku puna është meritë dhe shpërblim drejt një jetese me dinjitet, jo skllavëri moderne; ku për shoqja-shoqen jemi krahar mbështetës, jo konkurrente në një garë absurde që mëkon strukturat e shtypjes; ku dallimet tona në terma të etnisë e gjuhës që flasim, kombësisë, kulturës e besimit të cilit i përkasim, orientimit seksual apo identitetit gjinor, shërbejnë për të na afruar dhe fuqizuar.

Shota është ide dhe përpjekje. Ajo është çdo grua që vjen nga skajet drejt qendrës. Shota e banon personalen e tyre, i jep asaj jehonë dhe e shndërron atë në thirrje publike. Por mbi të gjitha, Shota është kërkesa për drejtësi shoqërore dhe barazi gjinore, mungesa e kompromisit për lirinë dhe jetën.

Nga ky këndvështrim ndoshta “SHOTA” nuk qe një çast i vetëm, por shumatore e përpjekjeve ekzistuese. Ajo s'ishte një thirrje vetmitare që iu bashkua momentumit, porse përcjellja e shumë zërave të izoluar, që duke u bërë bashkë në solidaritet mbërritën në sipërfaqe duke ofruar një hapësirë të sigurt, solidare dhe kritike. “SHOTA” nisi si veprim dhe u kontekstualizua më pas edhe në fjalën e shkruar e të folur, për gjuhën si një mjet të domosdoshëm dhe strategjik për të shtruar ura bashkëveprimi dhe njëkohësisht, një ligjërim progresist feminist, të dokumentuar dhe arkivuar.

Ajo mbërriti me pandeminë, gati si një antitrip i krizës së thellë që ka mbjellë e do të lërë pas COVID-19. E teksa dikur pandemia do të kalojë, nevojat tona për struktura të tilla solide dhe bujare, të shtrura gjatë kësaj periudhe, nuk do të reshin. Se përpjekja jonë është njëje e pazgjidhshme deri në momentin e çlirimit, që në rrotullimin përfundimtar drejt gjendjes natyrale të lirisë nuk shkëputet, por derdhet shpengueshëm në botë, për të shërbyer si provë e gjallë e përjetimit të historisë si gjerdan kolektiv...

Autoret janë aktiviste feministe dhe bashkëthemeluese të Revistës Shota në Tiranë.



38 burra



Leonida Molliqaj

Asnjë komunë në Kosovë nuk drejtohet nga gratë. Ndërkohë burrat kanë pushtetin në 38 komuna, aq sa edhe numëron shteti ynë.

Të dhënat për përfshirjen e grave në zgjedhjet lokale janë alarmante. Nga 208 persona sa i kishin kandiduar subjektet politike për udhëheqjen e komunave në zgjedhjet lokale të vitit 2017, vetëm 8 ishin gra, pra më pak se 4% e garuesve. Edhe kur partitë politike vendosën gra kandidatë për pozitën e kryetares së komunës, zakonisht ato garuan në rajone ku kishin pak gjasa që të fitonin, ndërkaq bastionet partiake përgjithësisht u rezervuan për burrat.

Përbërja e listave zgjedhore për këshilltarë komunalë është një tregues i qartë se si ndahet pushteti brenda një subjekti politik: 70% e listës u takon burrave dhe vetëm 30% përfshin gratë, dhe kjo ekskluzivisht për shkak të detyrimeve ligjore. Të gjitha subjektet politike deri më tani e kanë shkelur Ligjin për Barazi Gjinore që parasheh përfqasim 50/50 të burrave dhe grave në të gjitha institucionet publike.

Partitë politike nuk kanë një angazhim të përhershëm për të ndihmuar gratë që të bashkohen dhe përfshihen politikisht. Zakonisht vërehen tek angazhohen në kërkim të emrave të grave vetëm kur vjen koha e fushatave zgjedhore. Në zgjedhjet lokale të vitit 2017, nga 6.887 kandidatë për këshilltarë komunalë në përgjithësi, vetëm 34% prej tyre ishin gra. Nga gjitha anëtarët e kuvendeve komunale, 65% kanë arritur aty falë kuotës gjinore.

Gara në zgjedhjet lokale është e pabarabartë për burrat dhe gratë në të gjitha drejtimet. Gratë kandidatë për këshilltarë komunalë, sidomos ato në zonat rurale, kanë kushte të pafavorshme për të bërë fushatë. Të dhënat nga Demokracia në Veprim tregojnë se pjesëmarrja e grave në tubimet elektorale të vitit 2017 ka qenë në mesataren 10%, ndërsa sa i përket pjesëmarrjes së grave si folëse ka qenë 21%. Zakonisht partitë politike grumbullojnë burra nëpër oda dhe hapësira tjera tradicionale që historikisht kanë qenë përjashtuese për gratë, kështu vetëm burrave kandidatë u mundësohet të diskutojnë për politikë dhe t'i përfqasojnë subjektet e tyre. Për sa kohë të kemi këtë lloj të segregimit në baza gjinore, nuk mund të flitet për sfidim normash tradicionale.

Gratë kandidatë nuk janë të barabarta as ekonomikisht me burrat kandidatë. Fondet për shpenzime të fushatës zgjedhore nuk ndahen në mënyrë të drejtë mes kandidatëve dhe kjo më së miri vërehet kur analizohen materialet promovuese si bilbordët, reklamat apo spotet televizive, ku gratë rrallë vërehen.

Në anën tjetër, edhe pas zgjedhjeve partitë fituese përgjithësisht i kanë vendosur burrat në pozita udhëheqëse brenda komunave. Një raport nga Democracy Plus ka gjetur se nga 364 drejtori komunalë sa janë identifikuar në 37 komuna, vetëm 75 drejtori udhëhiqen prej grave. Shembull të mirë në këtë mandat kanë dhënë Komuna e Kamenicës, ajo e Drenasit dhe e Klllokotit, që kanë balancë të plotë gjinore në poste

udhëheqëse të drejtorive.

Kemi të bëjmë me një dominim jashtëzakonisht të madh të burrave në të gjitha institucionet politike dhe ekonomike. Këtë nuk po e problematizojmë në rrafshin e shifrave të përfqasimit. Është fjala për ndarje të padrejtë të pushtetit dhe riprodhim të pabarazive.

Kuvendet lokale janë hapësira të rëndësishme politike. Aty propozohen dhe vendosen politika që prekin drejtpërdrejt jetën e komunitetit. Dëshmitë sugjerojnë që rritja e përfshirjes së grave në hartimin e politikave publike mund të ndihmojë në përpilimin e politikave më gjithëpërfshirëse. Ne kemi nevojë për politika tejet konkrete, por edhe të guximshme që shkundin rendin ekzistues diskriminues në Kosovë. Angazhimi politik i grave është një mundësi për të problematizuar shumë çështje që nuk kanë qenë pjesë e diskutimeve publike edhe për fatin e keq sepse kanë prekur vetëm gratë. Vetëm kur gratë ndërhyjnë në sferën publike mund të hapen mundësi të reja për artikulum dhe adresim të shtypjes e diskriminimit.

Ka pak gra që punojnë e edhe më pak gra që angazhohen politikisht. Ky duhet të jetë shtetësim i të gjithëve. Në vend të diskutimit të shtruar gabimisht, që i fajëson gratë për mungesë vullneti e gatishmërie për t'u përfshirë në sferën publike, duhet të flitet shumë e shpesh për vështirësitë e tyre për ta bërë këtë hap, e që shpesh lidhen drejtpërdrejt me punën e papaguar brenda shtetësisë.

Pabarazitë gjinore janë thellësisht politike andaj edhe lufta ndaj tyre duhet të jetë politike.

Autorja është gazetare dhe Drejtore Ekzekutive në Qendrën për Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA).

Darkën ose partinë?



Ballafaqim me të vërtetat në hije

“Pse nuk ka një grua sot këtu, të gjithë jeni burra?” - i drejtua një paneli një vajzë nga audienca, e cila në shenjë proteste nuk e shfrytëzoi mundësinë të ulej në karrigen e zbrazët së bashku me panelistët në skenë, ku mund të uleshin të gjithë pjesëmarrësit që donin t'u drejtonin pyetje atyre. Paneli përbëhej nga përfqasues prej komunave të ndryshme të Kosovës që ishin ftuar të diskutonin me të rinjtë lidhur me aktivizmin e tyre në vend. Meqenëse të ftuar ishin vetëm nga një përfqasues nga çdo komunë, të gjithë panelistët ishin burra - kjo përbërje sikur pasqyrore të kuptuarit e barazisë gjinore në përfqasim dhe pjesëmarrje në jetën publike; barazia gjinore si luks, mund të realizohet vetëm atëherë kur ka “një ulësë më shumë” - një ulësë e vetme, gjithsesi u takon burrave.

Përgjigja në pyetjen e vazhës, e vonuar disa sekonda që ndiheshin të gjatë në mes të panelistëve të cilët në çdo formë tentonin t'i iknin pyetjes dhe t'ia kalonin tjetrit barrën e përgjigjes, sikur ua përkujtoi përnjëherë se mungesa e grave në ngjarje të tilla nuk ishte më normalja - vërehej. Përmasë kësaj pyetje shpalosej ajo që në të shumtën e rasteve mbetet e padukshme për burrat në pozitën e tyre - gjinia e tyre. Kështu të stepur, ndoshta ngase nuk kishin një përgjigje, apo ndoshta ngase kishin një të tillë për të cilën e dinin se nuk mund të thuhej hapur para një audience, mund të ishte një

nga ato përgjigjet që do të rrezikonte t'i shpërfaqte bindjet e tyre se, në fund të fundit, “Pse do të duhej të ishin gratë aty?”.

Njëri nga ta, si qengj sakrifice, vendosi të përgjigjej duke thënë: “Gratë nuk duan të jenë pjesë e politikës”, se ata, burrat si ai, i kanë “ftuar” shumë herë “ato”, por “ato nuk pranojnë”.

Më erdhi të ngrihem e t'ia rendis arsyt e pafundme pse një grua edhe mund të mos pranojë të bëhet pjesë e një strukture të tillë dominuar nga burrat si ai, por nuk fola, sepse e dija se nuk do të kuptohesha, qëllimshëm. Sidoqoftë, pasi përfundoi paneli u sigurova ta takoja atë zyrtar, të cilin edhe ashtu e njihja prej më parë. U ulëm për një kafe me të dhe të tjerë nga komuna që kishin ardhur ta shoqëronin, edhe ata të gjithë burra. Në bisedë e sipër e ktheu diskutimin te pyetja e vazhës nga audienca pak më parë dhe e pyeta: “Kush nga ju shkon në takimet e partisë, ti apo bashkëshortja?”. Tha: “Unë, normalisht. Po çka ka lidhje kjo?”. Vazhdova: “Po në takimet e këshillit të fshatit kush shkon?”. U përgjigj: “Gratë nuk shkojnë në ato mbledhje”. E pyeta: “Pse?”, dhe sikur të ma lexonte mendjen, më ktheu përgjigjen duke e thënë pikërisht atë që unë po përgatitesha t'i thosha pasi të përgjigjej, sepse unë e dija faktin që takimet e këshillave të fshatrave bëhen zakonisht në orët e mbrëmjes, duke e arsyetuar mospjesëmarrjen e grave në këto takime. I çliruar se tani nuk ishte para një audience, duke aluduar në pamundësinë e grave për t'u angazhuar në aktivitete të tilla jashtë shtetësisë për shkak të pritshmërive ndaj tyre që lidhen me rolin e tyre gjinor, mundësi që gjithsesi u takojnë burrave, më tha: “E kush me e bo darkën për to?”.

Kush e gatuan darkën që hamë?

“Si e siguron darkën tuaj?” është pyetja fundamentale ekonomike të cilën e parashtron Adam Smith në librin e tij Pasuria e Kombeve. Sipas tij, darkën nuk e sigurojmë falë dashamirësisë së kasapit apo bukëpjekësit, por nga interesi që ata kanë për ta na e siguruar neve atë. Është pikërisht ky interes vetjak i secilit për të vepruar në një formë të caktuar që paraqet forcën udhëheqëse të ekonomisë.

Në diskutimet e tilla politiko-ekonomike mbi atë se si e sigurojmë darkën që hamë dhe çfarë interesa vetjake ka secili i përfshirë në këtë proces - konsumimin dhe prodhimin e ushqimit, janë disa pyetje fundamentale që mungojnë: kush e gatuan darkën që hamë? Çfarë interesi vetjak kanë personat që e gatujnë atë? Sa kohë shpenzohet në këtë aktivitet dhe ku ndodh?

Nëse sipas Smith, njerëzit vendosin të kryejnë aktivitete të caktuara bazuar në interesin e tyre, interesi i atyre që konsumojnë ushqimin është i dukshëm, mbijetesa. I atyre që e prodhojnë mbetet ose konsumi i atij ushqimi, ose shitja apo shkëmbimi i tij për të mira të tjera të nevojshme. Por, për ata persona që e gatujnë atë? Këto pyetje janë parashtruar nga filozofet feministe për kohë të gjatë tashmë, por në përgjithësi duket sikur këto pyetje mënjanojnë qëllimshëm nga diskutimet ekonomike apo politike, shpesh duke u thirrur në pamundësinë për ta matur këtë aktivitet, argument ky që lehtë mund të kundërshtohet. Kur ky aktivitet zhvillohet jashtë shtetësisë, matet në terma ekonomikë dhe shpërblehet si punë, kurse e njëjta nuk ndodh kur kryhet brenda në shtetë, në sferën private, aty ku në të shumtën e rasteve bëhet nga gratë.

Duke u lidhur me pyetjen fundamentale të Adam Smith se si e sigurojmë darkën që hamë, shkrimtarja feministe Katrine Marcal shkon një hap tutje dhe pyet: “Kush ia gatoi darkën Adam Smith-it?”, kjo

për të vënë në dukje se “Babai i Ekonomisë”, i cili parashtrori pyetjen si ta bëjmë ekonominë kapitaliste më humane dhe të kuptimshme, nuk e përfshiu në analizën e tij atë veprimtari bazike që në fund të fundit e vë në lëvizje të gjithë ekonominë. Por, për ta kuptuar thelbin e aktivitetit ekonomik të njeriut, përpos që e mendojmë se si sigurohet darka, duhet të mendojmë kush e gatuan atë darkë.

Marcal thekson se, përderisa Adam Smith shkruante për ekonominë dhe besonte se të gjitha veprimet tona bazohen në interes vetjak dhe bota sillet rreth profitit financiar, ai e harronte një detaj - ishte nëna e tij ajo që ia gatua darkën çdo natë. Është kjo pyetje që vazhdon të injorohet edhe sot, por ne pyesim: Kush e gatuan darkën e burrave që shkojnë në mbledhjet e partive në mbrëmje? Madje, shkojmë edhe më larg dhe pyesim: Çfarë humbin gratë që gatujnë, çfarë tjetër do të mund të bënin ato në këtë kohë, përpos që do të mund të mermin pjesë në këto takime? Shumë e rëndësishme, po ashtu: Cilat janë pasojat për gratë që mund të mos gatuajnë në një shoqëri e cila pret prej tyre ta kryejnë këtë veprim pa ndonjë interes konkret vetjak?

Zgjedhje?

Në pyetjen e parë, kush e gatuan darkën e burrave që ndjekin takimet e partive, përgjigjen e dimë nga shtetëpitë tona. Nga vetë burrat që na tregojnë, janë gratë ato që e bëjnë këtë.

Një parim tjetër shumë i rëndësishëm ekonomik nga ndihmon t'i përgjigjemi pyetjes së dytë, gjithashtu për ta kuptuar peshën e këtij aktiviteti të “padukshëm”, gatimit - është koncepti i koston oportune. Ky parim themelor i ekonomisë tregon se çdo zgjedhje ka një kosto oportune, apo ne kemi një mundësi të humbur për çdo gjë që zgjedhim të bëjmë në vend të diçkaje tjetër.

Për gratë që gatujnë mëngjes, drekë dhe darkë në shtëpi, e që nuk llogaritet se e bëjnë këtë punë, kosto oportune e përgatitjes së mëngjesit, drekës dhe darkës është pjesëmarrja e tyre në jetën publike, të cilën burrat e bëjnë në një formë ose tjetër përgjatë kohës që ato janë duke gatuar. Sidoqoftë, kur e mendojmë parimin e koston oportune, supozohet se personi mund të zgjedh në mes alternativave, prandaj nëse një grua do të zgjidhte të qëndronte në shtëpi dhe të gatua duke e ditur se çfarë humbet në vend të saj, ky nuk do të ishte problemi, por nëse një grua nuk mund të zgjedh, e që janë shumica, për arsye të ndryshme zakonisht kulturore, sociale, gjinore, ajo merret si e mirëqenë.

Përderisa burrat marrin pjesë në mbledhjet e partisë, gratë duhet të zgjedhin: darkën ose partinë? Por, a mund të themi se gratë kanë një zgjedhje përderisa pasojat e “zgjedhjes” së tyre përfshijnë edhe dhunën që i bën ato të përfundojnë në spital, e në rastin më të keq, edhe të vdekura? Në një rast të raportuar në fund të vitit 2018, u tha se një burrë “bëri gruan për spital” sepse ajo ia vonoi çajin. Prokuroria në Ferizaj ngriti aktakuzë ndaj të pandehurit J.K, i cili e sulmoi fizikisht bashkëshorten e tij duke e kapur për flokë fillimisht dhe duke e goditur për lavamani me kokë disa herë radhazi. Në raportim thuhej: “E dëmtuara në ditën kritike derisa kishte qenë duke i shërbyer çaj të pandehurit e njëkohësisht duke përgatitur mëngjesin për fëmijët, nuk kishte arritur që t'i shërbejë në kohë të pandehurit, me ç'rast të njëjtës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore”.

Duke e konsideruar këtë rrezik dhe këto pasoja për gratë, numrin e lartë të raportimeve të dhunës ndaj tyre, si dhe numrin edhe më të lartë të rasteve që nuk e raportojnë dhunën, a mund të themi që shumica e tyre, në fakt, kanë një zgjedhje në mes të darkës ose partisë?

Autorja është magjistre e studimeve mbi gratë dhe gjinitë.



Politika e familjes: Sinjale të mirëseardhura



Artan Mustafa

Kosova ka pasur dhe ka politikë të familjes që nuk mbështet degjenderizimin e përgjegjësive familjare, defamiljalizimin e kujdesit ndaj fëmijëve, dhe punësimin e gruas. Por sinjale të mirëseardhura, sidomos për kontekstin tonë, po dërgohen edhe nga iniciativat aktuale brenda burokracisë shtetërore, edhe nga programi i fituesit të zgjedhjeve – Lëvizjes Vetëvendosje.

Në kuptimin e ngushtë, literatura e shtetit të mirëqenies e definojnë politikën e familjes si politikën që përfshin beneficionet (transferet) për fëmijët, edukimin e hershëm dhe kujdesin ndaj fëmijëve (termi anglisht: Early Childhood Education and Care - ECEC), dhe lejet prindërore nga puna.

Përkundër konvergencës, shtetet dallojnë për kah dizajni i politikave të familjes dhe qëllimeve të tyre. Politikat më ambicioze dhe më të suksesshme - në kuptim të punësimit të lartë të gruas, kufizimit të varfërisë së fëmijëve, suksesit të fëmijëve në arsimim, socializim dhe përgatitje për moshë të rritur - llogariten të vijnë nga vendet të cilat aplikojnë pushime prindërore që përfshijnë dy prindërit (me pagesë), dhe benefite të përfshirje universale të fëmijëve në shërbimet ECEC publike të menaxhuara dhe financuara nga shteti.

Disa nga prizmat e rëndësishëm përmes së cilëve vlerësohen këto politika përfshijnë degjenderizimin e kryerjes së përgjegjësive familjare, defamiljalizimin e kujdesit të fëmijëve dhe të personave tjerë të varur në familje, si dhe krijimin e kushteve për punësim dhe për balancë punë-familje për gruan.

Politika konservatore e familjes në Kosovë gjatë socializmit

Politika e familjes e Kosovës, e definuar si më sipër, lindi gjatë periudhës së socializmit vetëqeverisës (1952-1989), në kohë me zhvillimet e ngjashme në Europë. Ajo derivate nga parimet që ndiqeshin në tërë Jugosllavinë, ku shumica e të drejtave sociale kanë qenë të ndërlidhura me punën dhe financueshin nga kontributet e punëtorëve.

Transferet cash (shtesat) për fëmijët lëshoheshin për fëmijët e punëtorëve duke targetuar punëtorët me të ardhura më të vogla, pra përmes një logjike të solidaritetit brenda popullatës në punë. Në vitin 1981, kulmin e vetëqeverisjes socialiste, rreth 37% e fëmijëve të Kosovës mbuloreshin nga këto transfere.

Edhe shërbimet ECEC kanë nisur të paraqiten veçanërisht përreth kohës së krijimit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (1974). Ato qenë ambicioze në kuptim të stafit të synuar, infrastrukturës, ushqimit etj., dhe shënjestronin mbulimin e fëmijëve të prindërve në marrëdhënie pune. Megjithatë, përderisa në shumë vende tjera në Europë ECEC vazhdoi të vihet në qendër të politikës së familjes, në Kosovë dhe rajon zhvillimi u ndal për shkak të krizave ekonomike dhe politike. Asnjëherë nuk arriti që mbulueshmëria e fëmijëve të moshës parashkollore me ECEC formale të kalojë mbi 2%.

Sa i takon lejeve nga puna, me Ligjin mbi Marrëdhëniet e Punës (1977) politika ishte e koncentruar

në pushimin e maternitetit. Nëna kishte të drejtë në gjashtë muaj pushim me pagesë pas lindjes së fëmijës, gjashtë muaj tjerë të drejtë pune me orar të pjesshëm të paguar si rrogë e zakonshme, dhe deri në dy vjet tjera të drejtë pushimi pa pagesë. Babai kishte të drejtë pushimi me pagesë deri në shtatë ditë me rastin e lindjes së fëmijës.

Në këtë kuptim, si edhe në vendet tjera socialiste dhe në vende të Europës kontinentale që kanë ndjekur modelin e bazuar në sigurime sociale, politika e atëhershme e familjes ka qenë konservatore: e ka nxitur gruan të rrijë në shtëpi me leje të gjata e gjeneroze dhe nuk ka ofruar alternativa të kujdesit për fëmijët. Shkalla e punësimit e gruas ka qenë e ulët (9.7% më 1981 për grupmoshën 15-60 vjeç). Rrënimin e autonomisë së Kosovës më vonë ka prekur edhe këto të drejta, duke vështirësuar gjendjen e familjeve dhe të grave.

Politika ekstremisht e ngushtë e pasluftës

Pas luftës (1999), Misioni i Kombeve të Bashkuara që mori në administrim vendin filloi ta ndërtojë politikën sociale të Kosovës mbi parime tërësisht të reja - nën ndikimin edhe të organizatave tjera ndërkombëtare që promovonin paradigmen neoliberal - ku synohej të ofrohej një prag minimal të drejtash të financuara nga buxheti kombëtar, ndërsa shumica e mirëqenies pritej të krijohet në treg dhe familje. Politika e familjes nuk ishte trajtuar me prioritet, por përgjatë viteve mori pamjen e saj.

Transferet cash për fëmijë me politikën e re targetojnë vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme, fëmijët e braktisur dhe të vendosur në komunitet. Ato mbulojnë më pak se 1% të popullatës së fëmijëve, çfarë përbën kthim mbrapa në raport me periudhën pararendëse.

Shërbimet ECEC si infrastrukturë janë trashëguar kryesisht nga socializmi, ndonëse janë ndërtuar edhe disa të reja. Kosova ka gjithsej 44 institucione të tilla publike (çerdhe, kopshte për fëmijë dhe qëndrime ditore). Bazuar në legjislacionin e vendit, këto institucione u japin prioritet grupeve më të rrezikuara: fëmijëve nga familjet e varfra, fëmijët e personave me aftësi të kufizuara e të ardhura të ulëta, të veteranëve, etj. Në mënyrë implicite, pritet që familjet tjera të gjejnë zgjidhje në treg - sidomos përmes institucioneve private dhe kujdestarëve privatë. Shërbimet private janë rritur vitet e fundit; në vitin 2019/2020 kanë qenë 159 institucione të këtylla të licencuara, 83 prej të cilave gjenden në Prishtinë. Prej vitit 2006 e tutje, gjithashtu jepen klasat përgatitore për fëmijët parashkollorë (mosha 5-6 vjeç), që zgjasin rreth 2.5 orë në ditë dhe kryesisht organizohen në shkolla publike. Ndonëse këto klasa nuk janë specifike obligative me legjislacionin, mbulueshmëria e tyre është gati se universale në praktikë.

Lejet prindërore mbeten të koncentruara te pushimi i maternitetit, por nuk financohen më nga sigurimet sociale. Fillimisht, rregullorja e UNMIK-ut (2001/27) vendosi 12 javë pushim materniteti me kompensim nga punëdhënësi (pa specifikuar shkallën e kompensimit të të ardhurave). Pastaj, me Ligjin e Punës (2012), pushimi i maternitetit u zgjat në formën që është ende në fuqi: gjashtë muaj të kompensuar nga punëdhënësi në vlerën e 70% të rrogës, tre muaj tjerë të kompensuar nga qeveria në vlerën 50% të rrogës, dhe të drejtën e pushimit tremujor shtesë pa pagesë. Me kontratën kolektive

(2014), babai ka të drejtë tri ditë pushimi me pagesë me rastin e lindjes së fëmijës.

Kjo politikë është unike në tërë rajonin në kuptimin që i ngarkon kryesisht punëdhënësit dhe përfshin shumë pak përgjegjësi shtetërore. Politika e Kosovës, sa i takon ECEC, nuk haset askund në entitetet tjera që kanë dalë nga Jugosllavia ku ato shërbime jepen për fëmijët e prindërve me punë, pra synojnë të harmonizojnë punën dhe kujdesin. Në këtë aspekt, politika e Kosovës i ngjan modelit unik të Britanisë së Madhe, ku shërbimet ECEC nuk synojnë ndërlidhjen punë-kujdes dhe as edukimin universal (si dy parimet më të përhapura në Europë). Në këtë model, ECEC orientohet kah edukimi, por vetëm duke targetuar grupet e rrezikuara.


Në tërësinë e saj, kjo politikë në mënyrë implicite është tejet familjalizuese pasi shërbimet e kujdesit të fëmijëve mbesin kryesisht të jepen në shtëpi. Në vitin 2019/2020, pa klasat përgatitore, bazuar në të dhënat administrative, mbulueshmëria e fëmijëve (deri në 6 vjeç) me ECEC ka qenë 7.2%; pa institucionet private do të ishte 3%. Me rritjen e shërbimeve private, ka nisur të vërehet dallimi klasor sa i takon qasjes në ECEC. Klasat përgatitore janë tejet të shkurtra. Me këto transfere të kufizuara dhe shërbime shumë të targetuara publike, gruaja me fëmijë pengohet të punojë. Shkalla e punësimit e gruas mbetet e ulët (14.1% në 2020). Edhe lejet nga puna nuk mbështesin degjenderizimin në kuptim të kujdesit për fëmijët, kryerjen e punëve të shtëpisë dhe punën në socializmin e fëmijëve pasi lejet koncentrohen te nëna. Kjo strukturë institucionale (përveç normave kulturore) mund të jetë një nga shkaktarët kryesorë të këtij punësimit shumë të ulët të gruas, dhe kështu një parakusht për pabarazinë e thellë gjinore. Në anën tjetër, edhe pritja se tregu do të ofrojë shërbime del të jetë shumë e sfiduar nga realiteti pasi shërbimet private shfaqen kryesisht vetëm në qytetet më të mëdha e të zhvilluara.

Kjo politikë gjithashtu pamundëson shumicën e fëmijëve të marrin aftësi sociale, të mësojnë dhe të ushqehen përtej zgjedhjeve që ofron familja. Literatura empirike tregon se përdorimi i ECEC-ve është dëshmuar përfitues sidomos për fëmijët e klasave me të ulëta shoqërore, duke mundësuar që ata të kenë pikënisje më të barabartë dhe sukses në mësim e socializim gjatë periudhës së hershme të shkollimit. Kështu, mbulueshmëria e ulët e sotme mund t'i çimentojë pabarazitë sociale të të rriturve të ardhshëm.

Nismat ligjore qeveritare përmendin pushimin prindëror

Sinjalet e reja, megjithatë, sugjerojnë se politika e familjes edhe në Kosovë do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme brenda politikës së përgjithshme sociale.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjatë vitit 2020 ka draftuar një projektligj për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror me të cilin parasheh shkurtrimin e periudhës së pushimit maternal të kompensuar nga punëdhënësi në 3 muaj (70%), rritjen e periudhës së kompensuar nga qeveria (gjashtë muaj me 50% të pagës), mban tre muajt shtesë pa pagesë sipas zgjedhjes dhe shton edhe katër muaj tjerë pushim prindëror për dy prindërit, të cilët mund ta marrin këtë pushim në të njëjtën kohë ose ndarazi, kurdo deri kur fëmija t'i bëjë dy vjet. Gjithashtu, pushimi i babait me rastin e lindjes së fëmijës zgjatet në 10 ditë.



Këto ndryshime ulin barrën mbi punëdhënësit - çka mund t'i motivojë ata të punësojnë më lehtë gratë - dhe mbi të gjitha avancojnë pushimin prindëror drejt përfshirjes për herë të parë të pushimit prindëror. Mirëpo, nuk është sqaruar se si financohet pushimi prindëror dhe deri në çfarë mase. Eksperiencia e vendeve tjera tregon që pushimi prindëror për pjesën e babait kur ka qenë i paguar me kohë ka rezultuar në përdorim të kësaj të drejte, ndryshim të normave sociale sa i takon perceptimit të pushimit të babait, lidhjes më të mirë baba-fëmijë, etj. Një mangësi tjetër është ulja e kompensimit për tre muajt e dytë të pushimit maternal.

Programi i LVV-së sinjalizon transformim substancial

Transformim shumë më të madh në politikën e familjes, për kontekstin e Kosovës, ndërkohë, paralajmëron programi me të cilin Lëvizja Vetëvendosje (LVV) garoi dhe fitoi në zgjedhje.

LVV paralajmëron instalimin e transfereve cash universale: 20 euro për secilin fëmijë nën 2 vjeç; 10 euro për fëmijët 2-16 vjeç. Ajo gjithashtu paralajmëron - çfarë është e afërt me atë që njihet si "tax credit" - shtimin e 50 euro deri në 150 euro në vit në të ardhurat e ulëta familjare. Këto transfere do të rrisin buxhetin familjar dhe kapacitetin për të investuar në shërbime të kujdesit. Një premtim tjetër i ndërlidhur që do të forcojë pozitën e familjeve ka të bëjë me politikën e saj të paralajmëruar të banimit të përballueshëm për rreth 4 mijë familje.

Premtimi më i madh i LVV-së ndërkohë është ai për 160 çerdhe (institucione të shërbimeve ECEC) në gjithë vendin. Me një numër të këtillë, dhe duke marrë parasysh rënie demografike, Kosova mund të arrijë mbulueshmëri të lartë të fëmijëve - çka do të përbente vërtet transformim të jashtëzakonshëm të shoqërisë sonë. Megjithatë, LVV nuk sqaron se për çfarë çerdhesh e ka fjalën - private apo publike; nuk

sqaron as kur do të bëhen ato. Shërbimet publike, bazuar në përvojat e vendeve tjera, e bëjnë dalimin edhe sa i takon qasjes së barabartë, edhe sa i takon garantimit të cilësisë.

LVV thotë se pushimi prindëror do të jetë 12 muaj dhe do të përfshijë pushimin e babait, por nuk e sqaron më tej se si e ka planifikuar këtë politikë në detaje, përfshirë kompensimin. Megjithatë, paralajmëron se do të vendosë gjashtë muaj pushim me pagesë në vlerë 250 euro për të gjitha nënat e papunësuar - që është përparim i dukshëm në drejtim të qasjes të vendeve europiane, ku një prag minimal i mbrojtjes jepet për të gjithë bazuar në nënshtetësi pavarësisht statusit të punësimit. Përveç kësaj, LVV paralajmëron punë njëvjeçare të garantuar, të kompensuar nga qeveria, për grupmoshat 16-18 vjeç, çfarë mund të rritë punësimin e grave të reja.

Deri më tash, kontrata sociale e Kosovës ka qenë e koncentruar te transferet për të vjetrit - dhe shumë pak e fokusuar në popullatën në moshë pune dhe të fëmijëve, sidomos me politika më ambicioze të shërbimeve. Më 2017, në shtojcën Koha për Gratë, patëm shkruar se evidenca sugjeron që barazia gjinore dhe politika më e suksesshme e familjes korrelojnë me pushtetin më të madh të së majtës. Katër vite më vonë, në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, në bazë të anketave të publikuara, rreth 60% të grave votuan për LVV-në, e cila garoi me program të majtë që nis me preokupimet e zhvillimit dhe politikës sociale. Nëse ky program jetësohet, atëherë transformimi do të ketë nisur nga votimet e muajit të kaluar.

Autori është ligjërues dhe kërkues në fushën e politikës sociale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Të gjitha referencat teorike dhe të dhënat e përdorura më lartë derivojnë nga një punim i autorit i prezantuar në Konferencën për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Shkencë Politike të UBT-së, në tetor 2020.

Politika, Gjinia dhe të Drejtat Ligjore të Grave në Kosovë



Valmira Rashiti

Viti dramatik të cilin e lamë pas nuk është se ka qenë vit aq i ndryshëm për gratë e Kosovës. Përditshmëria e tyre ka kaluar nëpër po të njëjtat shkelje edhe pabarazi, njëlloj sikur në përditshmërinë e para-pandemisë, vetëm se tash në instanca shumëfish më të theksuara. Gratë dhe vajzat kanë bartë mbi supet barrën e rimëkëmbjes prej kësaj pandemie, duke u vërtitë me këtë barrë sikur me qenë të padukshme, pa u vlerësuar, përfshirë, e aq më pak paguar. Viti 2020, në tanësi, i ka vë në pah vështirësitë edhe pasojat e papunësisë të shumicës dërrmuese të grave, siç janë të mospasurit pronë dhe moszbatimi i kornizës ligjore që ua siguron atyre (teorikisht) njëfarë mbrojtjeje.

Politikëbëmja vazhdoi të qëndrojë totalisht indiferente kundrejt nevojave të ndryshme të grave përgjatë kësaj pandemie. Në të njëjtën kohë, përgjegjësitë e kujdesit edhe të punës së shtëpisë, kësaj pune të romantizuar, veçse u shtuan e po u zinin frymën grave të punësuar e të papunësuar. Pa kurrfarë mase që të adresohet edhe lehtësohet ky bagazh i randë i kujdesit, planet për rimëkëmbje ekonomike vazhduan – pa analizë gjinore paraprake. Sipas politikëbërësve, barazia gjinore në

këto kushte pandemie nuk ishte prioritet, ajo edhe mund të priste.

“Pandemia është neutrale edhe po i prek të gjithë njëlloj”, pohonin politikëbërësit... burra! Nuk kishte fare rëndësi që ekziston dikund si i pluhrosun Ligji për Barazi Gjinore, i cili detyron institucionet për “përfshirjen e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit, të planifikimit, miratimit, zbatimit, përcjelljes dhe vlerësimit të legjislacionit, politikave ose programeve dhe buxheteve, në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, duke pasur parasysh promovimin dhe avancimin e mundësive të barabarta mes meshkujve dhe femrave” (Neni 5, paragrafi 1.3 i LBGJ). Kështu, edhe në front të proceseve vendimarrëse, gratë mbetën jashtë edhe të papërfshira. Me ç’rast, patëm masa thelbësish të verbëta nga aspekti gjinor. Natyrisht që për burrat të cilët kanë lëshu rranjë në pozita menaxheriale dhe vendimarrëse, barazia gjinore nuk është prioritet. Për ta, kjo e fundit edhe mund edhe të mos arrihet kurrë, aq më mirë! Ndërsa në anën tjetër, gjinia mbetet një përcaktues kaq i fortë i jetës së një personi, aq sa i jep përparësi vetëm një gjinie që të jetë aktive në vendimarrje, duke e bërë plotësisht të pamundur që nevojat, përvojat dhe shqetësimet e gjinisë tjetër të artikulojnë drejt edhe të adresohen siç duhet.

Në anën tjetër, barazia gjinore është vlerë e mbrojtun me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me legjislacion përkatës primar (por jo edhe me atë sekondar). Por, çfarë ndodh kur ligjet të cilat janë kriju për t’i luftu pabarazitë, përfshirë ato gjinore, nuk respektohen as nga vetë institucionet. A ka jetë përtej frazës: “Ligjet ekzistojnë dhe janë mirë të hartuara, por nuk po zbatohen”? Kam bindjen që vërtetimi rreth kësaj fraze qysh tash e 14 vjet, nga viti 2007, atëherë kur u kalua edhe Ligji i parë për Barazi Gjinore. Por, kush duhet mbajtë llogaridhënës për këtë status quo? Apo, a ekzistojnë dispozitat mjaftueshëm të fuqishme për ta bërë të obligueshëm realizimin e të drejtave të grave deri në arrijten e barazisë gjinore dhe jo vetëm promovimin e këtyre të drejtave?

Korniza ligjore për të drejtat e grave përbëhet nga disa ligje kryesore të cilat janë hartuar dhe amendamentuar shumë herë ndër vite, kjo me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të grave dhe drejt arrijtes së barazisë gjinore. Thëksi i rëndësisë bie më së shumti mbi ligjet në vijim: Ligji për Barazi Gjinore; Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit; Ligji për Familjen; Ligji për Trashëgiminë; Ligji i Punës; Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Kodi Penal, i amendamentuar me definicionin mbi dhunën në familje dhe ngacmimin seksual në vitin 2018.

Ligji për Barazi Gjinore, mes shumë tjerash, thërret për përfundim të barabartë në të gjitha sferat ekonomike dhe sociale. Thërret për masa afirmative në punësim, për të arritur deri tek barazia gjinore, buxhetim të përgjeshëm gjinor, mbajtje të të dhënave të ndara sipas gjinisë, si dhe për mbrojtje nga ngacmimi seksual. Ndërrkaq, sipas Analizës Gjinore të Rrjetit të Grave të Kosovës (2018), gratë mbeten të nënpërfaqësuar si zyrtare të zgjedhura në kuvendet komunale

(35%) dhe në Kuvend të Kosovës (32%); si nëpunëse civile në pozita të larta vendimarrëse në nivel komunal (20%) dhe në nivel kombëtar (27%); në poste politike si kryetare të partive, ministre, dhe kryetare të komunave (0 nga 38); si dhe në dialog dhe negociata. Institucionet nuk i aplikojnë masat afirmative në punësim, sepse vazhdojnë të rekrutojnë sipas parimit të (pseudo)meritokracisë. As këtë vit, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk i përfili dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore, përkundër faktit që ky i fundit është lex specialis dhe si i tillë e shfuqizon LPZ-në. Si pasojë e moszbatimit të Ligjit për të drejtën në pronë dhe trashëgimi, gratë vazhdojnë të qëndrojnë në martesë, lidhje apo familje abuzate, duke mos pasur alternativë tjetër ekonomike. Vetëm 3% e grave në Kosovë kanë pronë në emër të tyre. Dhuna në baza gjinore u raportua 40% më shumë përgjatë vitit 2020, e megjithatë për të mbijetuarat e dhunës ende nuk ka zgjidhje afatgjate. Banimi social, përparësia në punësim dhe riintegrimi shoqëror mbesin ende të porealizueshme, përkundër faktit se Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020 parashohin që komunat janë përgjegjëse të ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme për rehabilitimin dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave të dhunës në familje, e që përfshin edhe çështjen e sigurimit të vendbanimit afatgjatë.

Për më tepër, Ligji aktual i Punës vazhdon të mos jetë në harmoni me direktivat e BE-së, duke forcuar kështu rolin tradicional të gruas në përkujdesjen e fëmijëve, me një

model të lejes së lehonisë dhe atësisë i cili i përjashton burrat nga përgjegjësitë e kujdesit. Drafti i ri i këtij ligji vazhdon të qëndrojë pezull dhe i varur nga stagnimi politik. Ndërkohë, disa ligje specifike trajtojnë diskriminimin me bazë gjinore në punësim, mirëpo vetëm në mënyrë krejt të përgjithshme. Kuadri ligjor mbetet i paharmonizuar, me mbivendosje të përkufizimeve dhe sanksioneve të ndryshme, gjë që po përkthehet në paqartësi të konsiderueshme dhe pasiguri juridike në gjykata.

Retrospektiva nëpër pasojat që ka sjellë moszbatimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore duhet të shërbejë si një mësim për hartimin e normave të mëtejshme dhe zbatimin e tyre, e jo të vazhdohet me avazin e njëjtë të moszbatimit të ligjeve dhe mungesës së sanksionimit për këtë gjë. Është thelbësore që dispozitat ligjore të hartohen dhe amendamentohen në atë mënyrë që të mos jenë të zhveshuna plotësisht nga aspekti social dhe normat të cilat i dëmtojnë kaheerë gratë dhe vajzat. Hartimi edhe zbatimi praktik i këtyre dispozitave duhet medoemos të bëhet duke pasur parasysh gjendjen e tanishme të grave në Kosovë, si dhe duke i përfshirë ato në procese legjislative (mes tjerash), e gjithë kjo me kujdes të shtuar që të synohet përparim në aspektin legjislativ, i cili përkon me arrijten e drejtësisë sociale dhe barazisë gjinore, e jo me regres!

Autorja është aktiviste feministe dhe asistente ligjore në Rrjetin e Grave të Kosovës.

Feminizmi i majtë do të na çlirojë!



Liridona Sijarina

“Punët e grave nuk kryhen kurrë” - kjo është e vërteta që e shënjon përvojën e grave punëtore brenda shtëpisë. Kjo si grackë shtëpëse e cila iu është imponuar atyre nga patriarkalizmi, për t’u thelluar dhe përdorur në formë edhe më të egër nga kapitalizmi i cili sot funksionon duke i mbajtur, ndër të tjera, me dikotominë punë e paguar / e papaguar. Dhe duke ua veshur këtë të fundit grave. Siç vëren edhe Engelsi, “Ndarja e parë e punës ka ndodhur mes grave dhe burrave me ndarjen e me lindjen e fëmijëve”. Sipas kësaj, aftësia biologjike për të lindur fëmijë ka ndikuar në krijimin e roleve gjinore, gjë që më pas ua ka përcaktuar edhe pozitën socioekonomike në familje, duke e asociuar çdo herë e më shumë shtëpinë dhe kujdesin me gruan, përdërisa i ka shndërruar burrat në “fitues të bukës”. Kjo ndarje ka çuar në shfrytëzim të punës së grave nga çdo sistem, duke e përcaktuar peshën e tyre si prodhuese dhe kujdestare të forcës punëtore dhe jetës, por me një hile të madhe. Duke mos ua njohur kontributin si punë. Për rrjedhojë, kjo ka bërë që në familje pasuria të koncentrohet tek burri, duke i varfëruar gratë dhe duke i bërë ato klasë në vetë, në krahasim me burrat.

Ekonomia klasike dhe kritikant klasike ndaj saj na tregojnë se sa vlen prodhimi, duke e barazuar atë me prodhimin e të mirave materiale dhe se si krijohen raportet shtypëse në procesin e prodhimit të të mirave. Megjithatë, ato dështojnë të shohin se si përgatitja e bukës, kujdesi për të vegjlit, të rriturit dhe pleqtë e shtëpisë, larja e enëve e çorapeve, i kontribuon ekonomisë dhe prodhimit e vazhdimin të jetës. E për ekonominë, prodhimin falas të forcës punëtore.

Feminizmi i punës paraqet para së gjithash një problem patriarkaliteti, i cili më vonë është transformuar në një shtypës edhe të kapitalizmit dhe si i tillë në asnjë mënyrë nuk mund të zgjidhet pa një pozicionim ndërthurës të cilin e ofron feminizmi. Kjo pasi që vetëm feminizmi me qasjen e vet ndërthurëse është duke ofruar një rrugë premtuese të zgjidhjes, duke i përfshirë të shtypurat/it në procesin e artikullimit dhe çlirimit dhe duke e parë shtypjen në të gjitha format që mund të marrë.

“Pagë për punë të shtëpisë”, e Silvia Federici, e cila zëshem përshkoi marsin e vitit të kaluar në Kosovë, e shënoi një kthesë në diskursin feminist lokal këndej e tutje, duke i shtyrë kufijtë e definicionit të tregut të punës dhe duke e kontestuar konceptin klasik të punës. Kjo edhe më tej e ktheu edhe më majtas, dukshëm më majtas, lëvizjen feministe në Kosovë. Duke e artikulluar çdo herë e më

shumë një të majtë e cila i kishte munguar hapësirës kritike, këto thirrje i transferuan në rrugë muhabetet e shtëpisë që gratë, të vetëdijshme për dhunën që iu ushtrohet atyre, e kanë denoncuar vazhdimisht. Kjo lëvizje majtas e përgjeshëtroi edhe më qartë premtimin e së djathtës “feministe” që barazia mund të arrihet brenda status quo-së, duke treguar që vetë dizajnim i sistemit është problemi. Çrrenjosja është alternativë. E në anën tjetër, kërkesa të tilla jo-guditërisht trazuan edhe qarqet tjera klasike, siç janë disa rryma brenda të së majtës, të cilat vështirë mund ta paramendojnë një burrë me përparëse tek gatuar darkën. Ndonëse këto teori kanë ofruar një analizë të thuktë të shtypjes dhe mjetet për çlirim, paaftësia e tyre për të skenuar më drejt shtypjen ka çuar në një definim të kufizuar të tregut të punës dhe shtypjes, e që pashmangshmërisht ka rezultuar edhe në artikullim përjashtues të projektit emancipues. Mbi këtë, feminizmi si ndërhyrje dhe projekt më emancipues e ka zgjeruar fokusin, duke përfshirë shumësi të shtypjeve që duhet analizuar dhe zhdukur dhe duke konkluduar se eliminimi i një shtypjeje i kontribuon avancimit përmbajtësor.

E çka është duke prezantuar lëvizja feministe e majtë?

Për feministet e majta, amvisëria është punë dhe amvisëria nuk është grua. Ndërsa, problemi është ekonomia thellësisht e gjinuar, e

prodhuar nga patriarkati kapitalist, racist dhe heteronormativ, i dizajnua për të shtypur dhe eksploatuar grupe të caktuara identitare në shërbim të një pakice. Ekonomia është duke u mbajtur nga gratë që prodhojnë forcë punëtore, të nevojshme për funksionimin e kapitalizmit, ndërsa mbetet e definuar dhe e mirëmbajtur nga burrat. Kjo duhet ndryshuar, për të lëvizur drejt një organizimi ekonomik dhe politik të drejtë. E kjo mund të bëhet me qëndrëzimin e riprodhimit të jetës dhe punës së kujdesit në qendër të politikave ekonomike dhe zhdukjen e të gjitha formave të shtypjeve mbi baza identitare dhe klasore.

Ekonomia që projektohet nga kjo alternativë është ekonomia e cila, në fjalët e Tithi Bhattacharya, priorizon jetën mbi profitin. Ekonomia feministe kërkon që të lëvizet nga ideja e rritjes në terma të rritjes së GDP-së, në një ekonomi që e vendosë mirëqenien në qendër. Ajo e heq luftën për mbijetesë dhe dikotomitë klasore, duke e zhdukur konkurrencën ekonomike si kusht për mirëqenien e cila në kushte të patriarkatit kapitalist krijohet veç duke e luftuar tjetër/in dhe dominuar atë.

Përfshirje e drejtë dhe përmbajtësore e grupeve dhe individëve në lëvizje. Për këtë, njohja më e thellë e formave të shtypjeve që krijohen në këto kushte është cruciale. Dhe shndërrimi i këtyre përvojave në forca ndryshimi është mundësia e vetme në këtë proces. Potenciali ndryshues i feminizmit qëndron në

njohjen dhe përfshirjen e përvojave, pozicioneve, kontributeve dhe nevojave të ndryshme, derisa lentet dalluese të neutralizohen.

Organizim politik solidarizues. Feminizmi i majtë është duke prezantuar një qasje më të drejtë ndaj masës, duke ua njohur përvojën dhe kontributin unik gjithsecilës/it dhe nevojën e lëvizjes kolektive përmes shtrimit të diskutimit dhe ndërgjegjësimin kolektiv për zhvillimin e një lufte e cila nuk e lë askënd pas dhe më pak të rëndësishëm.

Përfundimisht, siç na mëson Gerda Lerner, “patriarkati është produkt historik dhe si i tillë mund të përmbysset veç me mjete politike”, tekta na thërret për t’u rreshtuar në luftën e përbashkët për rishkrimin e “fatit”. E siç po tregohet, ky rishkrim bart potencial progresiv veç duke qenë feminist dhe i majtë. Lëvizja e cila po ndërtohet është duke e ideuar dhe punuar për një të ardhme e cila trupëzon luftën tonë për çlirim individual dhe kolektiv nga shtypja dhe tirania e patriarkëve, të pasur, racistë dhe heteronormativë. Përmes denoncimit të asaj se çka realisht i shtypë gratë - patriarkatin kapitalist - feministet e majta janë duke e theksuar çdoherë e më shumë një lëvizje feministe të majtë, e cila mund të shndërrohet në forcën me potencialin më emancipues në vend dhe përtej.

Autorja është aktiviste feministe.

Agjencia për Barazi Gjinore, aleate e grave në kohë të vështira



Edi Gusia

Në prag të këtij njëvjetori të përballjes me situatën e COVID-19, një përpjekje për të përmbledhur dhe reflektuar mbi çfarë kemi përjetuar, veprimet tona, angazhimet e ndërmarra dhe perspektivat e krijuara për t'iu kundërpërgjigjur të panjohurës dhe siguruar të ardhmen.

Viti i bashkëjetesës me COVID-19 është një nga më të vështirët të përjetuar që nga periudha e pasluftës. Sikurse e tërë bota, edhe ne u përballëm me një situatë komplekse të panjohur e cila riktheu vëmendjen se sa i brishtë është civilizimi ynë në këtë fillimshkull përkundër të arriturave të mëdha në shkencë, teknologji dhe mjekësi. U përballëm dhe vazhdojmë të përballlemi me humbje tragjike përkundër një rreziku të padukshëm me pasojë tragjike plot dhimbje. U detyruam të adaptohemi në kushte të reja jetese dhe funksionimi, me sakrificë jo të vogla në aspektin human, profesional dhe financiar. Nuk kishim të planifikuar strategji parandalimi apo luftimi të emergjencave të natyrave si kjo lloj pandemie, e cila ditë pas dite u bë kombinimi i gjithçkaje dhe që përfundimisht na ndryshoi.

Pandemia na rikujtoi dhe njëherë se në situata emergjente kategoritë më të ndjeshme afektohen edhe shumëfish dhe në shumë aspekte njëherazi. Në tërë botën gratë dhe vajzat u përballën me dyfishim të obligimeve dhe përgjegjësisë të përkujdesjes ndaj kategorive në nevojë, të sëmuruve, humbjes së vendeve të punës, orëve shtesë të angazhimit, duke tentuar të balancohet puna nga shtëpia me përkujdesjen ndaj fëmijëve, edukimin e tyre online, tentimin për ta ruajtur shëndetin e të gjithë atyre që na rrethojnë, punën online, gjetjen e formave të reja të mbijetesës ekonomike dhe asaj emocionale, mbrojtjes në mënyrë të vazhdueshme, kufizimit të shërbimeve, kufizimit të lëvizjes, kufizimit të të gëzuarit dhe dhënies së lamtumirës.

Agjencia për Barazi Gjinore në këtë situatë të krijuar demonstroi udhëheqësinë, ekspertizën e saj dhe avokoi fuqishëm për rrezikun dhe efektet e pandemisë ndaj grave në tërësi, si dhe grave përkritazi me kontekste, fenomene dhe përkatësi të caktuara, sipas nivelit të përshkallëzimit të rrezikshmërisë, efekteve shumëplanëshe të pandemisë dhe ofrimit të zgjidhjeve, apo përkrahjeve adekuatë dhe të qëlluara. U rigrupuam, u aktivizuam, u riadaptoam në organizimin tonë institucional, i riadaptoam politikën ekzistuese, i rivlerësuan prioritetet dhe krijuam programe e projekte shtesë, me përgjigje të përshpejtuara dhe të targetuara, duke synuar mbulimin me shërbime dhe mbështetje të grupeve sa më të mëdha të grupmoshave të ndryshme, gjerësisë së fushave socioekonomike dhe shpërndarjes mbarëvendore gjeografike. Pandemia provoi të ishte testi ynë më i madhor në ekzistencën 15 vjeçare të Agjencisë.

Në muajin prill të vitit 2020, tri javë pas shpalljes së kufizimit të lëvizjes në nivel vendi, përmes bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës - Departamenti për Politikë Sociale dhe i Familjes, dhe partnerëve ndërkombëtarë, Agjencia propozoi iniciativën e themelimit të Strehimoreve tranzicionale në karantinë, në mbrojtje të jetëve të grave viktime të dhunës në familje, pavarësisht dhe njëkohësisht me synimin e mbrojtjes së shëndetit të viktimave të strehuara në strehimore dhe të stafit të strehimoreve. Strehimorja e përkohshme në karantinë gjeti aprovimin nga Qeveria dhe ishte funksionale në shërbim të rasteve të paraqitura, në një objekt të sigurisë së lartë, me kushte materiale cilësore dhe shërbime adekuatë shëndetësore e psikologjike.

Përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punës, në fillim të pandemisë shtuam mjetet financiare dhe pajisjet për rjetin e strehimoreve me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe në reflektim të masave për të luftuar COVID-19.

Avokuam për një rishpërndarje të përshtatshme, realiste dhe të targetuar të ndihmës ekonomike për gratë, qoftë përmes integritit të perspektivës gjinore në masat e ndërmarra sekto-

riale, por edhe atyre të veçanta me fokus të grupet e grave. Si rezultat, Agjencisë iu ndanë dy milionë euro, prej të cilave një milion në fazën e parë u akorduan institucioneve të arsimit parashkollor privat, përmes të cilit u mbështetën 115 institucione parashkollore private në nivel vendi. Në këtë mënyrë siguroam vazhdimësinë e ndërmarrësisë që ushtrohet dhe në pronësi të grave: 108 pronare gra siguruan jetëgjatësinë e biznesit dhe përmirësuan kushtet e tij, 1145 edukatore gra dhe 65 burra u siguroam vazhdimësinë e punësimit, 6938 fëmijëve u siguroam edukimin e vazhdueshëm dhe familjeve - prindërve mbështetje direkte në kujdesin e fëmijëve, mundësi për të vazhduar punën apo për t'iu vazhduar përpjekjet e tyre për angazhim në tregun e punës dhe balancimit të jetës familjare, përgjegjësi familjare prej ku më së shumti afektohen gratë, së bashku me angazhimin shoqëror dhe të punës.

Në shtator të 2020, sipas sistemit të Kombeve të Bashkuara "Gjurmuesi Global Gjinor në Kundërpërgjigje ndaj COVID-19", Kosova kishte 5 masa aktive gjinore, një masë në fushën e sigurisë ekonomike dhe katër masa në fushën kundër dhunës ndaj gra. Kosova kishte më shumë masa relevante gjinore sesa Mali i Zi, Maqedonia Veriore, Bosnja dhe Hercegovina, të njëjtin total numër masash si Kroacia, Sllovenia, Finlanda, Estonia, Suedia, etj. Për dallim nga shumë vende të tjera të zhvilluara në rajon, në Bashkimin Europian dhe vende të tjera të zhvilluara si Zelanda e Re, Australia, SHBA-të dhe Kanadaja, në të njëjtën periudhë raportuese, sipas këtij gjurmuesi, në grupin prej 47 shtetesh Kosova ishte në mesin e 15 vendeve që kishte masë për sigurimin ekonomik të grave përkrah Kanadasë, Spanjës, Belgjikës, Italisë, Sllovenisë, Letonisë, SHBA-ve, Shqipërisë, Serbisë, etj.

Në periudhën dhjetor 2020 - shkurt 2021, Agjencia vazhdoi me zbatimin e fazës së dytë të masës mbështetëse me fondin prej një milion eurosh për fuqizimin ekonomik të grave, për bizneset e vogla dhe bizneset familjare në pronësi të grave që drejtohen prej tyre, gratë e vetëpunësuar, shërbimet për përmirësimin e biznesit dhe për shtresat në nevojë. Po në të njëjtën periudhë, strehimoret për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje u

mbështetën fuqimisht duke eliminuar pasigurinë, fragmentarizimin e shërbimeve dhe mbrojtjes së viktimave.

Komunikimi dhe avokimi i shtuar me krahun politik vendimmarrës është domosdoshmëri absolute nëse duam që, edhe në një situatë emergjente, agjenda e barazisë gjinore, prioritetet dhe nevojat e grupeve të grave pa përkrahje, pa mbështetje ekonomike, shoqërore, informim dhe këshillim, si dhe nismat dhe përpjekjet e grave në rrugën e zhvillimit dhe transformimit të vendit - të marrin vëmendjen dhe mbështetjen e merituar. Falë komunikimit të shtuar, propozimeve të thukëta, progresive dhe vizionare, Agjencia gjeti mbështetje institucionale dhe financiare si nga Qeveria Kurti dhe Qeveria Hoti, ashtu edhe personalisht nga të dy Kryeministrat.

Pandemia na rivertetoi edhe njëherë se kur gratë janë në pozita vendimmarrëse dhe kur kanë vullnet politik, vizion zhvillimor e ku nuk mungon perspektiva gjinore, atëherë mirëkuptimi, avokimi dhe vendimmarrja i tejkalojnë prishmëritë dhe krijojnë rezultate konkrete, ku efektiviteti dhe eficientia e politikave publike prek dimensionet të reja dhe shkon në nivele të patestuara më parë. Bashkëpunimi dhe komunikimi i vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë, Albulena Haxhiun, për çështjet e viktimave të dhunës dhe çësjet në drejtësi, me Ministrinë e Financave, Hykmete Bajramin, për masat e rimëkëmbjes ekonomike, na ofruan hapësira koordinimi, adresim problemesh të kahershme në kohë reale, hapësira të adresimit të pandemisë me një perspektivë gjinore relevante dhe në bazë prioritetesh legjitime dhe emergjente, si dhe ridimensionim të fushëveprimit të barazisë gjinore në zbatimin e politikave anti-COVID.

Krizat dhe emergjencat kërkojnë kundërpërgjigje komplekse, ato nuk mund të adresohen përmes mungesës së vazhdimësisë dhe koherencës, fragmentarizimit, apo mbivendosjes e duplikimit. Me përkushtim vazhduar zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, të aprovuar nga Qeveria Kurti në maj të 2020-ës, ndërsa vazhduam kombinimin dhe modifikimin e aktiviteteve të Programit me masat e aprovuara për rimëkëmbjen ekonomike të Qeverisë Hoti, si dhe nxitim vendimmarrësit

për një vëmendje të shtuar ndaj obligimeve ndaj Programit për Barazi Gjinore në formulimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike.

Në këto kohë të vështira duhet përmendur mirëkuptimi, gatishmëria dhe mbështetja e pakursyer e partnerëve tanë të përhershëm multilateralë, si UN WOMEN dhe UNFPA, si dhe bilateralë, si SIDA dhe GIZ, për mbështetjen e tyre financiare dhe për sigurimin e asistencës teknike të vazhdueshme dhe në kohë reale ndaj Agjencisë, apo institucioneve të tjera shtetërore.

Në vitin që lamë pas, shënuam dhe 15 vjetorin e krijimit të Agjencisë për Barazi Gjinore. Do të kishim dashur ta festonim me të gjithë ata që kanë kontribuar në çështjet gjinore në Kosovë. Por, besoj se rezultatet e arritura me përpjekjet e stafit të Agjencisë, përkushtimit të bashkëpunitorëve tanë në institucionet shtetërore dhe partnerëve, janë provimi i pjekurisë së institucionit të Agjencisë, një provim përkundër në momentet më të rënda të përjetuara që nga përfundimi i luftës.

Agjencia shpreh mirënjohjen ndaj bashkëpunitorëve dhe partnerëve, grave dhe vajzave, por edhe qytetarëve, për mbështetjen e pakursyer gjatë këtij viti. Ne i falënderojmë të gjitha ato gra që kontribuuan dhe kontribuojnë në historinë e angazhimit feminist në Republikën e Kosovës, në kuadër të procesit të shtetndërtimit: qoftë si pjesëmarrëse të angazhuara në rezistencën paqësore, luftën e UÇK-së, qoftë si pjesëtare të shoqërisë civile, medias, akademisë, institucioneve shtetërore dhe organizmave politike, bashkëpunitorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë, grave dhe vajzave të cilat me angazhimet e tyre personale, ditore, me aktivizimin, përpjekjet dhe vullnetet e tyre, e bëjnë Kosovën një vend që me hapësirë të vogël gjeografike, me përpjekje historike monumentale, dëshmon gatishmërinë dhe dëshirën për progres, për një të një të ardhme paqësore e të dinjitetshme, për realizim ëndrrash e dëshirash, për gëzimin e të drejtës së jetës përmes barazisë e barabarësisë, realizimit të të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale.

Autorja është Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit.

A ka vend për gratë fetare në lëvizjen feministe?



Diana Morina

Para pak javësh, në një nga klasat po diskutonim për fenë dhe gjininë, me theks të veçantë gratë myslimane. Meqë në universitetin ku unë studioj (Universiteti i Lundit) një nga principet që të paktën mburrimi se na udhëheq është bashkëdyzimi i mendimit dhe praksës feministe, e vetmja pyetje që kisha në kokë ishte se a mund të bashkekzistojnë në praktikë brenda së njëjtës lëvizje feministe gratë fetare me ato jofetare dhe si? Përgjigjja e ligjërueses ishte e shpejtë dhe e qartë: "JO, nuk mundet!". Jo, nëse flasim për interpretim dhe praktikim fundamentalist të fesë që shtyn këto gra të kenë urrejtje dhe refuzim sistematik kundrejt bazikes së feminizmit, shprehimisht seksualitetit, orientimit seksual, autonomisë mbi trupin, publikes, e të tjera.

Teksa pajtoj plotësisht me një deklaratë të tillë që i dënon lëvizjet fetare moderne të cilat e përdorin fenë për të shtirë kontrollin dhe autoritetin mbi popullsinë, lëvizje këto të udhëhequra kryesisht nga burrat dhe që shtypnë gratë, dua ta mbaj vëmendjen tek rreziku i gjeneralizimeve dhe barazimeve automatike të fesë me fundamentalizmin, apo të çdo grupaje fetare si fundamentaliste. Zhvillimet e

dekadave të fundit (shto këtu dhe historinë e kolonializimit), kanë çuar drejt një përdorimi racist, selektiv dhe të gjinjzuar të termit fundamentalizëm, kryesisht nga shtetet perëndimore në raport me vendet e Lindjes së Mesme, apo vendet me shumicë myslimane. Gjithsesi, përdorimi kapitalist e hegjemonik i termit nga qeveritë neoliberale perëndimore, e shpeshherë edhe nga lëvizjet feministe neoliberale, nuk do të thotë që lëvizjet fundamentaliste nuk janë evidente mes feve të ndryshme, edhe pse variojnë në formë, qëllime e rreshtime ideologjike. Për më tepër, analizuam nga një perspektivë gjinore mund të konkludojmë që brenda lëvizjeve fetare fundamentaliste, në emër të fesë, ruajtjes së traditave dhe interpretimeve klasike të teksteve fetare, grave u mohohen vazhdimisht të drejtat dhe liritë fundamentale në sferën private e publike. Si aktiviste dhe shkollare feministe, përveç që na kërkohet të dekonstruojmë kuptimin semantik të termit "fundamentalizëm", ne duhet të qëndrojmë syhapura kundrejt leximeve mizogjene të fesë që rëndojnë mbi gratë dhe të mos tolerojmë diskriminimin gjinor që gjen strehë në diskursin fetar.

Lëvizjet feministe dhe gratë fetare në vazhden e debatit Perëndim/Lindje, është esenciale të reflektojmë shkurtimisht mbi impaktin që këto debate kanë pasur në zhvillimin e feminizmeve perëndimore dhe atyre në lokacione të tjera në botë. Me shumë të drejtë, feministet postkoloniale ato fetare, ndër të tjera, vazhdojnë t'i kritikojnë kuptimet universale të çlirimit, emancipimit, ag-

jensisë dhe rezistencës që kanë bërë nga feminizmi i grave të bardha liberale. Termit mbi të cilat definohet agjencia dhe rezistenca nuk janë homogjene dhe universale. Siç thotë Leila Ahmed, Perëndimi nuk e zotëron feminizmin, feminizmi buron gjithkund në forma të ndryshme dhe termit e Perëndimit nuk duhet të jenë pika jonë krahasimtare. Gjithsesi, për një kohë të gjatë diskutimi mbi fenë dhe gratë është mbajtur në nivel të privates. Në një nga shkrimet e saj, Mir-Hosseini analizon marrëdhënien mes fesë dhe feminizmit, me theks në supozimet e zakonshme që feminizmi mund të shfaqet dhe të lulëzojë vetëm atëherë kur feja mbahet brenda hapësirës private. Privatizimi i fesë, sipas saj, ka shërbyer si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të lëvizjeve feministe perëndimore që ka përjashtuar gratë fetare. Margot Badran, një autore tjetër seminale e fesë dhe feminizmit, thekson se në analizat feministe duhet treguar kujdes i shtuar mbi premissat në të cilat teorizohet, e të cilat janë hasur në mendimin feminist perëndimor gjer vonë. Nëse nise mi nga premissa se feja është për se e dëmshme për gratë, dhe si e tillë duhet izoluar e larguar, nuk do të thotë që feja do të zhduket e as shoqëritëdh e kulturat të cilat njihen si fetare.

Paralelisht, gratë në vendet islame apo me shumicë myslimane, kanë gjetur mënyra për të luftuar për drejtësi e barazi gjinore. Lëvizjet dhe debatet brenda këtyre vendeve kanë nuanca të shumta meqë gratë u rreshtuan në lëvizje të ndryshme. Edhe sot, debatet mbeten aktive mes autoreve e aktivisteve që janë të rreshtuara në lëviz-

je feministe sekulare kundrejt atyre në lëvizje feministe islamiste. Pavarësisht rreshtimit, e rëndësishme është që gratë kanë arritur të gjejnë mënyra për t'i kontestuar praktikat shtypëse. Si shembull, shkollaret iraniane Mir-Hosseini dhe Najmabadeh përmes përdorimit të metodologjive të ndryshme të bazuara në shkencë sociale, në kombinim me qasje që buronjë nga islamizmi klasik, kanë arritur t'i rilexojnë tekstet e shenjta, në këtë rast Kuramin, dhe t'i dekonstruktojnë interpretimet klasike që në bazë janë mizogjene dhe joegalitare. Mënyra e tyre dhe e shumë grave të tjera ka qenë përdorimi i gjuhës së teksteve fetare për ta artikuluar një feminizëm të ri dhe për t'i zgjeruar limitet e predikimeve fetare apo fundamentaliste, qoftë brenda lëvizjeve sekulare apo atyre fetare. Kjo na jep të kuptojmë që alternativat të cilat gratë fetare dhe ato jofetare i kanë për të bashkëvepruar brenda së njëjtës lëvizje feministe sekulare janë ekzistente, ashtu siç janë ekzistente alternativat për të mos qëndruar nën të njëjtën ombrellë të feminizmit.


Cilat janë alternativat në Kosovë? Në censusin e fundit në Kosovë, 826.039 gra janë vetëdeklaruar si besimtare të fesë islame, 19.127 katolike, 12.669 ortodokse, dhe 574 të besimeve të tjera. Ndonëse nuk guxojmë të aludojmë për kuptimin që feja bart për këto gra, e as t'i minimizojmë ato vetëm në numra, të paktën arrijmë të kuptojmë që çështja e fesë dhe grave duhet adresuar më sistematikisht. Diskutimet në diskursin publik duhet të shtrihen përtej shamisë, ndërsa

diskursi publik fetar që e redukton rolin e grave vetëm në sferën private dhe e sheh feminizmin si prurje të sforcuar perëndimore duhet dekonstruuar e sfiduar.

Një feminizëm ndërthurës na fton ta ekzaminojmë fenë në gërshetim me strukturat tjera shtypëse (patriarkati kapitalist, kultura), duke eksploruar këstu efektet që kanë në organizimin e punës e riprodhimit social dhe definimit të agjencisë së grave fetare vis-à-vis akteve të tyre të rezistencës. Praktikant nga vendet tjera na tregojnë që nuk ekziston një model a një rrugë që mund ta ndjekim të gjitha, sepse vetë praktikimi i fesë dhe kuptimi i saj varion nga konteksti në kontekst. Çështje të tilla na thërrasin t'i rivedinojmë në termat tanë kontekstuale motërzimin dhe solidaritetin, si dhe të shtrihemi përtej një ideje motërzimi homogen që rrezikon të zaptojë agjencinë e grave fetare. Njo-hja e shumësisë së subjekteve gra dhe identiteteve të tyre na tregon që duhet të krijojmë hapësira të reja që mundësojnë sjelljen e narrativave personale të grave të besimeve të ndryshme në publik, përtej mureve të shtëpisë. Fundja, jo domosdoshmërisht të gjitha duhet të përkasim në një lëvizje të vetme feministe nëse pikëpamjet tona mbi drejtësinë shoqërore dhe gjinore janë kontradiktore në thelb. Në të kundërtën, në qoftë se gratë fetare të besimeve të ndryshme pajtojnë me termat dhe luftën e lëvizjes feministe në Kosovë, atëherë lëvizja ka vend për të gjitha ne.

Autorja është aktiviste dhe feministe.

Izolimi i dyfishtë: Nga pandemia dhe homofobia



Agon Rexhepi

Pandemia globale, e cila e ka kapluar botën tash e një vit, ka përkrahur rreziqet dhe njëkohësisht ka shtuar edhe rreziqet e reja. Përballja me pandeminë, e cila ka prekur disa njerëz më shumë se disa të tjerë, ka vënë në pah dhe njëkohësisht ka thelluar pabarazitë shoqërore.

Grupet e marginalizuara shoqërore kanë qenë më të prekura nga kjo pandemi dhe nga vështirësitë që kanë ardhur bashkë me të. Personat LGBTIQ+, si një prej kategorive më të shtypura shoqërore, janë "sulmuar" nga pandemia në forma të ndryshme, respektivisht në aspektin social, emocional e psikik dhe ekonomik.

Në fakt, izolimi nuk është diçka e panjohur, e padëgjuar dhe e përrjetuar për shumë persona LGBTIQ+. Niveli i lartë i homofobisë e transfobisë, shtypja sistematike, paragjykimet, diskriminimi, rreziku në vendin e punës, në shkollë a në hapësira publike, janë vetëm disa prej arsyeve që detyrojnë shumë persona LGBTIQ+ të jenë të "izoluara". "Izolimi" i personave LGBTIQ+ nënkupton krijimin e mureve mbrojtëse për ta mbajtur fshehtë identitetin e tyre gjinor e seksual, si mënyrë e mbrojtjes nga diskriminimi, dhuna dhe shtypja. Kjo "karantinë" e personave LGBTIQ+, mbi të gjitha, është strategjike dhe e planifikuar, sepse këta persona i njohin rrethanat e tyre shoqërore dhe

mund t'i imagjinojnë sfidat me të cilat do të përballëshin po të dilnin nga kjo "karantinë"

Izolimi gjatë pandemisë ka qenë sfidues për të gjithë njerëzit. Mirëqenia sociale dhe emocionale e shumë njerëzve është përkrahësuar si rrjedhë e karantinës dhe situatës pandemike. Mirëpo, për personat LGBTIQ+ izolimi ka qenë edhe më i rëndë e më sfidues, duke pasur parasysh se shumë prej tyre mund të kenë qenë të izoluar në mjedise helmuese, përjashtuese dhe të dhunshme.

Shoqëria jonë vazhdon të jetë e mbyllur karshi diversitetit të identiteteve seksuale e gjinore dhe si pasojë niveli i homofobisë e transfobisë është i lartë. Kjo reflekton edhe te familjet kosovare, të cilat vazhdojnë të jenë shtypëse dhe torturose për personat LGBTIQ+. Shumë persona LGBTIQ+ kanë qenë të detyruar të izolojnë në familjet e tyre, ku në vend të solidaritetit e kujdesit gjatë pandemisë, në këto mjedise familjare ata kanë hasur në dhunë psikologjike dhe/apo fizike, në kufizim të lirisë të manifestimit të vetes së tyre, në komente e kërcënime për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor, apo çështje të tjera që lidhen me personalitetin e tyre.


Karantinimi në mjedise të tilla helmuese e shtypëse ka ndikuar në shëndetin mendor të personave LGBTIQ+, respektivisht në shtimin e ankthit, stresit dhe problemeve të tjera. Po ashtu, për shkak të karantinës dhe situatës, edhe qasja në terapi e seanca ka qenë më e vështirë për shumë persona. Gjatë pandemisë, organizatat joqeveritare dhe grupe joformale kanë ofruar ndihmë psikologjike falas, por për shumë persona ka qenë e pamundur të gjejnë hapësirë të sigurt në shtëpitë e tyre për të folur me një profesionist të fushës.

Gjithashtu, izolimi ka thelluar ndjenjën e vetmisë tek njerëzit, e sidomos te personat LGBTIQ+. Rrethi shoqëror është kryesisht hapësira më e sigurt dhe përkrahëse për personat LGBTIQ+. Pandemia ka vështirësuar dhe/apo pamundësuar kontaktet me rrethin shoqëror e përkrahës për personat LGBTIQ+ dhe rrjedhimisht këta të fundit mund të jenë ndjerë më të vetmuar. Për shkak të izolimit dhe situatës socioekonomike, në mungesë të mekanizmave shtetërorë dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e pandemisë, shumë persona kanë humbur vendin e tyre të punës dhe si rrjedhojë janë ballafaquar me probleme ekonomike. Ky problem ka prekur edhe personat LGBTIQ+, të cilët ende kanë vështirësi në punësim dhe në trajtim të dinjitetshëm në punë.

Problem tjetër që kanë hasur personat LGBTIQ+ gjatë pandemisë ka qenë edhe qasja në shëndetësi, sidomos për personat transgjinorë, të cilët e kanë pasur të pamundur t'i vazhdojnë seancat e tyre dhe terapatitë jashtë shtetit, duke pasur parasysh faktin që sistemi ynë shëndetësor nuk i mundëson këto shërbime për personat transgjinorë. Sistemi ynë shëndetësor, po ashtu, nuk i lejon personat që kanë pasur marrëdhënie me personat të gjinisë së njëjtë të dhurojnë gjak.

Situata pandemike ka vështirësuar edhe mbajtjen e Paradës së Krenarisë dhe aktiviteteve të tjera me karakter LGBTIQ+, të cilat shërbejnë për fuqizimin e personave LGBTIQ+ dhe për krijimin e hapësirave të sigurta për ta.

Karshi listës së gjatë të problemeve dhe sfidave me të cilat janë përballur dhe po vazhdojnë të përballen personat LGBTIQ+ gjatë izolimit dhe pandemisë, pothuajse të gjitha institucionet shtetërore



kanë zgjedhur heshtjen dhe "përrjetimin" e personave LGBTIQ+ nga planet e tyre për rimëkëmbjen shtetërore e shoqërore pas pandemisë.

Aktivistët e pavarur LGBTIQ+, grupet joformale dhe OJQ-të kanë punuar vazhdimisht gjatë kësaj kohe për t'iu qëndruar pranë per-

sonave LGBTIQ+. Solidariteti, vullneti e shpresa për një të ardhme më të mirë, më të sigurt, më të lirë e më të barabartë, po na jep forcë për t'u ballafaquar me këto viruse: me virusin COVID-19 dhe "virusin" e homofobisë dhe transfobisë.

Autori është aktivist për të drejtat e LGBTIQ+ në Kosovë.

Kamala Harris dhe e ardhmja feministe e Amerikës

Zëvendëspresidentja e re historike është në pozitën më të mirë për të çuar përpara barazinë gjinore për të gjitha gratë

Zgjedhja historike e Kamala Harris si zëvendëspresidente e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është arsye për të festuar, sepse është e para në shumëllojshmëri. Si e dyta për nga radha pas Presidentit Joe Biden, Harris është gruaja e parë në këtë pozitë. E si vajza e prindërve me prejardhje nga Xhamajka dhe India, ajo është femija i parë i emigrantëve, gruaja e parë me ngjyrë, amerikano-jugaziatikja e parë dhe gruaja e parë e racës së përzier në këtë pozitë. Ajo është zëvendëspresidentja e parë në martesë ndërracore, duke e bërë bashkëshortin e saj, Doug Emhoff, amerikano-hebre, të parin Zotëri të Dytë në histori.

Harris është përfaqësuese e një numri në rritje të grave që janë përqendruar në karrierë, duke e lënë martesën dhe amësinë për më vonë në jetë. Ajo u martua në moshën 49 vjeçare dhe është njerëz e femijëve të burrit të saj. Historia e jetës së saj, në shumë mënyra, ka ndryshuar portretin konvencional të gruas amerikane.

Nëse gjithçka shkon siç duhet me administratën Biden-Harris, ka arsye për të besuar se pas katër viteve ajo mund të bëhet gruaja e parë presidente e vendit.

Ngritja e saj në atë pozitë do të jetë shtruar nga Victoria Woodhull, kandidatja e parë për presidente të SHBA-së në vitin 1872; Shirley

Chisholm, gruaja e parë dhe afrikano-amerikanja e parë që në vitin 1972 garoi për presidente si kandidat e një partie të madhe; Geraldine Ferraro, gruaja e parë e cila në vitin 1984 garoi për zëvendëspresidente si kandidat e një partie të madhe; Barack Obama, presidenti i parë me ngjyrë në vitin 2009; dhe Hillary Clinton, gruaja e parë që u nominua nga Partia Demokratike si kandidatja për presidente (e cila para kësaj shkaktoi "18 milionë çarje" në atë tavanin më të lartë dhe më të vështirë të qelqit) dhe gruaja e parë që fitoi votën popullore në garën presidenciale të vitit 2016.

Trajektorja e Harris drejt presidencës duket premtuese. Pas studimeve themelore në Universitetin Howard dhe përfundimit të studimeve për drejtësi në Fakultetin Hastings të Universitetit të Kalifornisë, ajo e nisi karrierën në drejtësi. Shërbeu si prokurore në San Francisko dhe u bë afrikano-amerikanja e parë që shërbeu si Prokurore e Përgjithshme e Kalifornisë. Në këtë pozitë, Harris avancoi mbrojtjen për pronarët e shtëpive të Kalifornisë gjatë krizës së përvetësimit të shtëpive, siguroi barazi në martesë, mbrojti ligjin për ndryshime klimatike në Kaliforni kundër padive federale dhe mbrojti Ligjin e Kujdesit të Përbalueshëm Shëndetësor.

Në vitin 2017, ajo u betua në Senat-in e SHBA-së duke u bërë senatorja e dytë me ngjyrë dhe e para me prejardhje nga Azia Jugore.

Gjatë mandatit të saj në Senat, paraqiti dhe mbështeti projektligjet për drejtësi racore, barazi në kujdesin shëndetësor dhe masa mbrojtëse për gra dhe femijë.

Kur kandidoi për nominimin presidencial nga Partia Demokratike, disa progresistë u morën me dosjen e saj kur ishte prokurore. E akuzuan për burgosjen e numrit të shpërpjesëtarëve të afrikano-amerikanëve dhe për ndëshkimin që shënjestronte gratë me ngjyrë përmes ligjeve për ikje nga shkollat publike. Marrë parasysh rolin e saj si prokurore e shtetit federal, vendimet e tilla - edhe pse të kundërshtueshme - nuk janë për t'u habitur. Në platformat mediatike të krahut të djathtë, kundërshtarët e saj më shumë e kritikuan jetën e saj private sesa dosjen profesionale, duke nënkuptuar sjellje të pahijshme seksuale, e cila nxiti reagim indiferent të shumicës së opinionit publik.

Si zëvendëspresidente e sapoinauguruar, Harris është në pozitë për të çuar përpara një administratë vërtet përparimtare. Ka shpresë që kjo administratë do t'i adresojë me sukses pabarazitë racore dhe pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, e cila deri tash është trajtuar në mënyrë më efektive të mundshme nga disa udhëheqës të shteteve.

Gratë dhe komunitetet me ngjyrë janë më të prekura nga pandemia dhe Harris është në gjendje t'i kuptojë këto pabarazi. Dhe me

mbështetjen e Presidentit - i cili pavarësisht faktit se nuk i kishte menaxhuar si duhet seancat dëgjimore për konfirmimin e Clarence Thomas, kur profesoresha e drejtësisë Anita Hill pohoi se ishte ngacmuar seksualisht nga i nominuari i atëhershëm për Gjykatë Supreme, ka prezantuar një agjendë të guximshme për çështjet ekonomike, shëndetësore dhe kundër dhunës ndaj grave - ajo mund të jetë në gjendje që t'i avancojë çështjet e mundësive të barabarta dhe njëkohësisht t'i korrigjojë gabimet e së kaluarës.

Pas zgjedhjeve në vjeshtë e kaluar, autorja dhe studiuesja Britney Cooper shkroi në revistën Time se "Përfaqësimi nuk është gjithçka. Por absolutisht është diçka". Duke sqaruar tutje, ajo tha: "Harris do të jetë në pozitë të vështirë të shërbejë si njeriu më i besueshëm dhe këshilltarja besnike e Biden, si përkthyesja kryesore e ankthit të njerëzve me ngjyrë para njerëzve në pushtet dhe si zyrtarja kryesore e diversitetit për një vend që mendon se pozita paraqet mënyrën më të përshtatshme për t'i shfrytëzuar njohuritë mbresëlënëse të grave me ngjyrë për shekujt e padrejtësisë racore. Në ndërkohë, komunitetet e njerëzve me ngjyrë do t'i kërkojnë asaj që ta përfaqësojë një agjendë përparimtare të njëmendtë për drejtësinë racore dhe gjinore".

Posti i zëvendëspresidentes Harris premton shumë dhe ne të gjithë duhet t'iu kërkojmë llogari ud-

hëheqësve tanë për zotimet e tyre politike. Megjithatë, përfaqësimi i grave në pozita udhëheqëse është premtim në vete dhe kjo nuk duhet të minimizohet. Në vitin 2020, vitin që shënoi 100-vjetorin e amendamentit të 19-të të Kushtetutës së SHBA-ve, që iu jep grave të drejtën e votës, kur dështuan në realizimin e redizajnimit të premtuar të kartëmonedhës 20 dollarëshe, në të cilën ishte paraqitur abolicionistja e famshme e shekullit 19, Harriet Tubman, në vend të kësaj vendi zgjodhi një grua tjetër me ngjyrë në pozitën e dytë më të lartë në vend.

Pavarësisht të gjitha ndarjeve politike dhe racore, pavarësisht zbulimeve nga lëvizja #MeToo, pavarësisht krizave të shëndetit publik dhe të ndryshimeve klimatike, ka arsye për shpresë. Në të ardhmen feministe, këto probleme do të trajtohen me seriozitetin më të madh. Për më tepër, ato do të luftohen në mënyra që sigurojnë që vajzat e vogla si Harris, të cilat dikur dërgoheshin me autobus në shkollë gjatë përpjekjeve për t'i dhënë fund ndarjes racore, mund të bëjnë ndryshim të vërtetë në një botë ku asnjë pozitë e pushtetit nuk është e paarritshme për to.

Një përfaqësim i tillë simbolik është njafueshëm feminist për të shkaktuar ndryshime të konsiderueshme politike, sociale dhe kulturore.

Përkthyer nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore.

INTERVISTË ME SIBEL HALIMIN, STUDIUESE E SOCIOLOGJISË SË TRUPIT

Trupi si Pushtet

Kur është qëndëruar trupi në diskutimet sociologjike?

Halimi: Ndërtimi epistemologjik drejt zhvillimit të sociologjisë së trupit është arritur nëpërmjet refuzimit e kritikës së shpjegimit të fenomeneve shoqërore, sjelljes dhe ndërveprimeve njerëzore vetëm nëpërmjet premisave biologjike.

Përkundër përjashtimit të trupit në historinë e teorisë sociologjike, ai arriti të mbijetojë dhe si i tillë, në sociologjinë moderne, trupi u shndërrua në metaforën qendrore të shpjegimit të ndërveprimeve njerëzore.

Fokusimi në trupin nga hulumtimet sociologjike u arrit prej kontributit të shumë disiplinave akademike, prandaj historia e studimit të sociologjisë së trupit nuk mund të karakterizohet si një fushë homogjene.

“Prezenca e munguar” e trupit në sociologji është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrethanat shoqërore, respektivisht me zhvillimin e modernitetit dhe rikthimin e trupit nën kontrollin dhe monitorimin nga vet individi. Ndonëse, është e vështirë të përcaktohet saktë se ku dhe kur janë ndërtuar themelet e sociologjisë së trupit.

Megjithatë, idetë dhe konceptet e zhvilluara në gjysmën e dytë të shekullit XIX hodhën themelet e rëndësishme teorike për kuptimin e trupit. Derisa vetëm në shekullin XX teoria sociologjike arriti ta kuptojë trupin si një objekt sociohistorik.

Sociologu Bryan Turner, që mund të konsiderohet edhe njëri prej kontribuuesve të zhvillimit të sociologjisë së trupit, përshkruan katër zhvillime kryesore të shekullit të XX-të që kontribuuan në shfaqjen e hulumtimeve sociale dhe kulturore mbi trupin.

Së pari, ndryshimet në prodhimin dhe konsumin masiv nga vitet 1920 çuan në disponimin e mallrave të lirë që ndihmuan për të fuqizuar trupin si një shënues të identitetit. Kjo do të thotë, trupi u bë një mënyrë që njerëzit nga klasa të ndryshme të përdorin zbukurimin për të sinjalizuar seksualitetin, gjininë dhe statusin e klasës.

Së dyti, teoricienët postmodernistë sfiduan dallimet subjekt/objekt të përhapura në modernizëm, veçanërisht dualizmi kartezian, i cili promovoi idenë e mendjes si të veçantë nga trupi. Teoria postmoderne sugjeron që trupi i njeriut nuk është i dallueshëm dhe i ndarë nga vetja, por është thellësisht i ndërlidhur me identitetin dhe vetë-shprehjen.

Së treti, feminizmi dhe lëvizja shëndetësore e grave në mënyrë specifike ishin forcat kryesore që sfiduan ndërtimet mbizotëruese biomjekësore të trupave.

Së katërti, studimet e Michel Foucault provokuan një analizë të thellë e të pasur antropologjike, sociologjike dhe historike të prodhimit shoqëror të trupave

përmes disiplinës dhe mbikëqyrjes. Sipas tij, trupi nuk është i dhënë si objekt nga një entitet metafizik, por është një efekt i praktikave specifike historike dhe kulturore të pushtetit dhe dijes. Si rrjedhojë, trupi nuk është diçka objektive që qëndron jashtë historisë dhe kulturës. Në vend të kësaj, Foucault argumenton se trupi është formuar vazhdimisht nga shoqëria dhe historia.

Arsyetimi i trajtimit të trupit të munguar në historinë sociologjike bazohet në njohuritë sociologjike që e kishin origjinën e trajtimit nga perspektiva maskuliniste. Ngaqë është konsideruar se historikisht, trupat e grave janë trajtuar si mish dhe lidheshin kryesisht me natyrën, përdërisa trupat e burrave ishin të lidhur me mendjen, logjikën, racionalitetin dhe qytetërimin. Rrjedhimisht, gratë dhe trupat e tyre u kuptuan si jothelbësore për jetën shoqërore dhe politike, por më tepër si “tjetri” dhe si të tilla u bënë jointeresante edhe për sociologjinë.

Çfarë është trupi në teorinë feministe?

Halimi: Teoria feministe ka shprehur një interesim të vazhdueshëm për trupin dhe mishërimin (embodied), mirëpo, trupi u bë fokusi qendror i studimeve akademike në pjesën e dytë të shekullit XX. Në kohën kur ende vazhdonte të mbizotëronte besimi se gratë janë “më biologjike, më trupore dhe më natyrale sesa burrat”.

Prandaj, ajo çfarë i kontribuoi conceptualizimit teorik të trupit nga ana e studimeve feministe ishte dallimi në mes ‘gjinisë’ dhe ‘seksit’, sidomos në marrëdhënien me pushtetin. Duke e problematizuar konceptin e natyrës nëpërmjet termave si ‘grua’ dhe ‘burë’, ‘femër’ dhe ‘mashkull’, ‘feminitet’ dhe ‘maskulinitet’, vënë në dyshim bazat ontologjike të seksualitetit.

Derisa “Vala e Dytë e Feminizmit” mund të konsiderohet si kontribuuesja kryesore e aktualizimit të trupit në teorinë feministe, e frymëzuar nga Simone de Beauvoir, e cila ishte e përqendruar në ndarjen në mes ‘seksit’ dhe ‘gjinisë’, më pas për t’u elaboruar më gjerësisht në ndarjen në mes ‘natyrës’ dhe ‘kulturës’.

Ndonëse, më vonë “Teoria e performancës” nga Judith Butler mbi gjininë dhe seksin pëmbys konceptimin teorik mbi trupin të trajtuar nga studiueset feministe e hershme Butler bën thirrje për një rishqyrtim të strukturës ontologjike të identitetit dhe kërkon ri-analizë mbi nocionin seks/gjini. Sipas saj, një ndarje e tillë fikson identitetet në dy kategori ekskluzive. Përkundër kritikës nga Butler, megjithatë një ndarje në mes ‘seksit’ dhe ‘gjinisë’ krijoi përpjekjen e parë për të analizuar trupin si kategori analitike të marrëdhënive gjinore.

Politizimi i dhunës seksuale e dhuna ndaj grave, të iniciuara nga feministet



në vendet perëndimore rreth viteve 1970 dhe 1980 e fokusuar kryesisht në seksualitetin e grave, luajtën një rol kryesor në sigurimin e një ambienti të përqendruar të gratë viktime duke u angazhuar për t’i arritur ndryshimet e shoqërore dhe politike të nevojshme për të parandaluar dhunën seksuale.

Në këtë kontekst, ishte e domosdoshme që feministet të ndërprisnin marrëdhënien deterministe midis tipareve të veçanta të trupave të grave, aftësisë së tyre mendore dhe pozitës shoqërore.

Nevoja për të prishur këtë marrëdhënie deterministe, për t’i shkëputur gratë nga teoritë biologjike thelbësore, e bëri të domosdoshme ndërhyrjen e një fushate feministe.

Duke përdorur trupin si mjet veprimi politik dhe proteste, analizat feministe të shtypjes së grave sollën trupin në conceptualizimet akademike të patriarkatit. Në ndryshim nga ato teoritë që identifikonin familjen si bazë të pozitës së grave në shoqëri, një numër feministesh trajtuan trupin biologjik si burim të patriarkatit.

Struktura kryesore e patriarkatit së bashku me konceptin e gjinisë siguruan një kornizë teorike që zhvendosi kushtet e debatit nga një biologjizëm determinues në atë në të cilin kuptohet se shkaqet e dhunës seksuale qëndrojnë në sistemet shoqërore dhe politike që prodhojnë dhe mundësojnë pabarazi gjinore. Trupi u bë i rëndësishëm sepse ishte thelbësor për ndikimin e marrëdhënive të ndryshme të raportit të fuqisë që prekin gratë. Këto aspekte të pushtetit kanë kontribuar gjithashtu në faktin se trupi është bërë një çështje politike për shumë feministe që luftuan për të fituar kontrollin dhe të drejtat në lidhje me trupat e tyre.

Në këtë kontekst, kontributi i mendimit feminist luan një rol të rëndësishëm në ndriçimin e shumë çështjeve që lidhen me trupin e grave dhe vajzave.

Përgjatë historisë, trupi i është nënshtruar kontrollit të vazhdueshëm politik. Pse ndodh kjo?

Halimi: Trupi i gruas është përdorë në përshtatshmëri me specifikat e konteksteve të ndryshme shoqërore e kulturore.

Në historinë patriarkale, trupi i gruas kontrollohet dhe disiplinohet nëpërmjet amësisë. Në këtë sistem normativ, trupi i saj konsiderohet sinonim i pjellorisë, burri i cili “prodhon” djem për t’u bërë burra e të cilët i dalin në mbrojtje vendit ndaj çfarëdo kërcënimi nga “jashtë”. Nëna në shumë kultura është fryma e kolektivitetit, ndaj kjo ka bërë që ethosi të krijojë shprehje idiomatike edhe në kulturën tonë të tipit: “Nëna Shqipëri” apo “Shqipëria amë”.

Po ashtu, simbolikisht, nderi dhe identiteti i një kombi është i lidhur me trupat e grave. Jeta e përditshme dhe rutina e saj ishin vendimtare për transmetimin e kulturës nga brezi në brez dhe kështu gratë marrin qendrën në procesin e ndërtimit të identitetit kombëtar, sepse ato lidhen kryesisht me riprodhimin.

Derisa sot trupi i gruas po ashtu kontrollohet edhe nëpërmjet një përshtatjeje me standardin e së bukurës, kryesisht të promovuar nga kultura e konsumerizmit. Nga regjimet e dietave, veshjes deri tek kirurgjia kozmetike, gratë dhe gjithnjë e më shumë se burrat, përpigjen të gdhendin trupat e tyre në forma që pasqyrojnë normat mbizotëruese të shoqërisë. Standardet e bukurisë janë përcaktuese të sakta të ndërtimit të ‘vetes’ tek gratë e vajzat dhe është një relacion kompleks në mes lirisë së saj fizike (trupit) dhe asaj psikologjike.

Shkolla, media dhe shoqëria në përgjithësi nuk kanë sfiduar normat hegjemonë të bukurisë me qëllim të ruajtjes së individualitetit të vajzave dhe shpëtuar ato nga uniformizimi i mendjeve të tyre. Ky standard në të ardhmen e afërt do të ndikojë negativisht tek vajzat e reja. Prandaj, nuk është e rastësishme që në shoqëritë e industrializuara vajzat vuajnë nga anoreksia e vetëvlerësimi i ulët, për shkak të përpjekjes së tyre që t’i afrohen standardit të promovuar nga kultura e konsumerizimit, e ndikuar nga media dhe rrjetet sociale.

Vajzat që nga mosha e shkollës fillore e tutje janë të ndjeshme ndaj presioneve kulturore për t’iu përgjigjur një game të kufizuar të formave të pranueshme të trupit. Prandaj, trupi mund të konsiderohet njëri prej shkatërrimeve kryesore të bullizmit tek vajzat, çështje kjo që shtrun nevojën e diskutimit në shkollën e media, por gjithmonë duke pasur parasysh edhe mënyrën e të diskutuarit. Ngaqë në shumicën e rasteve, shkolla duke qenë konservative, qasjen ndaj trupit të vajzave mund të ketë po aq të dëmshme sa vet trendi aktual.

Prandaj, me të drejtë Naomi Wolf duke e analizuar ndikimin e modës në jetën e grave dhe vajzave, shkruan se “në aspektin e mënyrës se si ndihemi fizikisht për veten tonë, në të vërtetë mund të jemi më keq se gjyshet tona të pambrojtura”.

Ligjërimit publik për trupin e gruas si imperativ moral, si dhe përcaktimi i fatit të saj nëpërmjet mitit të së bukurës, na lë të nënkuptojmë vazhdimin e prodhimit të miteve të tjera të cilat do të jenë pengesa kryesore drejt arritjes se vetes për gratë!

Cila është kritika feministe ndaj kontrollit të trupit nga gratë dhe mbi çfarë baze arsyetohet ‘sovraniteti mbi trupin’?

Halimi: Jo rastësisht është teoretizuar çështja e trupit të gruas, ngaqë trupi u bë vend i shtypjes, detyrimit dhe viktimizimit për gratë, me të cilat ato janë pozicionuar e gjykuar t’i kushtojnë rëndësi vetëm nëpërmjet shërbimit të gjitha formacioneve shoqërore e politike. Në krijimin e një hendeku të thellë në mes trupit të grave dhe ‘përzgjedhjes’ së tyre, e drejta e grave për të kontrolluar trupat e tyre ka qenë thelbësore në vazhdimin e organizimit të një morie fushatash feministe për të drejtat e riprodhimit (qasja në kontrollin e lindjeve, abortin, lirinë seksuale dhe amësinë vullnetare). Po kështu, e drejta e grave për integritet trupor, për të dhënë pëlqimin se kush prek trupat e tyre dhe në çfarë rrethanash, u mobilizua në fushatash shëndetësore të grave anti-përdhunim në vitet 1970 dhe 1980.

Trupi u bë i rëndësishëm sepse është thelbësor për ndikimin e marrëdhënive të ndryshme të raportit të fuqisë që prekin gratë. Këto aspekte të pushtetit kanë kontribuar gjithashtu në faktin se trupi është bërë një çështje politike për shumë feministe që luftuan për të fituar kontrollin dhe të drejtat në lidhje me trupat e tyre.

Derisa lidhja në mes aktivizimit feminist dhe teorisë feministe ishte një bashkërendim i domosdoshëm me qëllimin e ‘rikthimit’ të trupave të grave tek gratë!

Prandaj, lufta duhet të jetë e grave për gratë duke mos iu përshtatur konditave të paracaktuara, por duke iu rikthyer trupit - jo si materie e as si metafizikë, por vendimmarrje për të. Kjo është e mundshme nga angazhimi i grave për gratë, sepse askush më mirë se sa gratë nuk e di se si në shoqëritë, madje edhe si e jona, të jetosh në trupin tënd është si të jesh e huaj!

DIJE DEMIRI - FRANGU

DAMA MBI TAKA TË LARTA

Takat e larta hanin dyshtemenë si dhëmbë hekuri

Frymë e shenjtë parfumi mbushte hapësirën

S’e dije se atë çast doja t’isha ajo reja e zezë

Poç i djegur varur në qiell të isha

Gur të isha qoftë edhe në id-hzën tënde

Treni që ik fushave me sirenën e dhembshme të rrezikut

Dita e djeshme faqja e shkoqur e kalendari

Vetëm t’mos përballesha me zezësinë e syve tu

T’mos bëhesha copë qielli

Që bie bashkë me lisin e prerë

Lisi bashkë me çerdhen e zogjve

Më lehtë

Do matja temperaturën yjeve

Do i mbaja në shuplakë

Se t’i mbaja lidhur mendimet

Në qafën tënde

- Unë dama në taka të larta

Poçi i djegur në qiell

SHUKRIJE GASHI HERONJTË E ORËVE T’LIGA

vdekja hije klonuar n’çdo hap mes përmes turmash tallet me heronjtë e orëve t’liga asgjë e pazakontë i ngjan ditës a muzgut mrekullues teksta

vjedh frymëmarrjet pa oksigjen e frika nuk ka kohë as guxim për hijet e pacientëve t’paidenti-fikuar

as nesër Covid-19 i han të gjitha sekondat tinëzishit kush është engjëlli që do ta ha Covid-19 rojën e ferrit a Xhibrilin ankthin pa zë epokë e çuditshme nuk disiplinohet njeriu...

Më të fuqishme se fati

Salih Mehmeti

Atë që e nisën fill të vetme gratë e Krushës së Madhe në vitet e vështira të pasluftës, sot bota e filmit po e vlerëson si një rrëfim mbresëlënës mbi vullnetin për të mbijetuar. Shpirti rimëkëmbës i Fahrije Hotit dhe historia e saj është përkthyer si shembull universal mbi qëndrueshmërinë, transcendencën dhe përpjekjen për liri.

Kur një dekadë më parë regjisorja Blerta Basholli po i endte fijet e projektit të saj filmik, ajo dhe të tjerët nuk e kishin përfytyruar as në ëndrrat më të guximshme që një histori e tillë do të merrte përmasa të përbotshme. Megjithatë, në fillim të shkurtit, filmi “Zgjoji” u shpërblye në edicionin e sivjetmë të më të madhit festival amerikan të filmit Sundance Film Festival. Nga aty doli me tri trofe stolisur: “Grand Jury Prize”, “Audience Award” dhe “Directing Award” në kategorinë “World Cinema Dramatic”.

Për katër ditë me radhë, ekipi i filmit nga Kosova ishte gati në një agoni ekzaltimi. Nuk kishin kaluar veçse pak orë pas premierës së dhënë më 31 janar, kur ia behën kritikant në superlativ për filmin debutues. Edhe në ditët në vijim filmit do t'i trokisnin në derë vetëm ogure ndjellmira për diçka që tashmë po bënte histori jo vetëm në festivalin e mirënjohur, por edhe në kinematografinë shqiptare. Ndarja e çmimeve kaloi me një ceremoni që zgjati rreth një orë e gjysmë, të cilës moderatori i njohur Patton Oswalt i dha përplot mëlsesa humorit.

“Sundance Film Festival”, i cili nisi në gusht të vitit 1978, këtë vit zgjati vetëm shtatë ditë dhe pjesa më e madhe e publikut e përcolli larg nga epiqendra e tij, Park City në Utah të SHBA-ve. Festivali mbajti të hapur vetëm disa kinema për vetura dhe pjesën më të madhe të programit e shfaqti online për shkak të rrethanave me pandeminë.

Gongu ra...

Minutat rridhnin njëra pas tjetrës me shpalime fituesish kur anëtarit i jurisë, Isaac Julien, shqiptoi titullin në anglisht të filmit të Bashollit - “Hive”, si fitues të çmimit për regji. Duke lexuar vlerësimin e jurisë, ai tha se ky film sjell rrëfimin e vullnetit për të mbijetuar. Sipas tij, “filmbërësja demonstroi angazhim rigoroz dhe integritet në rrëfimin e fuqishme”.

Fill pas kësaj u ndërfut videoja me adresimin e regjisores Blerta Basholli, e cila tha se çmimi ka vlerë të madhe për të, për stafin si dhe për Fahrijen si “shembull të madh”.

“Nuk mund ta fsheh ngazëllimin tim për festivalin që na dha mundësinë për të treguar rrëfimin tonë”, tha regjisorja e skenaristja 38-vjeçare.

Pak minuta më vonë, “Zgjoji” iu kumtua i dyti çmim: “Grand Jury Prize”. Duke përcjell arsyetimin e jurisë, anëtarja Daniela Vega tha se filmi fitues synon të bëjë një portretizim të përpjekjeve të grave për pavarësim.

“Është një film për qëndrueshmërinë, transcendencën dhe përpjekjen për liri. Vendosmëria dhe shpirti për të tejkaluar represionin ndjehet ende nga shumë gra gjithandej botës”.

Se “Zgjoji” veçse fitoi zemrat e publikut amerikan u dëshmuar nga çmimi i tretë që mori, atë të audiencës. Duke e vlerësuar edicionin e sivjetmë të “Sundance” që ishte jetik për lidhjet e rëndësishme mes filmbërësve dhe audiencës, prezantuesi Diego Luna tha se filmi i Bashollit tregon se kjo lidhje po bëhet gjithnjë e më e fortë.

Sfidimi i konvencave shoqërore

Nën regjinë dhe skenarin e Blerta Bashollit, “Zgjoji” vë në qendër rrëfimin e vërtetë të Fahrije Hotit, gruas nga Krusha e Madhe, e cila duke sfiduar konvencat shoqërore merr fatin e saj në dorë dhe bashkë me gra të tjera hapin një biznes.

Filmi i cili prej kritikëve amerikanë u cilësua si një reze shprese që ngritet nga rrëfimi i një gruaje, ka përçar mesazhet e tij universaliste përmes një historie dhembjeje, vuajtjeje dhe përpjekjesh.

Në kohëzgjatje prej 1 orë e 24 minutash, filmi përmbledh në mënyrë të përkryer jetën në Kosovë, ndikimin e pasojave të luftës si dhe jetën e grave në një mjedis tradicional.

Në zemër të tij, “Zgjoji” tregon një kronologji të Fahrije Hotit nga Krusha e Madhe. Rrëfimin e përshkon kërkimi i pareshtur për ta gjetur burrin e saj, Bashkimin, të cilin për të fundit herë e pa në 25 marsin e 1999-ës. Përpos ankthit të pritjes për të pagjeturit, që është përditshmëria e banorëve të fshatit plagëshumë, Fahrija bashkë me gra të tjera nismojnë një biznes të vogël.

Bashkë me këtë janë edhe pëshpërimat që vijnë nga mendësia parokiale e njerëzve. Filmi është edhe një testament për atë sesi një grua nuk e ka ndërmend të rrijë duarkryq dhe me shpirtin e saj ndërmarrës jo vetëm krijon mirëqenie, por edhe pavarësohet duke marrë patentë-shoferin.

Për dallim nga publiku amerikan që pati rastin të shihte filmin në “World Cinema Dramatic Competition” – si kategoria kryesore e garës në edicionin e sivjetmë virtual të “Sundance” – ai në Kosovë ende nuk e ka parë filmin e Bashollit. Të vetmet imazhe të këtij projekti kineast janë nga trajleri gati 2-minutësh, të afishuara në portalin e njohur “IndieWire”.

Duke e vlerësuar filmin si portret feminist, mediumi që merret me kinematografinë ka theksuar se

“Zgjoji” është një rrëfim i fuqishëm për gruan që lufton patriarkatin në Kosovë. Filmi mori kritika të shumta pozitive që në premierë.

“Regjisorja Blerta Basholli i mban gjërat me këmbë në tokë, duke na vënë aty me Fahrijen dhe familjen e saj, sikundër edhe me gra të tjera që i bashkohen asaj në rropatjen e guximshme, gjersa ato bëhen blea punëto-re që e ndihni Mbretëreshën e tyre”, ka shkruar Gibbs në një recension të botuar në “Slug Mag”, e cila është një nga revistat më jetëgjatë në Utah, mu aty ku ndodhet zemra e Festivalit “Sundance”.

Të dënuara me vuajtje

E para ndjesi që përtohet është ajo e marramendjes, gjersa Fahrija nxiton fshehurazi t'i hapë thasët me mbetjet mortore të banorëve të vranë të Krushës së Madhe.

Kjo mënyrë e të xhiruarit përkap si mos më mirë agoninë e pambarimtë të atyre që jetojnë në pritje të më të dashurve që nuk u kthyen asnjëherë. Skena e radhës është gati si shkëputje që shikuesin e vë mes zukumës së koshereve të bletëve. Aty Fahrija si bletare hedh hapat e parë në një mbi-jetesë për shumëkë të pamundur: zhdokja e burrit ka prerë si me thikë fatin e një familje të tërë. Mbi të rëndon barra e mbajtjes së dy fëmijëve dhe vjehrit në karrocë. Trupi i saj ka plot të ënjtura nga pickimet e bletëve si indicie që as me to nuk po bëhet rehat.

Me skena të bukura pamore që paraqesin blerimin veror – ashtu siç është e gjithë mbamendja kolektive për pasluftën kur vera e parë në liri ishte përballje me plagët e thella të luftës – ngjarja e filmit “Zgjoji” merr shtjellën e vet si histori e dhimbshme e atyre që fati i la të gjallë, por i dënoi

të vuajnë pasojat papërshkrueshëm tragjike të luftës.

Edhe pa e ndërmendur fare faktin që filmi i regjisores prishtinase Blerta Basholli ka marrë tre trofe në “Sundance Film Festival”, tok me vlerësime të jashtëzakonshme nga kritika e filmit, stori e Fahrije Hotit të bën për vete me diçka që shplekset e zbulon të reja nga thellësitë e dhembjes.

Është një dhembje që secilit shqiptar i bën një lëmsh në fyt si diçka e përjetuar në njëfarë mënyre edhe pa qenë i prekur personalisht. Aktorja Yllka Gashi sublimon 22 vjet të personazhit real, gruas nga Krusha e Madhe, që është e kryqëzuar mes dhembjes për burrin e zhdukur, skamjes në shtëpi dhe një rrethi shoqëror që nuk arrin ta ndihmojë, përveçse ia shton dhembjen me fshikullime paragjykimesh. Por, aty ku duket gjithçka e mbaruar prej fatalizmit - vetëtin shpresa. Është pikërisht shpirti ndërmarrës i Fahrijes që kthehet si fanar për dhjetëra gra që kanë mbetur pa burra në fshatin rahovecian, ku forcat serbe vranë 240 njerëz të pafajshëm.

“Nëse nuk punojmë, dojna me u tranue”, u thotë Fahrija një ditë grave të veja. Asgjë nuk është e lehtë: vullneti e dëshira ndonjëherë nuk e kapërcejnë ngurrimin përballë normave shoqërore.

Ajo që nuk përfundon kurrë

Kështu kjo histori ndërtohet në njëfarë antagonizmi mes Fahrijes dhe Haxhisë, vjehrit të saj, interpretuar nga Çun Lajçi. Është pikërisht ky personazh që manifeston burrat që nuk mund të familjarizohen lehtë me nocionin e grave të pavarura. Por, që të dy këto skaje i bën bashkë dhembja për Agimin (që në jetën reale është Bashkim Hoti, kurse në paraqitjet disasekondëshe në film interpretohet nga Armend Smajli). Krajjat me mjekoligjorët janë një histori që gati përbashkon 1600 familje nga Kosova të cilave iu zhdukën të afërmit.

“Testi i ADN-së ju kryen punë juve, por për neve nuk kryhet kurrë”, i thotë mjekut një ditë Fahrija. Është me siguri titra më besnike e vuajtjes së kësaj kategorie.

Duke qenë edhe skenariste e filmit, regjisorja Basholli ka bërë një ekuilibër të mirë duke i pakësuar mjeshtërisht dialogët e duke iu dhënë paraqitje vizuale e emocionale personazheve që reflektojnë historinë tragjike të Krushës së Madhe.

Përveç dyshes së njohur të aktorëve kryesorë, Yllka Gashit dhe Çun Lajçit, kastin e filmit e përbëjnë edhe Aurita Agushi, Kumrije Hoxha, Adriana Matoshi, Kaona Sylejmani, Ilir Prapashtica, Astrit Kabashi, Mollikë Maxhuni, Blerta Ismaili, Xhejlane Tërbanja dhe Shkëlqim Islami. Drejtor i fotografisë është Alexander Bloom, montazhi i filmit është bërë nga Enis Saraçi dhe Félix Sandri, ndërsa producentë janë Yll Uka, Agon Uka dhe Valon Bajgora.

“Zgjoji” është bashkëprodhim filmik në mes të Kosovës, Zvicrës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës, Zyra Federale për Kulturë FOC dhe Cinéforum (Zvicërr), Agjencia e Filmit e Maqedonisë së Veriut dhe Qendra Kombëtare për Kinematografi (Shqipëri), prodhuar nga Ikonë Studio dhe Industria Film, me bashkëprodhim nga Alva Film Production, Black Cat Production, AlbaSky, Swiss National TV, ndërsa të drejtat e shitjes globale i ka LevelK.

“Një ndjenjë lehtësimi...”

Një muaj pas suksesit të “Zgjoit”, Fahrije Hoti, rreth të cilës qendërohet filmi, thotë se të gjitha gratë e Krushës së Madhe ndjehen pak më të lehtësuara që për dhimbjen e tyre po mëson bota.

“E di që njerëzit mund të kenë sër-

ish një fluks paragjykimesh, por megjithatë jam shpirtërisht më e lehtësuara që e kam dhënë dhe dokumentuar atë përvojë”.

51-vjeçarja ka bindjen që duhen edhe shumë e shumë filma të tjerë për t'i dalë “hakut” vuajtjeve të grave të veja jo vetëm në Krushë të Madhe, por në tërë Kosovën.

“Le t'i tregojmë botës se këtu ka pasur luftë të përgjakshme dhe gratë i kanë përjetuar sa e sa sfida që dokumentohen edhe në film”.

Rrëfimet që nuk iu është dhënë peshë

Profesoresha në Departamentin e Etnologjisë dhe Antropologjisë kulturore në Universitetin e Prishtinës, Nita Luci vlerëson se përvojat e grave nuk janë homogjene dhe ato formohen sipas akseve të ndryshme shoqërore, politike dhe ekonomike.

“Ekziston një prirje që të flitet, për shembull, për ‘gruan’ apo ‘gruan shqiptare’, por përderisa ato ndajnë shumë përvoja konsideroj se është me rëndësi të tregohet kompleksiteti dhe shumëllojshmëria e të qenit grua në Kosovë”.

Teksa filmin e Bashollit ende nuk e ka parë, ajo vlerëson se fokusi në jetën e një personi për të thurur narrativa mes mikro dhe makro historive është një “strategji e fuqishme” që sjell agjensinë e njerëzve, zëreve dhe veprimeve që nuk iu atribuohet pesha e duhur në historiografitë konvencionale.

Duke folur mbi dokumentimin e rrëfimeve të luftës, profesoresha e antropologjisë mendon se animë është duke u zhvilluar një veprimtari shkencore dhe artistike që nuk ngurron, për shkak të paragjytimeve, të merret me rrëfimet, përvojat dhe dijen e grave.

“Në veçanti nuk ka më qasje apologetike (mbrojtëse) kur ngrihen pyetje rreth marrëdhënieve të pushtetit të ndërtuara mbi baza të pabarazisë gjinore. Ka perspektiva që nuk e konsiderojnë gjininë si koncept të rëndësishëm, mos të themi të domosdoshëm analitik”.

Luci ka bindjen që nuk janë vetëm studiuesit e huaj ata që kanë treguar domosdoshmërinë e zërave të grave. Për këtë ajo ka përmendur edhe studiuese e artiste shqiptare që, sipas saj, e kanë trasuar këtë rrugë, duke përmendur Blerta Bashollin, Blerta Zeqirin, Lendita Zeqirajn, Antoneta dhe Sevdije Kastratin, Drita Gungën, Elife Krasniqin, Linda Gusinë, Vjollca Krasniqin, etj.

Kinematografia po e fuqizon zërin e gruas

Regjisorja nga Prishtina, More Raça ka bindjen se zëri i gruas po dëgjohet gjithnjë e më shumë përmes kinematografisë.

Ajo thotë se rrëfimet mbi individin janë rrëfime që po e marrin vendin dhe hapësirën e duhur në kinematografinë botërore dhe atë të Kosovës.

“Ndër këta individë pa dyshim bie theksi te gruaja si individ në një shoqëri me mbetjet e patriarkisë dhe probleme të shumta që e sfidojnë atë në një shoqëri në zhvillim”.

Regjisorja 29-vjeçare – filmi i të cilës “Galaktika e Andromedës” ka shënuar një varg suksesesh ndërkombëtare – ka bindjen që kinematografia e Kosovës po jep kontribut më të madh sesa vetë institucionet shtetërore kur bëhet fjalë për përfaqësimin e vendit në arenën ndërkombëtare.

“Dokumentimi i vuajtjeve njerëzore në Kosovë është trajtuar si temë në filmat tashmë të suksesshëm në festivale ndërkombëtare, por kineastët mbështeten shumë pak nga institucionet”.

Autori është gazetar në KOHA Ditore.



HIVE
WINNER
SUNDANCE
FILM FESTIVAL

PËRKRAHUR NGA:

